

TREGIME

DIBËN PËR
SHTETIT
81432
P59



**PERGJIGJE
LETRES**

81H-32

PSS.

PËRGJIGJE LETRËS

Tregime dhe skica



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

EDHE NJË KËNGË TJETËR

Posta e policisë në Vranisht s'kishte në atë kohë as dritë elektrike, as radio e, për këtë arsye, komandanti i saj, shoku Zenel Leka, nxiste Sadikun dhe Pjetrin t'i binin çiftelisë. E vërteta është se si Sadiku ashtu edhe Pjetri s'kishin nevojë për nxitje, mbasi këtë punë e kishin merak vetë. Sapo u jepej rasti, ose kishin kohë të lirë, ata merrnin çiftelinë, uleshin te stoli, nën hijen e sallgëmit, dhe ia fillonin këngës.

Jonet e këngës përhapeshin luginave e prozhmeve gjersa treteshin në largësi së bashku me gurgullimën e ujërave dhe fëshfërimën e gjetheve të pemëve.

Nuk ka asnjë vegël tjetër muzikore që të barazohet me çiftelinë për tonet e saj të veçanta. Timbri i saj duket sikur ka përmbledhur meloditë e natyrës së bjeshkëve në pranverë. Mbyll sytë kur dëgjon një çifteli dhe të ngjan se ke përpara një vijë që gurgullon gëzueshëm duke shkuar tatëpjetë prozhmeve e sukave; atje dëgjon zukatjen e mijëra bletëve mbi lulet e pranverës, zhurmën e pyllit nga flladi i erës, lodrimet e fijeve të barit nën pikat e shiut, kleisjen e yjeve kur dalin mbi mal. Dhe para së gjithash çiftelinë e ke shok.

Ajo të shoqëron kur ti këndon, mbush boshllëqet midis vargjeve, kur ti lodhesh ose merr frymë, dhe këndon vetë kur e do puna. Ajo të kupton e të bindet si të jetë e gjallë. Dhe nuk u bindet vetëm gishtave, më shumë i bindet zemrës dhe harmonizohet me të. Këndon dhe për brenga dhe për halle, për gëzim e dashuri, për trimëritë e largëta të brezave dhe për ato të afërmet. Në bishtin e saj janë regjistruar me mijëra histori trimash, me mijëra dashuri e ndjenja intime. Brezat kanë lënë aty gjurmët e tyre.

Kur nis çiftelia, pleqtë presin këngën dhe mbajnë në vesh. Zakoni dhe tradita i kanë dhënë asaj në këtë mënyrë një vend nderi duke e vendosur mbi hajen. Ajo sillte lajmet e komentonte ngjarjet e mëdha; përjetësonte trimëritë dhe u këndonte heronjve.

Ja, këto po mendonte Sadiku atë ditë pranvere në oborin e postës. Melodia po i dilte pak e trishtuar. Kështu ngjiste gjithë herët që merrte këngën e Lulës dhe këtë e dinin shokët e tij. Duke kënduar atë këngë ai shprehte mallin dhe brengën e tij. Kjo këngë që e re, s'kishte disa vjet që këndohej nëpër dasma e gëzime, në ditëlindje dhe festa popullore, në bjeshkë dhe në stane. Këngëtarët e vetëmuar këndonin trimërinë e saj. Atë këngë duhej ta kishte nxjerrë Sadiku, se atij i takonte para të tjerëve, por Sadiku nuk dinte të bënte vargje. Këngën e kishte hartuar dikush tjetër por siç ngjet shpesh në këso rastesh që hapur me shpejtësi dhe që përpunuar duke u bërë pasuri e gjithë krahinës. Lulës së Mark Shytit tani i këndonin të gjithë, por ata i këndonin vetëm trimërisë së saj, kurse Sadikun, kur i përmendte emrin e saj, e shtrëngonte diçka në

zemër. Ai e kishte dashur Lulën dhe ata kishin qenë në prag të fejesës, kur një natë dhjetori të vitit 1945, — atëherë Arma e Policisë nuk kishte mbushur veçse gjashtë muaj që kurse qe krijuar, — Lula, duke iu përgjegjur alarmit të postës së policisë kishte shkuar, si shumë fshatarë të tjerë për të rrethuar një bandë kriminelësh në stanet sipër fshatit.

Nuk ishte hera e parë që trimëresha Lulë shkonte në ndihmë të forcave të policisë dhe të organeve të ndjekjes. Ajo e kishte bërë këtë gjë sa herë ishte paraqitur rasti dhe sa herë e kishte dashur puna. Por në atë betejë ajo la nam, sepse u sul vetë e para në krye të forcave për të zhdukur armiqtë. Që ajo që hodhi shishen me benzinë mbi kasollet ku ishin strukur kriminelat. Plani i armiqve, që të rezistonin gjersa të errej e pastaj të largoheshin, dështoi. Armiqtë si të tërbuar tentuan të çanin rrethimin dhe u sulën pikërisht në drejtim të Lulës. Ajo luftoi kundër tyre dhe ra si trimëreshë. Ja, kështu e dha fjetën Lula, dhe këto thoshte me pak fjalë edhe kënga.

Që atëhere kishin shkuar shtatë vjet dhe Sadiku s'po vendoste ende të martohej. Plaga që i kishte hapur humbja e Lulës nuk qe mbyllur dhe me këngë e çifteli ai shprehte mallin e dashurisë së pa-realizuar. Kjo qe edhe arsyeja që ai e këndonte me aq pasion këngën e saj dhe ndryshe nga të tjerët, më me ndjenjë, më me shpirt, sepse ai i këndonte jo vetëm trimërisë por edhe dashurisë.

Tani Sadiku po bënte katër vjet që kurse kishte hyrë në Armën e Policisë dhe qe veshur me uniformë, pa llogaritur këtu kohën që kishte kaluar në Tiranë për të kryer shkollën njëvjeçare të poli-

cisë. Gjatë kësaj kohe kishte punuar si në qytet ashtu dhe në postat e policisë të lokaliteteve të vogla dhe kudo kishte ndjerë dashurinë e sinqertë të njerëzve të thjeshtë, të njerëzve të popullit.

Ai vetë kur kishte qenë i vogël, kishte patur shumë frikë nga xhandarët, ndonëse i kishte parë fare rrallë. Ata vinin në fshatin e tij për të arres-tuar njerëzit që s'kishin para të paguanin taksat. Xhandar dhe burg për të pothuajse kishin të njëjtin kuptim dhe, sa herë që bënte ndonjë prapësi, nëna i thoshte se do ta kallëzonte te xhandari kur të vinte në fshat.

Tani fëmijët e fshatit në Vranisht qenë miqtë më të mirë të Sadik Morinës. Ata, kur delnin nga shkolla, ktheheshin në oborrin e postës, këndonin bashkë me të ose dëgjonin meloditë e çiftelisë. Disa prej tyre kishin sjellë dhe informata shumë të vlefshme për njerëz të dyshimtë që qarkullonin atyre anëve jo shumë larg zonës kufitare.

Kjo lidhje e ngushtë e njerëzve të popullit shfaqej në mënyra të ndryshme. Ata e kishin kuptuar me kohë se Arma e Policisë mbronte rregullin dhe rendin nga kriminelët dhe të arratisurit e viteve të para, nga diversantët dhe spiunët, nga keqbërësit e vjedhësit e kategorive të ndryshme, nga spekulatorët e matrapazët. Ishin njerëz të thjeshtë, punëtorë e fshatarë, këta që ndihmonin Armën e Policisë. Pra shtëpiake qytetarë të ndershëm e ndihmonin policinë në punën e saj.

U ndie zilja e telefonit dhe nënoficeri i rojes u përgjigj. Ai filloi të thërriste me zë të lartë:

— Komandant Zeneli, ju kërkojnë në telefon!
Sadik Morina e preu këngën me çifteli, sepse

kur bisedonin në telefon me zona të largëta zëri në kufjen e telefonit mezi dëgjohej.

Sadikun e kishte marrë malli për njerëzit e familjes dhe për fshatin. Atë verë motra e tij, Lavdija, kishte mbaruar shkollën shtatëvjeçare dhe kishte dëshirë të vazhdonte shkollën e mesme në Tiranë. Bursa i qe dhënë, por prindërit s'donin ta dërgonin, sidomos babai. Ai thoshte se s'kishte ç'i duhej më shumë shkollë dhe gjente si shkak se asnjë prind tjetër, deri atëkohë, nuk kishte pranuar t'i nxirrte vajzat nga shtëpia e t'i dërgonte pa njeri, larg shtëpisë, për tre a katër vjet. Ky qe një zakon që s'thyhej lehtë dhe i ati i Sadikut ndruhej e s'donte të vihej në shinjestër si njeri që prish zakonet e aq më tepër në një çështje delikate si kjo, ku patjetër gojë e këqija do të «shpërthenin» për nderin e vajzës.

Mirëpo Lavdija donte të shkonte në shkollë, i kishte hyrë në zemër të bëhej mësuese dhe vetëm për këtë ëndërronte. Ajo i kishte dërguar një letër Sadikut ku ia thoshte hapur dëshirat e saj dhe e ftonte të vinte në shtëpi dhe t'u mbushte mendjen prindërve. Detyrë e vështirë për Sadikun. A do të arrinte t'ia mbushte mendjen babait? I ati e dinte se i biri ishte punëtor politik, të cilin pushteti e donte dhe e nderonte, përderisa e kishte vesnur me uniformë. Ai e ndjente veten krenar për këtë, po ama, kur vinte puna për çështjet familjare ai ishte babai dhe Sadiku i biri. Sadiku e ndjente këtë dhe e dinte se e kishte më lehtë me të tjerët se me babanë e vet.

Ja për shembull, Sadiku e kishte bindur Arif Spahon, sigurisht me vështirësi, me këmbëngulje dhe lutje, që ta dërgonte vajzën në shkollë. Dhe

Arifi me gjysmë zemre e kishte pranuar. Po tani po e shikonte vetë se e bija jo vetëm që s'kishte pësuar gjë të keqe, por përkundrazi kish mësuar e vazhdonte të mësonte për mrekulli dhe dërgonte letra kaq të bukura, sa ai i lexonte nga katër a pesë herë e gati sa nuk i mësonte përmendsh. Arifi për këtë ia dinte të mirën Sadikut dhe e quante mik për kokë. Arifi që anëtar i grupeve vullnetare dhe aktivist i dalluar.

«Më duhet të marr disa ditë leje, — tha Sadiku me vete, — të shkoj në shtëpi dhe të bisedoj me babanë.»

Komandanti i postës doli tek dera.

«A t'i them tashti? mendoi Sadiku, po prapë i erdhi rëndë se komandanti i kishte premtuar që do ta dërgonte me leje në fillim të shtatorit.

Atë kohë në postë u duk një gjahtar me çizme e çifte. Pas i vinin dy langonj me këmbë të gjata e veshë të varur. Ai diç bisedoi me komandantin, dhe në postë u dha alarmi. Të katër policët menjëherë u vunë në gadishmëri dhe atje mbeti vetëm nënoficeri i rojes.

Gjahtari kishte parë rastësisht një burrë me veshje gjysmë ushtarake që po shikonte me dy lbi në drejtim të fshatit dhe pat dyshuar. Të dhënat e tij korrespondonin me përshkrimin fizik të një kapobande të rrezikshme.

Katër u nisën, po gjersa dolën nga fshati u bënë në katërmëdhjetë, e gjersa arritën në vendin e treguar mbi tridhjetë e pesë. Fshatarët linin punën dhe rendnin pas shokëve të policisë.

Sadiku ecte pranë Arifit që kishte ardhur drejt prej arës dhe të dy po bisedonin se si mund t'i organizonin forcat.

Rrethimi i vendit u bë sipas planit e kur nisi pushka erdhën në ndihmë edhe fshatarë të tjerë, të cilët i sollën aty vetëm krismat.

Po njerëzit e bandës kishin zënë një pozicion të mbrojtur nga natyra me gurë të mëdhenj dhe qe tepër e vështirë t'u afroheshe.

Përpyekja po zgjatej dhe rezultatet s'po duke-shin.

— Ata e duan me granata, — dëgjoi Sadiku një zë pranë tij. Ishte Arifi që po përgjonte se mos dukej ndonjë kokë në shkëmbin përkundrejt.

Sadiku e gjeti me vend planin e shokut. Nxori granatat dhe po hiqej zvarrë. Ai u habit kur vuri re se përbri tij po zvarritej edhe Arifi.

— Po ti ku vete?

— S'të lë vetëm.

— Po a e di se kështu mund të na diktojnë më lehtë?

— Një herë kemi për të vdekur, — ia pat Arifi.

— Si thotë ajo kënga për Lulë Markun:

*Cucë malsie ti s'u ndale,
Por luftove me trimni...*

Kur armiqtë i diktuan, ata ndodheshin thuajse rrezë shkëmbit dhe plumbi i armikut s'i hante, por edhe pozicioni që zunë të dy shokët nuk qe fort i mirë. Mund të luftonin vetëm me granata, madje edhe ato duhej t'i hidhnin me saktësi se qe rrezik t'u binin vetë atyre në kokë. I pari hodhi granatën Sadik Morina dhe pas tij edhe Arifi. Pas krismave u dëgjuan disa britma e të shara nga ana e armiqve. Lufta u ndez e rreptë me bomba dhe granata nga të dy anët. Banda u asgjësua por një cifël bombe e

plagosi rëndë në gjoks Arifin dhe ai pas pak mbylli sytë në krahët e Sadikut.

Pak ditë pas këtij aksioni një këngë e re u dëgjua në ato anë. Qe kënga për trimërinë e Arif Spahos dhe të një polici me emrin Sadik. Por Sadiku, kur e këndonte këtë këngë, emrin e vet nuk e përmendëte, por thoshte thjesht: Një shok i Arifit..... Të gjithë e dinin se brenda telave të çiftelisë gjëmon-te edhe trimëria e policit Sadik Morina.

NË VENDIN E TAKIMIT...

Pasi na lajmëruan për një vrasje, u nisëm për në vendin e ngjarjes. Pas kqyrjeve që i bëmë vendit të ngjarjes menduam se ndodheshim para një vrasjeje dhe jo vetëvrasjeje. Flagët që kishte marrë viktimia ishin në të tilla pjesë të trupit që përjashtonin mundësitë e vetëvrasjes. Pra dikush atë e kishte vrarë. Por kush ishte ky «dikush» dhe përse e kishte kryer këtë krim?

Kufoma ndodhej në një gropë të gjerë me krahe të hapur. Dhjetë metra larg trupit të viktimës ishte një biçikletë. E viktimës ishte apo e kishte harruar vrasësi? Në qoftë se biçikleta nuk ishte e viktimës, atëhere vrasësi kishte ardhur me biçikletë, pra ai ishte një njeri i vetëm. Në rast të kundërt...

Nga studimi i vendit të ngjarjes rezultoi se vrasja nuk ishte kryer në gropën e gjerë. Nga vendi ku qëndronte biçikleta deri tek gropa viheshin re gjurmë takash dhe shenja zvarritjesh. Aty-këtu, kishte disa njolla gjaku. Pra, viktimia, para ngjarjes, kishte qëndruar pranë vendit ku ndodhej biçikleta dhe ajo duhej të ishte e tija. Fakti që ai ishte ulur aty e jo në vendin tjetër, vërtetohej edhe nga gjurmat e lëna në tokë nga të ndenjurat dhe nga takat e këpucëve. A kishte qenë ulur me njeri tjetër viktimia?

Mos vallë me vrasësin? Pranë vendit ku kishte qenë ulur viktimia u gjend një copë gazetë. Pak më poshtë u gjend një pjeshkë e ngrënë përgjysmë. Mjaf-tonin këto dy fakte për të krijuar mendimin që pranë viktimës ishte ulur një person, që duhej të ishte femër. Në gjysmën e pjeshkës dalloheshin gjurmat e të kuqit të buzëve.

Por a mundej të kryente një femër një vrasje të tillë? Në raste të veçantë mund të ndodhë, por përgjithësisht jo. Viktimia ishte vrrarë dhe nuk kishte vdekur menjëherë, por pas një përleshjeje që kishte zgjatur ca. Kjo vërtetohej nga fakti se në një zonë rreth 30-40 metra katrore dalloheshin gjurmë të shumta këmbësh, gjurmë zvarritjesh, gjurmë gjaku, lëvizje të sendeve përreth e të tjera. Përveç kësaj, në shuplakën e dorës së djathtë të viktimës dalloheshin plagë prerjesh, gjë që tregonte se viktimia duke dashur të mbrohej kishte kapur armën e vrasësit.

A mundej një femër t'i kryente të gjitha këto? Po bëhej e qartë jo vetëm se pranë viktimës kishte qenë një femër, por edhe se ajo kishte qenë e shoqëruar edhe nga një njeri tjetër. Kjo përforcohej edhe nga fakti se nga vendi i ngjarjes, dukeshin gjurmë këmbësh të larguara në dy drejtime. Pra, përveç viktimës, në atë vend kishin qenë edhe dy njerëz të tjerë, njëri nga të cilët femër.

*
* * *

Perdja që i mbulonte vrasësit qëndronte pa lëvizur. Megjithatë, disa të dhëna të reja që u nxo-

rën nga ekspertiza mjekësore e kufomës dhe studimi në laborator i disa pikave të gjakut që ishin gjetur pak larg prej vendit të ngjarjes, hodhën dritë mbi çështjen. Vrasja ishte kryer rreth orës 20-22 të mbrëmjes, një ditë para gjetjes së viktimës. Kjo gjë vërtetohej lehtë nga shkalla e ngrirjes së kufomës dhe nga sasia dhe forma e njollave, ndërsa pikat e gjakut dëshmonin se një nga autorët e krimit duhej të ishte plagosur lehtë. Cili? Femra apo tjetri? Plaga duhej të ishte në pjesën e sipërme të trupit, në dorë ose në fytyrë dhe, kurrsesi në këmbë. Kjo shpjegohej në bazë të formës dhe dimensionit të pikave të gjakut, të cilat kishin karakteristikat e pikave të rena nga një largësi prej më tepër se një metër.

Qytetari L, i cili doli si pronar i biçikletës së gjetur në vendngjarje, tha se viktimja quhet Qemal K. dhe punonte si magazinier. Ai ia kishte dhënë biçikletën Qemalit po atë ditë që ishte kryer vrasja.

Edhe një fakt tjetër jo më pak i rëndësishëm: Në njerin nga xhepat e viktimës u gjet një letër. Ajo ishte shkruajtur me makinë daktilografike. Në krye të saj viktimja shkruante si i lindi mendimi për vetëvrasje dhe pastaj sqaronte arsyet që e shtynë atë të merrte këtë vendim. Pas ekspertimit grafik të saj, eksperti sqaroi përfundimisht se letra ishte shkruajtur me makinën e shkrimit të ndërmarrjes ku punonte viktimja. Veç kësaj eksperti dha një mendim që u duk mjaft interesant. Një njeri që merr vendimin për vetëvrasje nuk para shkruan letra me makinë. Veç kësaj mendimet e hedhura në atë letër që u gjet në xhepin e viktimës nuk mund të ishin të një njeriu me një gjendje të tendosur nervore por të një tjetri. Këto gjëra

na përforcuan mendimin se kishim të bënim me një vrasje, por që ishin bërë tentativa për ta paraqitur si vetëvrasje. Kjo dukej qartë. Veç kësaj në ndërmarrje u sqarua se makina e shkrimit nuk ishte përdorur asnjëherë prej viktimës. Dikush tjetër e kishte përdorur atë...

* *

Atë ditë, në dhomën e mjekimit të poliambulan-cës hynin e dilnin njerëz. Gra me fëmijë, të rinj e të reja mjekoheshin me kujdes nga infermierja. Për disa minuta dhoma mbeti bosh. Pacientët kishin mbaruar.

— Mund të hyj? — u dëgjua një zë femre, e cila hyri brenda pa pritur përgjigje.

Ajo shtriu parakrahun dhe çpështolli që andej një copë leckë të bardhë. Një e prerë e gjatë kish filluar t'i qelbëzohej.

— Ulu! — i tha infermierja, e cila, si e pastroi vendin e qelbëzuar me një copë garzë, e pyeti:

— Pse s'keni ardhur më parë?

Pacientja uli kokën.

— Gjëra që ndodhin, — tha mjeku, i cili u çua nga karrikja ku ishte ulur. — Shpesh njerëzit tregohen indiferentë kur sëmuren ose kur gërvishten pakëz dhe s'e marrin me mend se kjo mund të jetë me pasoja.

Ai iu afrua pacientes dhe i shikoi krahun.

— Kur e keni prerë? — e pyeti.

— Para tre ditësh — iu përgjigj.

— Gabim, gabim! — tha përsëri ai. — Plaga qenka qelbëzuar. Po me çfarë e keni prerë?

— Po qëroja patate dhe...

— Po, po, e kuptoj, ju rrëshqiti thika dhe ndodhi ajo që ndodhi, — tha ai duke qeshur.

Pastaj ai shkroi në regjistër emrin e mbiemrin, llojin e mjekimit dhe adresën e shtëpisë. U çua. Iu afrua dritares dhe vuri re pacienten me dorë të lidhur. Ajo e prerë në parakrah, në atë formë dhe drejtim ishte e pamundur të shkaktohej duke qëruar patate!

* * *

Në njoftimin e mjekut u gjet një fije e rëndësishme, e cila mund të kishte lidhje me ngjarjen. Gruaja e prerë në parakrah, punonte si magazinierë në të njëjtin vend me viktimën. Pra ata njiheshin me njëri-tjetrin...

Në këtë kohë, një njoftim i ardhur nga grupi i revizorëve që bënte inventarin e magazinës, e që fliste për mungesa të konsiderueshme sendesh në të, na shtroi përpara pyetjen: Mos ndoshta magazinierja, e cila ka qenë në dijeni të vjedhjeve të kryera ose pjesëmarrëse në to, vetë e dytë, ka dashur të zhdukë dëshmitarin? Me cilin mund ta ketë kryer vrasjen?

I shoqi i saj kishte ditë që s'shkonte në shtëpi. Mësuam se ai ishte larguar nga shtëpia afërsisht një ditë pasi ishte kryer vrasja. Ku ndodhej? Nga qendra e punës s'ishte nisur gjëkund me shërbim.

Për ne çdo gjë po qartësohej. Ata, burrë e grua, mund të kishin...

*
* *
*

...Si kaloi grumbullin e njerëzve gruaja ngadalësoi hapat. Ecte si e shkujdesur. Kishte arritur në periferi të qytetit. Në këtë pjesë rruge njerëzit ishin të rrallë. Ajo filloi t'u ngjitej kodrinave me drejtim nga jugë lindja. Si eci edhe pak, doli në rrugën e asfaltuar, që gjarpëronte në atë park të madh kodrinor, pastaj la asfaltin dhe vazhdoi në një udhëz këmbësore mes për mes një lëndine...

Dalngadalë dita po ia lëshonte vendin natës...

...Në heshtjen e natës, dëgjohej vetëm kënga e bulktheve dhe e karkalecave. Ajo eci edhe pak dhe u takua me të shoqin. Ai rrinte i fshehur në kaçube.

— Do të arratisem, — tha ai.

— Pse? Ata s'kanë nuhatur gjë.

— Hë, hë, dyshoj tek ata të policisë. Më duket se ty të kanë lënë të lirë kastile që të vijne në gjurmët e mia.

— Jo, jo!

— Po ata s'e lënë pa e zbuluar vrasjen.

— Po ti, pse e vrave dreqin?...

— Shëët, se na dëgjojnë... Tani thua kështu?!

Pas një procesi të gjatë në hetuesi, vrasësi tregoi plotësisht motivet e këtij krimi, hoqi atë perde që mbulonte veprimin. Ja se çfarë deponoi ai: «Gruaja ime punonte në një ndërmarrje me Qemalin, viktimën. Të dy ishin magazinierë. Ata përvetëso-

nin mallra dhe m'i jepnin mua që t'i shisja. Vjedhjet i bënin shumë të maskuara. Erdhi një ditë dhe ato s'mund të mbuloheshin më. Një gjë duhej bërë. Dhe bashkë me gruan menduam që Qemalin ta zhduknim. Do ta vrisnim në një pozicion të tillë që të dyshohej për vetëvrasje. Unë i propozova gruas që përveç masave të tjera të shkruanim një letër në emër të viktimës, ku të dilte se ai po i jepte fund jetës me vetëvrasje për arsye se ishte përlyer me vjedhje dhe kohët e fundit ndërgegja e vriste shumë. Letrën e përpilova unë, ndërsa në makinë e shtypi gruaja. Letrën nuk mund ta linim të shkruajtur me dorë, se kështu ishte më e lehtë të zbulohesh shkruesi. Pas vrasjes letrën e futëm në njërin nga xhepat e xhakëtës së Qemalit. Kjo pra e mbulonte mirë vrasjen e tij. Të gjitha fajet do të binin mbi atë. Gruaja e solli Qemalin në periferi të qytetit, pasi aty takoheshin shpesh. Aty bëmë... ç't'ju them, ju i dini tani! Kur gruan e thërritën në polici unë u fsheha. Në qoftë se dyshonin për ne, unë do të arratisesha jashtë shtetit. Kështu mendoja atëherë, por çdo gjë u përmbys, ngjarjet rrodhën kundër planeve të mia. Këtë gjë nuk e kisha menduar...»

SHKRUAR E SHTE

GRUJA: ATER

197

2999

ILUZIONI I ARMIKUT

Gazi që shpinte grupin operativ në vendin e ngjarjes fluturonte. Çdo minutë ishte e shtrenjtë. Skënderi, punëtori operativ, vështronte i menduar duart e shoferit, që duke shtrënguar fort timonin kishin djersirë. Duhej të arrinin sa më parë atje, pas maleve, në Varkas, ku pranë një objekti të rëndësisëm kishte rënë zjarr.

Ndërsa grupi operativ u nis nga qyteti, kooperativistët kishin vrapuar andej nga dukej tymi.

Pas disa orëve, duke luftuar me çdo mjet, ata e detyruan zjarrin të nxirrte fjollat e fundit të tymit. Në këtë kohë arriti aty grupi operativ.

Ndërsa kooperativistët u kthven në shtëpi, grupi operativ filloi qyrrjen e vendit të ngjarjes. Sapo kishte filluar të zbardhte dhe sendet në tokë shquheshin qartë. U ndalën gjatë veçanërisht në pjesën ku kishte nisur zjarri. Era e fortë që frynte atë natë i mirrte gjuhët e flakëve drejt objektit. Lufta më e madhe për ta shuar ishte bërë në atë zonë. Vendi ku kishte rënë zjarr për herë të parë ishte i pastër dhe kooperativistët nuk ishin afruar. Kjo e lehtësonte punën e grupit operativ, pasi gjurmët fillestare të autorit të kimit ruheshin.

— Shoku Skënder, një kuti duhani!

Të gjithë u afruan. Mbi bar dukej një kuti du-

hani e bukur e zbukuruar me piktura të moçme. Dhe pak më tej në barin e njomë dukeshin disa gjurmë këmbësh: majat e thyera tregonin drejtimin nga ishte larguar një njeri. Drejtimi ishte nga fshati drejt shtëpisë së xha Shahinit.

Grupi operativ duhej të bisedonte shtruar me fshatarët, të cilët do të hidhnin dritë mbi autorin e krimin. Dhe pikërisht në gjirin e tyre ata u futën për të gjetur arsyet e vërteta të atij zjarri, autorin dhe qëllimin e tij. Që në fillim grupi operativ ngri-ti disa versione. Eksperti, duke kontrolluar gjurmët që të çonin deri në afërsi të shtëpisë së xha Shahinit, pas disa veprimeve të kujdesshme, konkludoi se ato nuk ishin gjurmë të asnjërit prej pjesëtarëve të asaj familjeje. Kjo ishte pikëpyetja e parë. Por kutia e duhanit dhe gjurmët drejt shtëpisë së xha Shahinit e vunë në mendime Skënderin.

Xha Shahini ishte një plak i nderuar. Gjithë jetën e kishte kaluar duke punuar dhe s'para u kush-tonte rëndësi grindjeve të vogla. Ishte patriot, njeri i mirë, që kishte luftuar gjithë jetën për këtë vatan. Dyfekun ai s'e kish hequr nga dora edhe pas Çlirimit. U mësonte të rinjve ç'kishte përfituar nga jeta dhe ata e donin. E donin edhe për arsye se ai ishte një plak me humor. Me shakatë e tij të rinjtë qeshnin me lot. Këto gjëra i dinte punëtori operativ dhe, kur në vendin e ngjarjes u gjetën kutia e duhanit e xha Shahinit dhe gjurmët drejt shtëpisë së tij, ai ra në mendime. Me gjithë se bënë kërkime të mëdha, tej shtëpisë së tij nuk u gjetën gjurmë. Ato humbisnin aty. «Ç'do kutia e tij këtu, pikërisht ku i është vënë zjarri pyllit? Pastaj, po këto gjurmë?... «pyes-te veten Skënderi. Dhe aty për aty vendosi të flasë hapur me xha Shahinin. E gjeti tek dridhte cigare.

Duhanin e mbante në një qeskë plastike. Punëtori operativ pa u vonuar e pyeti:

— Ku e ke kutinë e duhanit, o xha Shahin?

— Plaku vështroi punëtorin operativ në sy dhe e kuptoi menjëherë se pyetja nuk ishte e thjeshtë dhe pa nënkuptim.

— Ma morën. Ka disa ditë, por edhe në fund të dheut ta fshehin do ta gjej. Kuti si ajo nuk ka njeri në të gjithë krahinën

— Ku të humbi? — pyeti punëtori operativ.

— E harrova të flamosurën kur ika nga dyqani, — tha plaku. — Ma morën mendjen këpucët e nipçes, që vazhdon shkollën në Tiranë!...

Pyetjes nëse kishte bashkëfshatarë të tjerë pranë tij kur harroi kutinë, plaku iu përgjigj me një «po», por nuk zuri në gojë asnjë emër.

— Kishin shkuar nja pesë a gjashtë minuta kur m'u shkrep të ndizja një cigare, — shtoi plaku. — E kërkova kutinë por... do ta gjej kush ma ka marrë. Në mos kutinë, urorin do ta gjej patjetër, se është punuar për sevda.

Atë që nuk e tha xha Shahini, i cili, siç thosh-te vetë «nuk donte t'i binte njeriu në qafë kot» e plotësoi shitësi i dyqanit, një invalid lufte.

— Kur doli xha Shahini nga dyqani, unë po këërkoja një palë këpucë për Namikun, — tha ai. — Më hëngri kohë kjo punë, se ky njeri e ka numrin e këmbës 44. Për kutinë e duhanit, që ishte zhdukur e mora vesh kur erdhi plaku dhe e kërkoi. Atë kohë në dyqan ishin... — dhe shitësi nisi të kujton-te bashkëfshatarët e tij...

«Edhe ekspertiza e gjurmëve që dalloheshin deri afër shtëpisë së xha Shahinit nxori se ato ishin gjurma këpucësh Nr. 44», tha me vete Skënderi.

Biseda me xha Shahinin dhe me shitësin e dyqanit sikur qartësoi deri diku kuadrin e mjegulluar. I duhej futur problemit më thellë; duheshin qartësuar shumë pika të errëta, që të mund të formohej i qartë e i dukshëm autori i krimit. Dhe punëtori operativ ndejti shumë ditë midis fshatarëve. Bisedoi me shumë prej tyre dhe mësoi shumë gjëra. Nga të gjitha bisedat pothuajse një gjë ishte e përbashkët: dyshimi binte mbi Namikun, që rridhte nga një familje e dekluar. Dhe kjo ishte arsye.

Një grua i tha punëtorit operativ se Namiku pas një grindjeje me xha Shahinin fliste poshtë e lart se ai plak do ta pësonte, bile keq. «Se për çfarë e kishte fjalën ai, unë nuk e kuptova, por ma merr mendja se ai donte të hakmerrej ndaj xha Shahinit. Me sa kuptoj kjo duhet të ketë lidhje me zjarrin që ra në pyll», tha gruaja.

Edhe një bisedë tjetër. Kësaj radhe ende më qartë dilte krimi i Namikut, ndofta jo drejtpërdrejt. Në të gjitha këto të dhëna biseda e sinjalizime, përmendej grindja e Namikut me xha Shahinin si dhe kërcënimi i të parit. Bile biseda e fundit e punëtorit operativ kishte përsëri lidhje me kutinë e duhanit, por kësaj radhe për atë flitej se ishte në duar të Namikut. Se si, e në ç'rrethana fshatarit nuk i kujtohej, por ishte i bindur se Namiku ia kishte marrë kutinë xha Shahinit. Bile ai shtoi se Namiku, megjithëse hiqej si njeri punëtor, ishte shpirtkeq, përkrahte disa të rinj parazitë, që e kishin mendjen në qytet. «Dëshirat e këtyre, shtoi fshatari, — ai i quantë të drejta, sepse, sipas tij, dëshirat dhe kërkesat e rinisë janë shtuar dhe ata nuk mund të rrinë e të myken në këtë fshat të humbur».

Skënderi ishte futur në burim dhe kishte mun-

dur të dallonte mikrobin e rrezikshëm, i cili përpiqej të infektonte edhe të tjerët. Skënderi kishte tashmë prova të forta. Analizat e kujdesshme provuan se «mikrobi» ishte Namiku. Qëllimi i tij tashmë për Skënderin ishte i qartë si drita e diellit. Dhe ja ç'përfundim dhe tërë kjo analizë...

Namikun nuk ta shaje për punë. Bir i një ish-fshatari të pasur, kur u ngrit kooperativa bujqësore, u grind keqas me të jatin dhe u ndanë. Askush nuk e mori vesh si ndodhi që ai u fut në kooperativë. Ndonjëri thosh se «ndryshuan kohërat». Në gjoksin e Namikut ziente urrejtja për pushtetin popullor, për pronën e përbashkët, për jetën që po lulëzonte. Dhe në sytë e vegjël vetëtinte dëshira për të përmbysur gjithçka. Por ai ishte i zgjuar dhe e kuptonte se duke ndenjur mënjanë nuk mund të bënte asgjë. Dhe ai mendonte se duke rregulluar «biografinë» do të mund të dëmtonte më shumë. Këtu ishte ndryshimi që kishte ai nga i jati, i cili ishte i izoluar. Por ata lidheshin dhe puqeshin në një pikë. Të dy ishin armiq dhe donin të hakmerreshin ndaj jetës së re socialiste që u shoi ëndërrat.

Dhe rasti i erdhi. Pylli me fidane të rinj pishe i therte në zemër. Ai ishte afër një objekti të rëndësishëm dhe, duke i vënë flakën atij, me siguri do të digjej edhe objekti. Me këtë rast, mendonte ai, njolloste edhe xha Shahinin, i cili dikur ishte shprehur kundër pyllëzimit të vendit shkëmbor. Xha Shahini kish thënë dikur se në atë vend vetëm bari kishte lulëzuar. Plaku më vonë ishte çuditur kur kishte parë kurorën e gjelbër me pisha të njoma. «I lumtë rinisë», kishte thënë dhe ishte penduar që dikur kishte qenë kundër zotimit të rinisë.

Namiku kishte pasur një grindje me xha Sha-

hinin. Në fshat diskutohej për një problem dhe Namiku ishte çuar në këmbë e i ishte drejtuar xha Shahinit:

— Na hëngërt shpirtin ju konservatorët! Gjithmonë ju të vjetrit me këto mendime të mykura... Na lini ne të rinjve të ecim përpara, pse na pengoni?

Xha Shahini ishte bërë prush në fvtyrë dhe tërë inat ishte ngritur e me zë të fortë kishte thënë:

— Ti të më thuash mua i mykur, mor pizeveng! Ti, biri i Selim ballistit, me të cilin dikur jam përleshur me armë! Turp të kesh, mor pizeveng, që më hiqesh sikur të digjet xhani për fshatin! Çfarë mendon se do t'i rregullosh kaq lehtë proçkat e Selimit?!...

Namiku ishte fyer shumë nga kjo, dhe hakmarrja e vjetër e klasës iu ringjall më me forcë. Vendosi të vepronte. Do të digjte pyllin, objektin e rëndësishëm, dhe fajtor do të bënte xha Shahinin. Dëshimet do të binin mbi të, se ai nuk kishte dashur dikur të ngrihej ai pyll. Dhe planin e përpiloi me kujdes. I vodhi kutinë e duhanit xha Shahinit dhe, pasi i vuri zjarrin pyllit, e la aty. Kur u largua eci në drejtim të shtëpisë së xha Shahinit. «Qeni i policisë do të drejtohet në shtëpinë e tij. Kutia, gjurmët dhe... vate dhe ajo biografi e mirë, mor xha Shahin matufi...» Mendoi atëhere Namiku.

Kështu ëndërronte atëhere Namiku, por ngjarjet rrodhën kundër planeve të tij.

NDËRGJEGJE

Megjithëse kanë kaluar shumë vite që atëherë, akti që kreu ajo grua nuk më hiqet kurrë nga mendja. Ajo nuk u hodh në valët e lumit për të shpëtuar ndonjë që rrezikohej të mbytej; as u fut në ndonjë shtëpi ku papritmas kishte rënë zjarri, për të nxjerrë që andej foshnjën e mbetur brenda. Jo! Akti i saj i detyrohej ndërgjegjes së lartë proletare.

E quanin Afërdita. Sa u martua, me gjithë kundërshtimet e disa njerëzve nga rrethi i të afërmve, ajo hyri në punë në një oficinë. Punonte si tornitore. Në pak kohë e zotëroi tornon për bukuri. Nga dora e saj dilte gjithmonë punë e cilësisë së lartë. E qeshur dhe e gëzuar si gjithmonë, ajo kish fituar zemrën e kolektivit.

Por një ditë, e para herë që kur kishte ardhur në oficinë, shokët e panë atë të mërzitur. Me gjithë shakatë e një punëtori, fytyra e saj mbeti e zyrtë, e, siç thonë nganjëherë, nuk i qeshi nuri. Shokët, të shqetësuar, e pyetën se çfarë i kishte ndodhur, por ajo, duke kafshuar cepat e buzëve, u përgjigj shkurt se i kishte ndodhur diçka familjare. Ata e dinin se Afërdita nuk hapej lehtë në këso rastesh dhe nuk e pyetën më gjatë.

Kështu kalonin ditët. Askush s'e mori vesh se çfarë tronditje shpirtërore kishte pësuar Afërdita. Por edhe tek burri i saj ata vunë re një ndryshim të tillë. Çudi! Ai çift, të cilin të gjithë e mbanin në gojë për të lumtur dhe e kishin zili, tani bënte një jetë të mbyllur. Njerëzit habiteshin, dhe, kur binte fjala, ngrinin supet duke mos qenë të zot të jepnin asnjë shpjegim. Por, thoshin ata, në këtë mes do të ketë ndonjë gjë, është e pamundur që në atë familje të mos ketë ndodhur diçka.

Ç'kishte ndodhur? Ç'ishte ajo gjë që kish tronditur dy vetë dhe si një krimb po brente një lumturi familjare?

*

* *

Ishte nëntor, muaji i festave të mëdha. Gjithë populli përgatitej për të festuar përvjetorët. Edhe ofiçina ku punonte Afërdita, ishte shndërruar në një uzinë të vërtetë me reparte e pajisje të reja.

Atë ditë, për herë të parë pas kaq kohësh, Afërdita u pa e qeshur dhe e gëzuar. Sekretari i organizatës bazë të Partisë, iu afrua dhe, pasi e përgëzoi për tornon e re, i tha se dëshira e tij dhe e kolektivit ishte që ta shihnin gjithmonë të lumtur e të gëzuar. Por, sapo dëgjoi këto fjalë, ajo u zbeh në fytyrë dhe dy pika lot i rrëshqitën faqeve.

Sekretari i Partisë u habit. Pse u pezmatua Afërdita? Fjalët që i drejtoi ai në emër të kolektivit s'ishin gjë tjetër veçse një urim. Mos vallë në atë urim kishte fjalë nga ato që e goditnin fort atë i kujtonin ndonjë çast që s'i shqitej dhe e trondiste?

— Shoku sekretar, — dëgjoi ai zërin e Afërditës. — Dua të bisedoj me ju. Nuk mund të hesht.

Bashkë u futën në zyrë. Pa u ulur mirë, Afërdita nisi të flasë:

— Ju e keni vënë re që unë nuk jam më ajo e para. Po kështu edhe burri im. Disa herë kam menduar dhe kam luftuar me veten time që t'ia hap zemrën Partisë, por... Tani unë nuk dua të mbaj asnjë të fshehtë dhe do t'ju tregoj se çfarë e ka prishur qetësinë e familjes sonë.

Sekretari dëgjonte me vemendje. Në fillim Afërdita i nxori fjalët si me zor, por pastaj filloi të flasë më lirshëm dhe kuptohej se dalngadalë ajo po çlirohej nga ai ankth i rëndë që e kish munduar prej kohësh.

— Përse s'na i kini thënë që më parë këto gjëra? — e pyeti sekretari.

— Nuk mundja, e kisha të vështirë, — u përgjigj Afërdita. — Por sa më tepër kalonin ditët, aq më e vështirë na bëhej jeta. I thashë burrit që ai të shkonte e të denonconte vetë, por s'pati guxim. Atë që nuk e bëri ai, e bëra vetë. Unë e dua burrin tim, prandaj po e denoncoj.

Të nesërmen, sekretari i organizatës së Partisë, bashkë me Afërditën, erdhën në zyrën time. Afërdita ishte pak më e qetë. Tregoi gjithçka. Sapo ata u larguan, unë kërkova një dosje. Me të vërtetë, në po atë datë që përmendi edhe ajo në rrëfimin e saj, rezultonte se disa kilometra në të dalë të qytetit ishte gjetur kufoma e një djaloshi 23 vjeçar, për të cilin mjeku ligjor në raportin e kqyrjes së kufo-mës konstatonte se vdekja kishte ardhur nga goditja në kokë me një send të fortë.

«Vrasja» figuronte e pazbuluar.

Filluan hetimet në drejtim të burrit të Afërditës dhe të shokut të tij shofer.

Së pari u vërtetua se automjeti me targë... ishte po ai me të cilin ishin kthyer burri i Afërditës dhe shoku i tij që drejtonte makinën.

Së dyti u vërtetua se, në këtë kohë, burri i Afërditës, automjetin e kishte në riparim të mesëm dhe se atë ditë kishte udhëtuar si ndihmëssofer me shokun e tij.

Së treti u vërtetua se, të dy shoferët, ditën e kthimit, ishin paraqitur në punë shumë të tronditur dhe më vonë me ditë të tëra kishin pëshpëritur me njëri-tjetrin.

Në qendrën e punës, për burrin e Afërditësh thoshnin fjalët më të mira. Por kur u pyetën se mos tek ai kohët e fundit kishte ndodhur ndonjë ndryshim shpirtëror, shokët pohuan. Madje ata thanë se atij nuk i qeshte buza më dhe se ishte kthyer në një tip nervoz.

Ndërsa për shokun e tij ata thanë se ishte tip kapadai. Shpesh ishte kapur me pasagjerë pa bileta.

*

*

*

Në fillim u muar në pyetje burri i Afërditës, Agroni:

— Sa herë keni udhëtuar në një automjet me shokun tuaj dhe në çfarë drejtimi?

Agroni mbeti i habitur. U zbeh në fytyrë dhe u përgjigj duke belbëzuar:

— V... v.. vetëm një herë.

— Tregoni, çfarë u ka ndodhur gjatë kthimit,

në mbrëmjen e datës...? Përpara se t'i përgjigjeni pyetjes, kini parasysh gjyqin e ndërgegjes, që të ka munduar prej kaq kohësh...

— Unë, — tha ai, — do të tregohem i sinqertë. Mjaft kam vuajtur. Këtë duhej ta kisha bërë më parë me vullnetin tim. Afërdita, gruaja ime, më ka këshilluar vazhdimisht, por unë kam heshtur.

— Dhe ai pohoi:

— Në mbrëmjen e.... kur do të ktheheshim për në Tiranë, një djalë na doli para në rrugë dhe kërkoi ta merrnim mbi ngarkesë deri në... pasi ai duhej të ndodhej patjetër atje atë natë. Shoku im i nxituar edhe nga të hollat që ofroi djali, pranoi, me gjithë kundërshtimin tim. Kur mbërritëm në atë vend, për të cilin na kishte porositur pasagjeri, ndalua makinën dhe i thamë djaloshit të zbriste, por ai s'na dëgjonte. Dolëm nga kabina, u ngjitëm në karroceri dhe e gjetëm të vdekur. Një arkë me mollë e kishte goditur dhe e kishte përplasur në spondin e automjetit, në qoshe. Na hyri një frikë e madhe. Në fillim menduam se duhej të shkonim në polici për të denoncuar, por shoku im më mbushi mendjen se kjo gjë do të ishte e rrezikshme. «Më mirë ta lëmë në breg të lumit, jashtë qytetit», tha ai. Dhe ashtu bëmë.

Pas kësaj u kalua në pyetjen e shokut të Agronit. Por ai i mohonte të gjitha në mënyrë kategorike. Bile fliste me kapadaillëk, por kjo nuk zgjati shumë. Ballafiqimi me Agronin bëri që edhe ai t'i pohonte të gjitha.

Mua më ka ngelur në kujtesë e shoqja e Agronit, Afërdita, e cila pas një lufte të gjatë shpirtërore, gjeti forca dhe me plot gojën na tha: Unë e dua burrin prandaj e denoncoj...

PIKËPYETJE...

Komandanti i postës së policisë, Ymeri, gjatë gjithë kohës që tjetri fliste, rrinte me kokën ulur, zënë midis dy pëllëmbëve. Disa herë me radhë u mat të pyeste, po e përmbajti veten. Më mirë le të fliste. Tregimi i fshatarit ishte pak i çuditshëm dhe linte, aty-këtu, ca vende të errëta. Ymeri dëshironte të ndriçonte këto. Dhe këtë do ta kishte bërë sikur ta ndërpriste tjetrin dhe t'i drejtonte ca pyetje...

«Le të flasë, tha me vete për të pestën herë, le të flasë. Kur nuk e ndërpret tjetrin, ngjarja rrjedh më qartë...Në qoftë se ka kontradikta në ato që thotë, atëhere»...

Ymeri, nga natyra, vinte pak i rrëmbyer. Ai e dinte se kjo që një e metë. Natyrisht rrëmbimi kishte të bënte me temperamentin, po në artin e hetimit të shpirtit të njeriut, që është aq tepër i koklavitur, plot dritë dhe hije, nuhatja profesionale është e domosdoshme t'i nënshtrohet një logjike të fortë, të përmbajtur...

Ymeri luftonte shumë me vetveten. Ja, edhe tani, kur njeriu i ardhur në postën e policisë denonconte dhëndrin se... Ymeri ndjente t'i qarkullonte me të shpejtë gjaku ndër damarë.

«Puna është ta rrënjos në kujtesë çdo fjalë të tij, çdo hollësi!», thoshte me vete, dhe befas ndjente t'i shpërthenin në kokë një sërë pikëpyetje.

«Prit dhe ca, prit... Duro de!», i thoshte vetes dhe vinte forca të qëndronte i qetë.

Ndoshta Ymeri nuk e kuptonte që kjo valë e ngrohtë, kjo dëshirë e madhe për t'i zgjidhur tërë ato pikëpyetje që i vërtiteshin në kokë, nuk ishte gjë tjetër veçse njëlloj frymëzimi për të hetuar deri në qoshet më të thella të shpirtit të njeriut dhe për të zbuluar të vërtetën. Ku qëndron e keqja këtu? Atëhere ta mjekojmë. Ah, mjeku, e ka shumë më lehtë. Sëmundja fizike, në fund të fundit, është një gjë konkrete. Apo jo?!... Sado i vogël të jetë mikrobi, shkenca e njeh atë. Ai ekziston, në fund të fundit, goftë edhe në madhësinë e atomit... Po difektet morale...

Tjetri heshti. Ymeri ngriti kokën dhe e pa denoncuesin drejt në sy. Po, tani edhe mund ta pyes-te. E kishte dëgjuar mirë dhe qe thëlluar jo vetëm në kuptimin e fjalëve, po edhe në intonacionin e zërit.

— Vajza juaj e di për të shoqin se?... — pyeti Ymeri.

— Po, unë ua thashë që vajza më ka treguar.

— Ç'i duhet pistoleta atij?

— Nuk di!... Thotë se ka një hasmëri të vjetër...

Po ku ta dish!? Ai shoqërohet megjithfarë njerëzish.

— Si jetojnë ata?

— Cilët?

— Vajza me burrin e saj?

— Si me të thanë, më asht' ankue një herë se i shoqi dyshon për nderin e saj.

— Ka dash të ndahet nga i shoqi? — e pyeti Ymeri dhe ndezi cigaren.

— Si me të thanë... Në fillim sikur desh, po mandej nuk ma zunë në gojë këtë punë...

Ymeri u çua dhe shkoi e qëndroi para dritares. Në fushën e gjerë, që hapej rreth e rrotull maleve, kishte zbritur pranvera. Bari që rritur dhe pemët kishin çelur lule. Një vajzë e vogël po mblidhte nëpër fusha manushaqe, kurse ca më tutje bridhnin të gëzuar qingjat e bardhë.

— Jeni i sigurt për këto që thatë? — e pyeti përsëri pa e kthyer kokën.

— Jam.

— Ju kujtoj se... ka rëndësi saktësia e këtyre që thua.

Ymeri u kthye përsëri nga denoncuesi dhe e pa me ngulmë.

— I them me përgjegjësi personale dhe jam gati t'i deklaroj kudo.

Ymerit iu duk sikur fjalët e fundit tjetri i tha me një ton mburrjeje, ndryshe nga ç'kishte folur gjatë gjithë kohës. Ai e vuri re këtë hollësi dhe, kur po ndaheshin me personin që denoncoi mendoi:

«Po përse, xhanëm, mua m'u duk sikur nuk tha të vërtetën? E zëmë se nuk tha të vërtetën. Ç'interes ka që të shpifë? Mos e urren dhëndrin, apo ka ndonjë dallavere tjetër me të bijën! Po të jetë se i ka thënë e bija të jatit që i shoqi mban pistoletë, ajo ka biseduar edhe me të shoqin për këtë gjë... Ndoshta i shoqi nuk ua ka vënë veshin fialëve të gruas dhe ajo e trembur se mos burri do të vriste hasmin e vjetër, i tregoi babait!... Apo u tremb se mos i shoqi do e vriste atë nga që ishte xheloz? Po si i ka thënë vajza të jatit për pistole-

tën që i ka parë burrit? Nga ato që tha del që denoncuesi nuk ka biseduar për këtë gjë me dhëndrin. Atëhere le të besojmë që vajza i ka thënë të jati të denoncojë. Këtë e ka bërë nga frika, apo nga që e urren të shoqin e do të ndahet? Po të donte të ndahej, i jati do të kish qenë dakord, po ajo e ka bërë nga frika. Po a e di ajo që kundër të shoqit do të mirret masë? E di, po nuk ka si t'ia bëjë ndryshe...»

Ymeri doli në rrugë dhe u mundua ta harronte për ca çaste problemin e denoncimit. «Brenda javës sqarohet gjithçka,» tha ai, dhe kaloi pranë shkollës.

Në klasë nxënësit këndonin. Ai desh të mendonte për të birin, që kishte kaluar një grip të fortë, po me vete tha: «A e di që problemi është shumë serioz? Po sikur, brenda këtyre ditëve, ai të qëllojë mbi hasmin? Gjithçka mund të ndodhë!... Ç'u pa atëhere puna jonë?... Bah! Qysh sot do të fillojmë nga puna... Shpejt e shpejt!...»

Ai u kthye prapë në zyrë, bisedoi me shokët dhe, pa e zgatur, mendoj që të bëhej një studim më i hollësishëm i çështjes.



U bisedua me njerëzit e fshatit, të cilët e njihnin mirë, u bisedua edhe me ata ku ai punonte dhe doli se njeriu që denonconte dhëndrin, ishte... Ai sillej keq me gruan, dorëzonte pak të holla në shtëpi, pinte dhe i bënte rrush e kumbulla paratë...

«Po, mendoj Ymeri, ndërsa ishte shtrirë në

shtrat. Ka shumë të ngjarë që ai të ketë shpifur. Po të nisemi nga sinjalizimet mund ta marrim si një gjë krejt të sigurt. Mundet të ketë denoncuar të vërtetën duke menduar që kështu do ta marrim me sy të mirë. Nga ana tjetër nuk arrij të kuptoj si guxoi të shpifë, kur e dinte që shpifja do të dilte në shesh? Apo ka menduar që ne do të dyshojmë për dhëndrin... E ç'do të fitonte nga kjo?...

Ymerit i rrihnin tëmthat dhe i dhimbte koka. Ai kishte disa net që nuk flinte shpejt. Ai dëshironte të zhytej në gjumë, po gjumi nuk e zinte, se nëpër kokë i silleshin mendime.

«Ai nuk është budalla, foli me zë Ymeri. Hë, ai është një dhelpër plakë, që mos e pyet hallin! Ai e di se dhëndri do të kërkojë arsyen e kësaj shpifjeje dhe kur të marrë vesh se një gjë të tillë ia ka bërë i vjehri, do të grindet edhe me të shoqen, e grindja mund t'i çojë në ndarje. Pikërisht këtë kërkon ai. Ai e ka ngritur kurthin jo për të dënuar dhëndrin, por për të futur grindje midis dhëndrit e së bijës. Vrau mendjen e kurdisi këtë lodër»...

Sido që të ishte, puna e kërkonte të informoheshin edhe për dhëndrin.

Një mëngjes, kur vajza e plakut që denoncoi punonte në arë, Ymeri iu afrua dhe e përshëndeti me dashamirësi. Ai e njohu menjëherë. Para ca ditësh kishte biseduar shtruar në shtëpinë e saj me të shoqin.

Edhe të dhënat e fshatarëve për dhëndrin e plakut ishin shumë pozitive. Ata thoshin që është burrë i ndershëm e punëtor i mirë. Ata vetëm psherëtitnin pak kur kujtonin se ai nuk kishte fëmijë...

— Ti ke dashur të ndahesh ndonjëherë nga burri? — e pyeti papritur Ymeri të bijën e plakut.

— Unë?! Jo, hə... Kush ka thënë?

— Babai yt.

Fytyra e vajzës u zbeh.

— Unë s'kam dashur. Baba, po!... Dhe unë s'kam dëgjuar.

— Pse desh ai?

— Se kërkonte të më shiste gjetiu... Kupton?... Të gjitha ato që të ka thënë baba, janë rrena. Unë nuk po fsheh asgjë. Kam qarë dhe vuajtur gjithë këto ditë. Nuk e besoja kurrë që babai të shpifte gjëra të tilla. Dhe u grinda edhe me burrin... A kupton?... Ai u zemërua atë natë kur ti erdhe të bisedoje me ne dhe unë e kyça gojën. Kujtoja se do të mbaronte me kaq.

Ymeri me shumë takt bisedoi gjerë e gjatë me të. Kur ajo u qetësua, u largua për në postë.

«Ka akoma punë, tha me vete; Kanë grindje. Të mendojmë si të gjejmë mënyrën më të mirë që ta shuajmë atë shkëndijë që hodhi ai».

Disa ditë më vonë populli e gjykoi ashpër personin që kishte shpifur.

«Tani ata janë të qetë», pëshpëriti me vete Ymeri, kur u kthye në postë dhe mendonte për një detyrë të re...

PRAPA NJË NGJARJEJE

Kur u nisën për në fshatin e largët malor, ku ishte kryer një vrasje, shefi mori me vete edhe Lefterin, punëtorin operativ të ndjekjes së krimeve, që ende s'e kishte mbushur muajin në detyrë.

«Filloje detyrën me këtë ngjarje», i kishte thënë me dashamirësi oficerit të ri.

Grupi operativ me të mbërritur në vendin e ngjarjes, filloi kqyrjen. Shtëpia ku u gjend viktima ishte e veçuar nga fshati. Duhej të kaloje një përrua që mbushej me ujë nga mali karshi, të ecje nëpër një monopat të zhveshur, të futeshe në një luginë të vogël dhe pastaj të mbërrije në atë shtëpi.

— Dy pleqtë e tij kanë afro 20 ditë që kanë shkuar tek djali në Elbasan. Njerëz të tjerë nuk ka në shtëpi, — i tha sekretari i Partisë shefit, posa mbërritën në oborrin e shtëpisë.

— Çfarë djali ka qenë? — pyeti shefi.

— Punonte dhe sillej mirë. Na erdhi keq të gjithëve. Nuk e dimë si ndodhi, ndonjë grindje nuk ka patur.

Shtëpia ishte përdhese. Dera dhe dritaret ishin të mbyllura. Veçse njëri xham i dritares ishte i thyer. Brenda dukej viktima e mbuluar me jorgan

në shtratin afër dritares. Duhej hapur dera dhe të shikohej çdo gjë me vëmendje. Ajo ishte mbyllur nga brenda me një lloz. Lefteri u fut pas shefit. Eksperti vështronte çdo gjë imtësisht dhe fotografonte. Në mur, përballë shtratit ku ishte shtrirë viktimja, dukeshin njolla gjaku dhe fije flokësh. Afër kokës së viktimës u gjetën dy copa të vogla kallaji, pjesë të plumbit. Duke kqyrur pamjen e jashtme dhe të brendshme konkluzioni dilte menjëherë, por shefi, duke u kthyer nga Lefteri, që ishte përqëndruar i tëri, pyeti:

— Ç'mendon ti, Lefter?

Lefteri u kthye menjëherë nga shefi dhe pa hezituar u përgjigj:

— Të gjitha shenjat tregojnë se ndodhemi para një vrasjeje.

«Por cila që ajo dorë që e kreu krimin, pastaj përse?» pyeste veten Lefteri ndërsa shkante në shtëpinë e Hitos, plakut hokatar, që banonte në periferi të fshatit, jo më shumë se 800 metra nga shtëpia e viktimës...

— Rreth atyre ditëve unë kam qenë në shtëpi, — nisi të flasë plaku Hito. — Në dasmë, që më ftuan, nuk vajta.

— Kur u bë dasma? — pyeti Lefteri.

— Po këtej nga ne, dasmat fillojnë tre-katër ditë përpara se të vijë nusja.

— Në dasmë nuk vajte, xha Hito, po krisma arme dëgjrove gjë atë natë?

— Krisma! — plaku Hito heshti dhe, duke lëvizur pak nga vendi i dha fytyrës një shprehje që ishte e vështirë të përcaktohej në pohonte a mohonte. Pastaj, me një pamje të menduar dhe duke ia ngulur sytë Lefterit, tha:

— Dasmë pa mish e pa krisma këtej nga ne nuk mbahet mend të jetë bërë. — Vështrimi i plakut, toni me të cilin foli dhe qëndrimi dukeshin sikur thoshin: «Qenke axhami, mor djalë, as dasmat nuk i ditke si bëhen? Do të jesh rritur qyteteve ti, e je mësuar me ato dasmat me karamele dhe saze». Plaku Hito nuk e kuptonte se ku donte të dilte Lefteri me ato pyetje. «Vrasësi mos ka shfrytëzuar njërën nga këto net», mendoi me vete Lefteri ndërsa dëgjonte plakun Hito. Plaku në çast, sikur të ishte kujtuar për diçka që duhej ta kishte thënë që në fillim, u kthye nga Lefteri dhe tha:

— Ti je i ri, ke qenë i vogël, ndofta të kanë treguar më të mëdhenjtë. Ishte viti 1945. Një vit kishim që ishim çliruar dhe po atë vit na vranë sekretarin e Partisë të krahinës. Djale po djale ishte...! Na e vranë kriminelët. Dhe një ditë gëzimi na e vranë. Ishte festë atë ditë, e gjëmonin pushkët. Krismat e dyfeqeve të kriminelëve u përzien me krismat e dyfeqeve tanë. Më vonë e morëm vesh që na kishin vranë komisar... se ne komisar i flisnim atij djali. — Plaku Hito heshti, nxori çibukun e mbushi me duhan dhe ra përsëri në mendime. Lefteri e dëgjoi plakun e vjetër dhe sikur iu forcua besimi në mendimin që i kishte lindur në bisedë e sipër me të.

«Po po, mendoi, vrasësi atë natë e ka kryer krimin. Natë më të përshtatshme nuk kishte ku të gjente. Po kush ka qenë ai dhe përse?... pyeste vazhdimisht veten. Por plaku Hito, që e kuptoi tashmë se pse erdhi Lefteri tek ai, ngadalë po i dilte në shteg, atje ku i interesonte aq shumë punëtorit operativ të ndjekjes së krimeve.

— Nuk bisedon njëherë me të bijën e Sefedinit, me Salushen. Bisedo një herë me të. Pastaj hajde prapë tek unë:

— Po pse me atë? — pyeti Lefteri.

— Ajo çoç di, e mbase të hyjnë në punë thënie e saj. Ka shoqëri të madhe ajo me Zenepen, të bijën e Nuros.

— Xha Hito, po i bie rrotull e rrotull muhabetit. Nuk më flet më troç?

— Unë jam plak dhe s'dua të hyj në gjynahe në pleqëri, prandaj bisedo njëherë me vajzën që të thashë, pastaj hajde prapë tek unë.

— Po mirë, o xha Hito, — tha Lefteri — më thuaj ndonjë gjë, të di dhe unë si t'ia hap bisedën. S'mund të vete derr në thes.

— Zenepja, shoqja e Salushes, është e fejuar; e ka fejuar i jati që të vogël. Por flitej se sikur ishte ngatërruar me të shkretin Jashar, që iku e vate. Po i jati i Zenepes është palo burrë, ballist ka qenë e ballist ka ngelur në mendime. Edhe me fëmijët do të bëjë tregti. Është më mirë të thuash se Zenepen e ka shitur e jo e ka fejuar. Po bisedo njëherë me Salushen se ajo mund të dijë më shumë, shoqja me shogën hapen.

Lefterit i ndritën sytë. Plaku Hito e kishte orientuar mirë...

«Mbështetuni vazhdimisht tek populli, tek njerëzit e thjeshtë. Ata të ndihmojnë, ata janë burim i paçmuar». Lefterit i gjëmuan në vesh këto fjalë të pedagogut të shkollës, i cili i përsëriste vazhdimisht...

— Po, — nisi të flasë Salushja. — Zenepja e ka dashur Jasharin. Këtë e mori vesh edhe i jati.

U bë si i xhindosur. E kërcënoi bile edhe e goditi rëndë. Këto gjëra m'i ka thënë vetë Zenepja.

— Po ndonjë gjë tjetër të ka thënë? — pyeti Lefteri.

— Më ka thënë shumë gjëra, po kush i mban mend tani! Vetëm dua t'ju them se Jashari ishte një djalë shumë i mirë. Kohët e fundit i kishte thënë Zenepes se donte të bisedonte me babanë e saj. «Le ta prishë fejesën me atë njeri që ti as që e njeh. Babait do t'i mbushet mendja», i kishte thënë ai. Zenepja i ishte përgjigjur «që ashtu të mos veprohte kurrë, pasi babai është neverik dhe mund të bëjë ndonjë gjë». Kaq, më vonë ai u gjet i vrarë...

— Mirë, mirë.... Po... pasi u muar vesh se Jashari u vra, u takove me Zenepen? — pyeti Lefteri.

— Po, — u përgjigj Salushja, — po, unë i vajta në shtëpi. Kujtoja se nuk e kishte marrë vesh. Aty më tha se e dinte.

— Çfarë të tha? — pyeti përsëri Lefteri.

— Ç'të më thoshte? Ishte pikëlluar dhe qante e nuk pushonte. Ah po, se desh harrova! Ajo, duke më vështuar në sy, foli sikur më pyeste: «Mos e ka bërë babai këtë gjë?». «Po pse babai yt?» e pyeta e habitur unë. Ajo qante vazhdimisht dhe me ca fjalë që mezi i nxirrte tha: «Ai do ta ketë bërë, se kështu më ka kërcënuar. Po të mos hiqnim dorë do të na bënte ai të hiqnim. «Do ta vras atë Jashar vagabondin», më tha njëherë.

Lefteri dëgjonte Salushen dhe mendja i shkonte tek plaku Hito, tek ato pak fjalë që ndërtuan atë historinë e dhimbshme të vitit 1945 e që krijonin një lidhje me dasmën dhe vrasjen e Jasharit. Dëgjonte punëtori operativ dhe në mendjen e tij po rikrijohej tabloja e kryerjes së krimit. Ajo tani

për tani ishte e turbullit, mungonin akoma shumë gjëra që do të çonin në një konkluzion mbi dorën që kreu krimin dhe arsyet. Biseda me Salushen sqaroi shumë pika. «Po në dasmë, ka qenë vallë Nurua? Në qoftë se ka qenë në dasmë, a është larguar në ndonjë rast? Nëqoftëse është larguar, ku ka ikur?»... Këto pyetje Lefterit i rëndonin më shumë se çdo gjë tjetër. Gjithë ato ditë kishte bërë një punë të mirë, ishte konsultuar vazhdimisht me shefin e tij, bashkë kishin përcaktuar edhe punën që do të bëhej në të ardhmen. Shefi nga ana e tij ishte i kënaqur nga puna e Lefterit. Nga eksperiencia e gjatë, ai e ndjente se Lefteri, megjithëse për herë të parë, ishte futur plotësisht në terrenin e përshtatshëm që i duhej për të vepruar.

Nga biseda me të zotën e shtëpisë, ku ato ditë ishte bërë dasma, Lefteri mësoi se Nurua nuk ishte i ftuar nga ai. Veçse ditën e shtunë, një ditë para se të vinte nusja, ai kishte ardhur aty nga ora 1 pas mesnate. «Unë e pashë që hyri brenda, dhe të them të drejtën, nuk më erdhi mirë, por, thashë me vete, fshatar i yni është, e megjithëse ka qenë ballist nuk më harxhon me një thellë mish. Tani që hyri s'mund ta ndjek. Pastaj iu afrova se e pashë që s'ishte mirë në fytyrë. Mendova se i kishite ndodhur gjë «Mirë se erdhe, i thashë, urdhëroni...» Ai më zgjati dorën (vura re se ajo i dridhej), dhe, pasi më uroi për djalin që martoja, u fut brenda. Ndejti afro një orë dhe u largua. Më bëri përshtypje ardhja dhe largimi i tij. Dasma kishte arritur kulmin dhe ndonjë gjysmë ore përpara se të vinte ai, vëllai qëllloi me dyfek katër a pesë herë. Ne e dimë që është e ndaluar të qëllosh po nuk e mbajtëm dot vëllanë. Ishte bërë në qejf. Ah, për

pak më doli nga mendja! Kur erdhi, Nurua më tha se kishte dëgjuar armë dhe i kishte dalë gjumi.

«Pra atë natë që është kryer vrasja, Nurua ka dalë nga shtëpia», mendonte Lefteri. Jo më vonë se tri orë nga biseda me fshatarin që kishte bërë dasmën, mësoi dhe një gjë tjetër interesante. Pasi u hap fjala në fshat se Jashari u gjet i vrarë, Nurua u interesua që ai të varrosej sa më shpejt, bile, ndihmoi dhe në hapjen e varrit. Më vonë ai interesohej në fshat se për kë dyshohej dhe përse.

«Struci, duke futur kokën në rërë, mendon se i shpëton rrezikut», tha me vete Lefteri. Pasi u hartua një plan i hollësishëm u vendos që Nurua të pyetej. Lefteri, duke dëgjuar Nuron që fliste, ndjeu kënaqësinë e realizimit me sukses të detyrës së parë si punëtor operativ i ndjekjes së krimeve.

Nurua në fillim s'deshi të pranonte asgjë, por e mposhtën faktet. Rrinte si i ngrirë para hetuesit, që e shikonte gjakftohtë dhe fliste. Pranoi se e vrau Jasharin me një pushkë që e mbante të fshehur qysh nga koha e luftës. Krisma nuk tërhoqi vëmendjen e askujt, pasi atë natë qëlluan edhe dasmorët. E quajti Jasharin «vagabond», njeri që ngatërrohej me një vajzë «të fejuar»...

— Ruajta nderin e familjes, — tha më në fund dhe fshiu djersët.

Pandehu se gjithçka shkonte sipas planit të tij, por hetuesi përsëri e mposhti. Ia faktoi që vajzën ai e kishte shitur për një shumë të madhe të hollash, megjithëse ajo s'pranonte të fejohej. Edhe krushqit e kishin kërcënuar, në rast se do të prishej fejesa...

Jo, Nurua s'mund të dredhonte më. E kuptonte se ishte mposhtur përfundimisht, ndaj ndjente nxehtësi dhe të rrënqethura në gjithë trupin. Ai kishte vrarë një njeri të pafajshëm dhe do të përgjigjej për këtë krim të rëndë para ligjës...

OPERATIVI ÇLIRIM ÇETA

Në një rajon të policisë në qytetin e Tiranës u paraqit një ditë qytetari K dhe lajmëroi se vëllai i tij kishte humbur, ishte zhdukur pa lënë gjurmë prej më se dy javësh dhe as në familje, as në fshat, s'dinin gjë për fatin e tij.

E pyetën se ku kishte punuar herën e fundit dhe K-ja kishte dhënë sqarime se vëllai i tij, Refiku, atë verë, së bashku me një bashkëfshatarin e tij, Ali Shqopën mbledhnin bimë mjekësore në një mal afër Tiranës, ku ishte zbuluar sanxë, një bimë e leverdisshme mjekësore, që siguronte shumë të ardhura.

Qytetari K shtoi se vëllai i tij para se të zhdukej, i kishte shitur edhe kalin bashkëfshatarit të tij, Aliut. «Këtë e di se ma ka thënë vëllai kur u nda nga unë. Ai kishte ndër mend të shkonte në fshat. Po bëhet dy javë që jemi ndarë dhe në fshat s'është dukur. Ç'u bë? Ç'ka ngjarë më këtë njeri? Në shtëpi gruaja dhe fëmijët po e presin».

Punëtori i policisë e pyeti për veshjen, nëse kishte ndonjë gjë karakteristike që mund ta identifikonin. Qytetari K. tha, veç të tjerave, se Refiku kishte një gëzof lëkure të bardhë, të cilin e për-

dorte për t'u mbrojtur nga e ftohta kur flinte përjashta në mal.

Pyetjes nëse Refiku kishte ndonjë hasmëri të vjetër, nëse qe grindur me njeri, nëse dyshonte për gjë, qytetari K iu përgjegj duke ngritur supet.

Me kaq biseda mori fund.

*
* *
*

Organet e policisë dhe të hetuesisë u vunë menjëherë në lëvizje. Një raport i hollësishëm iu përcuall degës së punëve të brendshme të rrethit D., ku ë kishte fshatin «personi i humbur» në mënyrë që edhe andej të bëheshin hetimet e rastit.

Kryetari i degës. Banush Shkurti, bëri një mbledhje të posaçme për këtë çështje dhe, më së fundi, ngarkoi operativin e zonës, Çlirim Çetën, që të merrej posaçërisht me sqarimin e çështjes.

Dhe Çlirimi iu vu punës me pasion e seriozitet, ashtu sikurse e kishte zakon.

«Duhet ta fillojmë atje ku është këputur hallka, atje ku humbin gjurmët, mendoj, dhe me siguri duhet të gjejmë diçka.»

Kjo çështje kishte filluar ta tërhiqte. Ai e njih-te Refik Sadrinë dhe gjithmonë i qe dukur burrë i drejtë, punëtor dhe fjalëpakë. Refiku punonte në kooperativë, kujdesohej për fëmijët, për gruan, dhe me njerëzit e tjerë shkonte mirë. Rridhte nga një shtresë shoqërore e varfër dhe në kohën e luftës kishte qenë i vogël.

Çlirim Çeta vajti në rrethin e Tiranës, ra në kontakt me shokët e vet dhe filloi të pyeste fsha-

tarët e zonës, duke u treguar fotografinë e Refikut nëse e kishin parë gjatë verës.

Doli se dikush e njihte dhe e kishte parë së bashku me dy vëllezërit Ali dhe Selman Shqopën. Ai tregonte se i kishte takuar duke mbledhur bimë mjekësore. Pastaj tha se herën e fundit Ali Shqopën e kishte takuar para shtëpisë vetëm, hipur në kalë. «Që atëhere s'e kam parë më», e përfundoi rrëfimin fshatari nga rrethet e Tiranës. «Këtu gjatë verës kanë ardhur shumë njerëz, — shtoi ai. Unë s'i mbaj mend nga fytyra pasi ata kanë qenë shumë dhe mua s'më lidhte puna me ta...»

«Sidoqoftë, tha Çlirimi me vete, këtu diçka do të ketë dhe ky fshatari na dha në dorë një fill fare të vogël. Me Aliun paska qenë dhe i vëllai. Duhet ta pyesim edhe këtë, e të dëgjojmë se ç'mund të na thotë e ç'di për çështjen...»

Selman Shqopa tha se ai vente herë pas herë në mal me ta po më shumë rrinte në qytet. «Herën e fundit, unë ika në Tiranë dhe lamë fjalë t'i gjeja aty te shkëmbi, pranë një burimi me ujë, ku mblidhnim bimë mjekësore. Kur u ktheva pas dy ditësh, s'gjeta as njërin as tjetrin. Pyeta andej-këtej dhe më thanë se Aliu kishte shkuar në fshat kurse Refiku, vëllai kishte zbritur në qytet».

Çlirimi po e dëgjonte me vëmendje. Kishte të ngjarë të ishte dhe kështu, sadoqë një fije e lehtë dyshimi i endej nëpër mend.

— Kë pyetët? — i tha Çlirimi.

— Fshatarët që gjeta në pyll.

— Mban mend emrin e ndonjërit prej tyre.

— Jo s'i kisha parë ndonjëherë — u përgjigj Selmani. Këtë shteg ai e mbylli dhe Çlirimi s'kishte si ta verifikonte me kë që takuar dhe nëse ishte e vërteta tamam kështu.

Çlirimi mendoi se rruga tjetër ishte të kërkonte gjurmët e Refikut në qytetin e Tiranës, prandaj e pyeti Selmanin se te kush vente Refiku, te kush fiinte e cilin njihte.

Selmani iu përgjigj se Refiku kish disa kushërinj të largët. Çlirimi mbajti shënim emrat e kushërinjve, sepse dëshironte t'i pyeste, nëse e kishin parë Refikun muajt e vjeshtës.

Pastaj Çlirimi e drejtoi bisedën si e kalonin jetën, ku flinin, me se mbulohehin, çfarë rrobash kishin.

— Çfarë rrobe solli në shtëpi vëllai? — e pyeti Çlirimi.

Selmani filloi t'i numëronte me radhë: një shkorsë, një velenxë të shkurtër me thekë, e të tjera vogëlsira.

— Po gëzof lëkure të bardhë, ka yt vëlla?

— Më duket se i kam parë një gëzof të tillë në shtëpi.

Çlirimi e nënvizoi këtë fakt, si tek një objekt që meritonte kujdes dhe tek i cili duhet të kthehej me domosdo. Duhej sqaruar nëse kishte vërtet gëzof dhe kujt i përkiste. Kishte të ngjarë që Aliu ta kishte blerë vetë në qytet, në ndonjë dyqan fshati ose nga ndonjë fshatar.

Çlirimi punonte i udhëhequr nga logjika dhe nga vlerësimi i fakteve.

Grupi operativ, përpara se Çlirimi të niste gjurmët e kërkimit në qytet, shkoi në vendin ku Refiku dhe vëllezërit Shqopa kishin mbledhur bimë mjekësore dhe bënë një kqyrje të hollësishme me shpresë se do të gjenin diçka që t'i ndihmonte sadopak. Asnjë shenjë s'dukej. Filladi frynte mbi lulet dhe barishtet, zogjtë fluturonin nga njëra pemë tek

tjetra, shumë të huaj për këtë ngjarje, dhe larg shqetësimeve të grupit operativ.

Çlirimi u interesua pranë kushërinjve të Refikut në Tiranë e të gjitha hotelet, por emri i Refik Sadrisë nuk figuronte asgjekundi. Në Tiranë s'ishte parë veçse në muajt e verës. Dëftesa e fundit nga qendra e grumbullimit mbante datën 20 korrik 1961.

*
* *
*

Në fshat vazhdonin diskutimet për humbjen pa gjurmë të Refik Sadrisë. Hipotezat më të çuditshme shkonin gojë më gojë: dikush thoshte se qe martuar në qytet me ndonjë vejushë. Dikush tjetër se mund ta kishte ngrënë ndonjë kafshë e egër në pyll; dikush thoshte se qe mbytur e disa të tjerë se kishte zënë punë në një kantier. Mbase shkuan disa kohë dhe ai s'u bë i gjallë, as me lajme as me letër, dikush tha se Refikun do ta kenë vrarë dhe dyshimet ranë mbi Aliun dhe Selman Shqopën. Këta njerëz duhej të dinin për fatin e tij.

Çlirim Çeta dëgjonte diskutimet, kërkonte motivet dhe pyeste pse mund ta kishin bërë këtë gjë. A kishte në mes ndonjë çështje nderi, zënke ose armiqësie? Disa thoshin se mund ta kishin bërë për ta grabitur, po këtë e kundërshtonin shumë veta.

Kishte shumë vjetë që vrasje me motive të tilla s'kishin ngjarë më në atë krahinë. Ato i përkisnin kohës së Turqisë, kohës së Zogut dhe asaj të pushtimit fashist, kur keqbërës e kriminelë profesionistë të vrisnin në rrugë për një palë këpuccë të mira, po në pushtetin popullor u ishte prerë

rruga me kohë këtyre lloj krimeve. Deri sa kishte punë për të gjithë, domethënë se të gjithë kishin të ardhura dhe e siguronin jetesën pa pasur nevojë të rrezikonin jetën e tyre duke marrë rrugën e kriminit.

«U zhduk si fenomen, po kjo s'do të thotë se tek ne s'ka individë parazitë, egoistë, mashtronjës e keqbërës», kujtoi Çlirimi fjalët e Banush Shkurtit.

Në fshat nuk flisnin mirë për Ali Shqopën, sepse qe gojë ndryrë, grindavec dhe tepër i dhënë pas interesit material, por vetëm me disa dyshime anësore s'ke si të vësh dorë dhe ta bësh përgjegjës për një krim. Me siguri ai do ta mohonte dhe duke mos patur në dorë asnjë provë materiale, do të dilte i pafajshëm.

Në mbledhjen që bëri për punën e deriatë-hershme grupi operativ i analizoi të gjitha faktet që kishte mbledhur operativi Çlirim Çeta. Gjurmata humbisnin dhe gati-gati po arrinin në një pikë të vdekur.

E vetmja dritëz e vogël në këtë errësirë mbe-tej gëzofi i bardhë prej lëkure, për të cilin, vëllai i Aliut, thoshte se e kishte parë në shtëpi të të vëllait.

— Çlirim, na e sqaro plotësisht këtë punën e gëzofit — i tha Banush Shkurti.

*
* *

Çlirimi u kthye sërish në zonë duke vrarë mendjen si mund ta shtinte në dorë atë gëzofin e

bardhë prej lëkure. Po ta shtinte në dorë e kish më të lehtë detyrën, mjafton të vinte me të te familja e Refikut dhe t'u thoshte familjarëve dhe të vëllait nëse i përkiste viktimës.

Ai i qe futur me dëshirë e pasion punës së vështirë të operativit të zonës dhe tani përvoja dhjetëvjeçare i kish treguar se supozimet dhe hipotezat, që të kthehen në fakte e prova materiale, kërkojnë zgjuarsi, takt, guxim dhe lodhje mendore e fizike. Disa herë ia kishte dalë me sukses dhe Banush Shkurti, sadoqë fjalët i kish shumë të kuresyera, e kishte lavdëruar në një mbledhje.

Çështja e gëzofit i kishte mbetur në mend.

«A mund të vërtetohet, mendoj Çlirimi, nëse në familjen e Shqopajve ka ndonjë gëzof? Selmani pranoi se ka. Po ai natyrisht do ta ketë biseduar me Aliun dhe mund ta kenë zhdukur».

Një brigadiere, vajzë shumë e mirë dhe komuniste, që hynte e delte për shkak se kishte miqësi me një nga nuset e shtëpisë së Shqopave, i tha Çlirim Çetës se ajo, para disa ditësh, kishte parë në shtëpinë e tyre një gëzof të bardhë prej lëkure po kohët e fundit s'ia kishin zënë më sytë.

Nisi çështja penale edhe nga ana e prokuroresë së rrethit. Pas një muaj hetimesh dhe në sajë të provave të grumbulluara, u vendos që Ali Shqopa të pyetej për fatin e viktimës. U pyet edhe Selmani po këtë herë ai i mohoi thëniet e para dhe deklaroi se s'kishte parë gëzof me sy.

Ali Shqopa thoshte se me Refik Sadrinë qe ndarë shumë kohë përpara në Bizë të Martaneshit dhe më s'e kishte parë.

Hetuesi e pyeti:

— Ke pasur një gëzof lëkure, a mund të thuash se ç'e ke bërë?

— Nuk kam pasur ndonjëherë gëzof dhe as që kam sjellë në shtëpi ndonjë gjë të tillë.

Por kjo binte në kundërshtim me thëniet e të vëllait dhe të brigadieres.

Gjatë bisedës, Ali Shqopa i ndryshonte herë pas herë thëniet e tij. Atij i kujtohej se kishte patur një gëzof, por këtë e kishte sjellë Selmani dhe jo ai vetë.

Këto të dhëna tregonin se këta ishin në dijeni për fatin e viktimës, por për hetuesin akoma nuk ishte e qartë nëse qenë bashkëpunëtorë apo vetëm njëri prej tyre që fajtor. Duhej bërë ç'ishte e mundur për t'u gjendur kufoma... Sipas gjithë të dhënave, ajo duhej të ishte diku në afërsi të rrugëve që dalin nga pyjet e Bizës drejt krahinës ku e kishin banimin Shqopajt.

Pas shumë kërkimeve, kufoma u gjend anës një përroi e mbuluar me dhe, gurë e harthje, që të mos dallohej gjërmimi i dheut...

*
* *
*

Grupi operativ bëri një kontroll në shtëpinë e Shqopajve me shpresë se mos gjente gjurmët e gëzofit të bardhë, por kjo s'dha asnjë përfundim.

Çlirim Çeta filloi të pyeste disa komunistë të fshatit në se mund të gjendeshin gjurmët e gëzofit të bardhë. Disa u treguan skeptikë e thanë se një gëzof mund të zhduket kollaj duke u djegur, disa të tjerë thanë se ka mundësi ta ketë shitur larg fshatit kurse shumica qenë të mendimit se Aliu

do ta kishte shpënë në shtëpinë e të vjenrrit ose do t'ia kishte besuar atij për ta fshehur.

Me Zenunin, vjehrrin e Ali Shqopës, Çlirimi vendosi të bisedonte vetë. Ai e njihte prej shumë vjetësh plakun dhe e dinte se ishte një njeri i drejtë.

Takimi i tyre ishte i ftohtë. Çlirimi e kuptoi se plaku u zbeh në fytyrë kur i shtërngoi dorën.

— Na kanë vrarë Refikun. — i tha Çlirimi dhe e shikoi me vëmendje. — Dje gjetëm kufomën...

Plaku s'foli. Kishte ulur sytë përdhe dhe diçka mërmëriste.

— Të takova vetëm për të të bërë një pyetje. A të ka dhënë Aliu ndonjë gëzof të bardhë për ta fshehur?

Pas kësaj ra heshtja. Zenuni s'e kishte të lehtë të ngrihej kundër dhëndrit të tij. Por ndërgjegjja s'e linte të qetë dhe foli. Ai tha se dhëndri i kishte sjellë një natë një gëzof duke e porositur ta fshih-te me kujdes.

«— Mos më ngatërro mua me këto punë! — i kundërshtova dhe s'desha të përzihesha, po Aliu ma priti:

— Ç'të mirë do të ketë vajza jote dhe ti, po të burgosem unë?

Atëhere e mora gëzofin dhe me porosi të Aliut e fsheha larg shtëpisë nga frika se mos ma shikonte dikush që e njihte.»

Zenuni tregoi se e kishte fshehur në cepin e një are.

Grupi operativ, së bashku me Zenunin, e nxuarën nga dheu provën materiale më të rëndësishme. Pohimet e të vjehrrit e kishin bërë edhe më të qartë fajtorin e vërtetë.

I vënë me shpatulla në mur, Ali Shqopa filloi të rrëfente:

«Kjo ngjau një natë korriku pa hënë. Ndo-dheshim nja dhjetë kilometra larg vendit ku mbli-dhnim bimë mjekësore, sepse kishim marrë rrugën e kthimit për në shtëpi. Vendosëm të flinim në pyll. Kalin ia kisha blerë Refikut dhe paratë që i dhashë i kishte në xhep. Atje mbante edhe ato të tjerat që kishte nxjerrë nga shitja e bimëve mje-kësore. Mendova: «Po sikur ta vras dhe t'i marr pa-ratë, kush do të më shikojë këtu në mes të pyllit në mes të natës?». Edhe kur u nisëm për rrugë, nuk na pa njeri bashkë, se unë u nisa pak më përpara me kalë. Kështu i vajta natën pranë dhe i rashë me cakore në kokë. E hoqa mënjanë dhe e mbu-lova pranë një përroi me veglat që kisha. Veglat e tij i hodha në lumë. Pastaj mora rrugën e kthi-mit, veç bëra gabim që i mora dhe gëzofin e bar-dhë. Ky gëzof më pëlqente shumë dhe unë doja të trilloja diçka gjoja sikur e kisha blerë nga Re-fiku, që ta mbaja vetë, po pastaj kjo m'u duk e rrezikshme dhe hoqa dorë. Shpresoja se do t'ia gjeja anën. Po kur dëgjova nga vëllai se kishte tre-guar në polici qysh herën e parë për këtë gëzof, vendosa ta zhdukja. Kështu ia shpura Zenunit, dhe i thashë ta fshihte sa më mirë pa i treguar kujt. Ai e futi në një kosh plehu dhe e fshehu në arë...

— A mos të thotë mendja se po ta kishe zhdukur gëzofin, krimi nuk do të qe zbuluar? — e pyeti hetuesi.

Ali Shqopa ngriti supet.

Si duket ai harronte se çdo keqbërës, duke u munduar të fshehë gjurmët, lë gjurmë të tjera.

ME SHPATULLA NË MUR

— Alban! Të kërkon kryetari!

Ai që foli e uli receptorin.

Albani u çua përnjëherësh dhe mori xhakëtën verore. Trokiti në zyrën e kryetarit të degës dhe hyri brenda.

— Ulu, — i tha kryetari, sapo Albani mbylli derën.

Pasi grupi operativ mori porosinë dhe detyrat, doli nga zyra. Jashtë priste «Gazi». Pjesëtarët e grupit i hipën makinës dhe u nisën. Nuk flisnin.

Gazi rendte nëpër rrugët tërë pluhur.

— Ku do të ndalim? — pyeti shoferi.

— Te kisha, — tha njëri prej anëtarëve të grupit.

Të tjerët heshtën. Pas pak «Gazi» mori kthesën. Shoferi frenoi. Ata bënë ca hapa e u kthyen majtaz. Koskat ishin aty, midis grumbullit të gurëve. Mjeku u përkul dhe i këqyri me vëmendje. Pastaj duke u drejtuar mërmëriti:

-- Koska njeriu janë.

— Bariu nuk paska gabuar në përcaktimin e tyre, — thanë të tjerët.

— Kafka i qenka shtypur, — shtoi mjeku.

Koskat i mblodhën në një thes dhe i muarën në makinë.

«Gazi» vrapon në rrugën nga erdhi. Aty brenda bisedohet për ato koska të çuditshme. Të kujt mund të jenë?

Albani ishte mbështetur në karrike dhe në duar kishte përfundimet e ekspertizës mjeko-ligjore. S'dihet për të satën herë shkoi ndër mend: «Gjatësia rreth 1 m e 75 cm., gjinia mashkullore, flokët të zinj, mosha 29-30 vjeç. Vdekja duhet të ketë ndodhur tre-katër muaj më parë»...

Pastaj drejtoi trupin dhe të dhënat e ekspertizës i futi në dosje. «Kush është dhe nga se ka vdekur ky njeri?

Kanë lajmëruar se nga fshati N... mungon Mikel Marku. Dhe ai mungon pikërisht qysh atëhere. Sa të vërteta janë fjalët që janë hapur sikur... ai... Koincidençë është kjo?!...»

Hetuesi brofi nga karrikja. «E çuditshme, gati sa nuk thirri fort. Por filli duhet kapur këndej».

Të nesërmen rrugës për në fshatin N... ecte një njeri. Ai shpejtonte.

Ishte hetuesi.

Në shtëpinë e Markajve hyri Albani. Në dhomë ishin një grua dhe një djalë rreth të shtatëmbëdhjetave.

— Urdhëroni! — e ftuan ata mysafirin.

Pasi u përshëndetën, Albani u ul.

— Jam Alban Dibra, hetues i degës, — u paraqit ai.

Djali dhe gruaja u stepën pak. Me ndrojtje ajo u paraqit si e shoqja e Mikelit dhe djali si vëllai i tij.

— Mbase ju lëndoj një plagë, — nisi hetuesi bisedën, — por nuk ke ç'i bën. Ju keni lajmëruar se burri juaj mungon, dhe se...

Gruaja uli kokën e turpëruar. Pastaj tha:

— E ku ta dimë të vërtetën? Kështu janë përhapur fjalë në fshat dhe kështu duhet të jetë. Fjalët zakonisht nuk dalin kot.

Albani heshte.

— Kur është larguar për herë të fundit burri juaj nga shtëpia dhe ku ka shkuar?

— Në qytet. Atje kishte ca shokë. Njëri prej tyre na vinte dhe në shtëpi. Bile kam edhe një fotografi. — Ajo u çua hapi një valixhë, mori që andej diçka dhe ia vuri përpara hetuesit.

Albani po e këqyrte me vëmëndje fotografi-në. «Sipas fotografisë flokë të zinj dhe rreth 1,75 cm. i gjatë», mendoi ai.

— Atë ditë që iku, këtë xhakavento kishte veshur? — tha hetuesi duke treguar fotografinë.

— Po, — ndërhyri i vëllai i Mikelit. Një xhakavento të tillë ia kam parë para pak kohësh në qytet këtëj tjetrit që shihni në fotografi. E quajnë Alfred.

Albani pyeti për ca gjëra të tjera dhe doli. Gruaja dhe djali kishin qëndruar në prag të derës. Diçka e madhe u rëndonte në shpirt.

«Pse u largua nga puna, Alfred Cikoja pikërisht kur u zhduk Mikeli? Po xhakaventoja? Mikeli s'duhet të jetë...» Hetuesit i shkuan ndër mend ato fjalë që ishin përhapur në fshat.

Pas dy ditësh, Albani po udhëtonte për në qytetin fqinj. Zbriti nga autobuzi dhe zuri vend për të fjetur në hotel. Pasi pushoi nja dy orë, u ngrit. U la, u vesh dhe doli. Atë pasdite kishte orar zyrtar. Albani mori rrugën për në degën e punëve të brendshme të qytetit. Atje u interesua për Alfred Cikon. Mësoi se Alfredi ishte traktorist në SMT, se rridhte nga një familje e pasur në të

kaluarën dhe reaktionare gjatë viteve të pushtetit popullor dhe se bënte një jetë të çrregullt.

Atje ai hetoi edhe për xhakaventon.

Pas një jave, në zyrën e hetuesit hyri një grua.

— Desha të më ndihmonit në një gjë. — Pas pak Albani hodhi mbi tavolinë gjashtë xhakavento.

— A njihni ndonjë? — pyeti Albani.

Gruaja i pa dhe kapi njërën:

— Po, kjo është e tim shoqi! Kjo është e tija!

Gruaja u ngrit dhe doli nga dhoma. Brenda hyri vëllai i Mikelit. Xhakaventot ishin mbi tavolinë.

— Njihni ndonjë të tjerë nga këto? — e pyeti hetuesi.

Djaloshi i ngriti ato me radhë dhe një të tjetër nuk e lëshoi.

— Kjo është e Mikelit, — tha djali. — Këtë kishte veshur Alfred Cikoja atë ditë.

Gruaja dhe djali kishin zgjedhur të njëjtën xhakavento.

«Ja dhe prova materiale», mendoi hetuesi.

.....

— Ulu, — i tha hetuesi të pandehurit.

Tjetri u ul ngadalë në karrike. U mbështet në shpinëzën e saj dhe ia nguli sytë hetuesit.

— Mund të më jepni një cigare?

Hetuesi, një burrë i shkurtër, rreth të dyzetave, nxori një «Diamant» dhe ia zgjati.

I afroi pastaj çakmakun, për t'ia ndezur.

I pandehuri e thithi cigaren fort. Pasi i hodhi një sy dhomës, vështrimin e përqëndroi mbi tavolinë. Në të majtë të hetuesit ishte dosja. «Asgjë nuk dinë, asgjë. Dhe as që kanë për të nxjerrë gjë nga unë», mendoi. E thithi prapë cigaren. Dosja

që rrinte mbi tavolinë, i ngjallte në shpirt një ndjenjë të ftohtë.

— Keni punuar në qytetin tonë?

— Po. Para katër muajsh, si traktorist. S'e kuptoj se ç'lidhje ka ky fakt me këtë që unë jam i arrestuar. Mos vallë është e ndaluar të shkosh nga një qytet në një tjetër?

— Jo, por cilët njerëz njihni këtu?

— Shumë.

I pandehuri e drejtoi trupin dhe sytë i nguli në një pikë aty ku bashkohej muri i dhomës me tavanin.

— Mikel Markun a e keni njohur?

— Të mendohem, zoti hetues.

Hetuesi nuk i foli. Ai vërente me kujdes atë fytyrë të ashpër dhe eshtake. Mollëzat e faqeve i kishte të dala. Sytë i mbante gjysmë të mbyllur.

— Njeri me emër të tillë, nuk njoh. Jo, jo, të jeni i sigurtë për këtë, — tundi kokën i pandehuri. Duart i kryqëzoi mbi gjunjë dhe heshti.

— Ashtu?!

— Ju thashë, një njeri me emër të tillë nuk njoh.

E shikuan njëri-tjetrin në sy.

«Sado që të këmbëngulë, ky s'ka për të nxjerrë gjë», mendoi i pandehuri.

Albani shtypi një sustë në tavolinë. Në korridorin e ndërtesës u dëgjuan hapa.

— Futeni brenda! — i bëri shenjë me dorë Albani atij që hapi derën.

I pandehuri nuk lëvizi fare. Por në trup i kaloi një dridhje e lehtë. «Diçka ditkan», tha me vete. Dy bulë djerse i rrëshqitën mbi mollëzat e dala të fytyrës. «Qëndro, mos e lësho veten», mër-

mëriti pa zë. Dera u hap prapë dhe në hetuesi, bashkë me atë që hapi derën më parë, hyri dhe një djalë i ri.

— Afrohuni, afrohuni! — i tha atij Albani.

Djaloshi u afrua me ndrojtje.

— E njihni këtë? — hetuesi i tregoi me gisht të pandehurin.

— E njoh, — tha djali. — Është Alfred Ciko nga... — dhe tregoi se nga ishte, — shok i vëllait tim, Mikelit. Ka ardhur kushedi sa herë tek ne.

I pandehuri lëvizi me rrëmbim në karriqe. Dëshi të thoshte diçka, por nuk foli.

— Mund të dilni! — iu drejtua Albani djaloshit.

Ata dolën.

Hetuesi lëvizi dosjen nga vendi.

I pandehuri i nguli sytë po në atë pikë ku bashkohej muri i dhomës me tavanin.

— Po, unë e njoh Mikelin, — tha i pandehuri. — Kam qenë nja dy herë në shtëpinë e tij. Tjetër nuk di ç'të them. — I pandehuri i uli sytë poshtë.

— Po pse më parë thatë se nuk e njihnit?

— Harrova. Kur ke shumë të njohur nuk i kujton dot. Mendje është... Pastaj unë e thërrisja Kel dhe jo Mikel, — u përpoq të dredhojë ai.

— Ndoshta, ndoshta — tha Albani me qetësi.

— Çfarë rrobesh mbaje veshur? — kaloi papritur Albani në një pyetje tjetër.

— Po ja, këmishë, xhaketë, pallto kur ishte ftohtë e... — dhe i pandehuri vazhdoi të fliste.

— Po xhakavento ke pasur?

— Jo, nuk kam pasur.

— As nuk ke shitur?

— Kur s'ke të tillë, çfarë do të shesësh, —

buzëqeshi me zor i pandehuri dhe një drithmë tjetër e ftohtë i përshkoi trupin.

— Mendohu, mendohu, — tha hetuesi, — se mos harron prapë ndonjë gjë.

— Këtu nuk ke çfarë harron, zoti hetues. Janë rrobe që i vesh për ditë.

Albani rrinte i qetë dhe tymoste cigaren. «Është çasti më i përshtatshëm tani», mendoi. U çua dhe hapi dollapin. Që andej nxori një xhakavento dhe e vuri me kujdes mbi tavolinë. Shikimin nuk e hiqte nga i pandehuri. Ai lëvizi pak nga vendi. Dësh të ngrihej. Pastaj u ul prapë në karrike. Duart ju varën si të këputura.

— I pandehur, gabuat dy herë dhe gabuat rëndë. Flisni, flisni!

— Po, do të flas, — tha i pandehuri. — Do t'jua tregoj të gjitha.

— Se mos «harroni» prapë diçka.

— Jo! Mikel Markun ne e njihnim. Po, po, ne. Dhe krijuam shoqëri. E afronim kudo. Pastaj menduam ta fusnim në rrethin tonë. I tregova qëllimet. Shokët më ngarkuan mua t'ia thosha. Dhe ia thashë. Në sytë e tij lexova mospranimin. Bile diçka më shumë — denoncimin. U frikësova. Ai nuk fliste. Të dy rrinim shtrirë. Ai në shpinë e unë në bark. Ai bënte sikur lexonte gazetën, ndërsa përbrenda ziente. «Mbaroi gjithçka» — thashë. «Unë s'mund ta bëj këtë. S'mund të bëhem vjedhës. Kurrë, kurrë!» tha ai. «Mirë» i thashë unë dhe vetëtimthi u ngrita, nxora thikën (atë e mbaja gjithnjë me vete) dhe ia ngula në zemër. Pastaj i hoqa rrobot dhe e tërhoqa zvarrë deri te grumbulli i gurëve...

— Ky ishte fundi i rrugës suaj të krimit.

I pandehuri heshti.

— Mund të pushoj pak, zoti hetues? — pvetrai me zë të zvargur...

Albani shtypi sustën mbi tavolinë. Dera e dhomës kërciti dhe u hap.

— Skënder, merreni! — dhe bëri me dorë nga i pandehuri.

U mbështet në karrike. Nxori paqetën dhe ndezi një cigare. Tymi u përhap rrathë-rrathë deri afër tavanit. Mblodhi fletët e dosjes.

«Ishte një proces i vështirë», tha me vete dhe u çua.

LAKU

Sa e pa shefin që po ngjiste shkallët oficeri i rojes i doli përpara dhe i raportoi. Gjatë shërbimit të natës s'kishte pasur asgjë me rëndësi. Një i sëmurë psikik kishte shqetësuar banorët e një pallati në lagjen «Guerile». Vetë banorët e shkallës kishin mundur ta qetësonin dhe ta dërgonin në spital. Një djalë i ri kishte goditur me biçikletë një plakë që nuk dëgjonte mirë nga veshët. Djaloshi që paraqitur vetë në polici. E këshilluan dhe e lanë të lirë. Plaka kishte pasur vetëm një tronditje të vogël dhe tani ishte mirë.

— Gjithçka në rregull, atëhere?

— Po, shoku Bato... Vetëm desha t'ju them se, nuk di përse, Luani ju ka kërkuar dy herë në telefon.

— Nuk tha gjë? Nga telefonoi?

— Nga kryesia e kooperativës së Beshirajt. Më tha se do t'ju marrë përsëri.

— Ashtu tha, hem... do të më marrë përsëri! Batua ndenji i menduar për disa çaste

Zilja e telefonit ra menjëherë.

— Jam Fadili, Bato, mirëmëngjes!

— Mirëmëngjes, shoku kryetar. Po nisem menjëherë.

— Mirë atëhere, po të presim. Kam dhe drejtorin këtu.

Po vishte pardsynë për të dalë, kur trokiti porta. Batua e çeli vetë dhe u gjend ballë për ballë me polic Adrianin.

— Hë, buçko, si është puna?

Polici, nga që u ndodh ashtu papritmas, buzëqeshi dhe tha:

— Nuk e di, por... ndoshta është ndonjë çështje pa rëndësi, shoku Bato. Mbrëmë, në bisedë e sipër, gruaja më tha se... një shoqes së saj, me të cilën punojnë së bashku në magazinat e seleksionimit të frutave, nuk i qe kthyer burri në shtëpi.

Batua i hodhi krahun në supe policit dhe dolën të dy përjashta.

— Po si the ti, Adrian, nuk i qe kthyer burri në shtëpi asaj nuses! Epo, ç't'u bëjmë këtyre burrave? — Dhe qeshi.

Qeshi dhe Adriani.

— Jo, shoku Bato, por... asaj nuses ka gati një muaj që i është zhdukur i shoqi.

— Një muaj?!

— Po, ka gati një muaj që është larguar. Dhe mua më lindi një farë dyshimi. Kur është larguar nga shtëpia, ai i ka thënë së shoqes se do të shkojë në stërvitje ushtarake për njëzet ditë. Në fakt, ka kaluar muaji dhe ai s'është kthyer. Pastaj ka stërvitje kaq të gjatë?!



Aty nga mesdita ishte bërë e qartë se një njeri qe zhdukur. Kooperativisti Dulejman Sadik Zala

nga Dëllinjasi, i cili para pesë muajsh ishte martuar me të venë Sadrije Delibasha nga Beshirajt, kishte gati një muaj që nuk ishte parë as në fshat dhe as në ndonjë vend tjetër. Në zyrën e vet nënkryetari i degës pati një takim të shkurtër me oficerin operativ të zonës, Luan Malkun, oficerin e policisë Mihal Vildanin dhe policin e ri Adrian Shekon. Dulejman Zala ishte një burrë rreth të tridhjetë e pesave. Në Dëllinjas ai kishte nënën dhe një vëlla më të madh, me tjetër baba. Para tetë vjetësh ishte prishur me të vëllanë dhe kishte ikur e që futur punëtor në minierë për disa kohë, por pastaj që kthyer përsëri në fshat. Në biografinë e tij të thjeshtë kishte vetëm një pikë të dyshimtë: para pesëmbëdhjetë vjetëve, kur po kryente shërbimin ushtarak, që akuzuar për tentativë arratisjeje së bashku me të birin e një kulaku, por kjo nuk i ishte vërtetuar dhe ai kishte dalë i pafajshëm. Në minierë, për gjithë kohën që punoi atje që dalluar si një nga vagonistët më të mirë. Edhe në Beshiraj asnjë fjalë e keqe nuk ishte dëgjuar për të. Kur erdhi në fillim e u martua me Sadrijen aty-këtu ishin shprehur dyshime për të: ç'ishte ky njeri që kishte lënë fshatin e njerëzit e vet dhe kishte ardhur e që martuar me një grua të ve, e cila nuk kishte dashur të largohej nga shtëpia e burrit të vdekur. Por këto pëshpëritje u mbyllën shpejt. Dylejmani ishte njeri i punës dhe dyshimet u lanë mënjanë. Burrë e grua punonin dhe shkonin mirë.

Po ja, papritur, njeriu zhduket pa lënë gjurmë. Dhe tani atyre të katërve, punonjës të degës së punëve të brendshme, u binte barra që të zbulonin të vërtetën. Në atë takim të shkurtër ata përcaktuan masat konkrete dhe mënyrën e koordinimit të

veprimeve të tyre. Në të tilla çështje, ngandonjëherë edhe minuta e humbur kushton shtrenjtë.

Që atë pasdreke, Batoja u nis vetë për në magazinat e seleksionimit të frutave në Fushëbeshiraj. Ai thirri në zyrën e përgjegjësit të magazinës të shoqen e kooperativistit të zhdukur. Gruaja hyri dhe qëndroi në këmbë krejt si e hutuar. Nuk duhej t'i kishte kaluar as tridhjetë vjeçët. Kishte një trup të plotë e të lidhur, por një pamje aq të vrarë e aq të trishtuar, sa menjëherë kuptohej se vuante shumë.

— Ulu, shoqe, ulu, — i tha Batoja me një ton shumë të ngrohtë.

Gruaja u ul sikur të kishte frikë mos zbërthehej karrikja dhe rrëzohej përtokë.

— E di që e ke të vështirë, shoqja Sadrije, por... ne na duhet të ndihmojmë njëri-tjetrin për të zbuluar se si qëndron çështja e burrit tuaj.

— Qyqja unë, qyqja unë!

Gruaja mbuloi fytyrën me duar dhe u shkreh në vaj. Batoja e la ashtu për disa minuta, gjersa ta mblidhte veten e të qetësohej.

— Duhet durim në të tilla raste, moj shoqe. Me lot e psherëtima nuk do të zbulonim asgjë. Ne duam që të të lehtësojmë dhembjen, Sadrije. Duam të të ndihmojmë. Ti Dylejmanin e ke pasur më afër se kushdo tjetër. Ndoshta keni vënë re ndonjë ndryshim në sjelljen e tij. Pastaj... ku ta dish, ndonjë armiqësi e vjetër... ndonjë grindje me ndonjerin...

— Qyqja unë! E ç'mund të them unë për të?! Ai ishte aq i mirë!... Të gjithë e donin, të gjithë s'e nxirrnin nga goja. Ai bëri çmos për mua. Qyqja unë!... Ai la edhe njerëzit e vet...

— Durim, Sadrije, nuk bën kështu!

Batoja mbushi një gotë me ujë dhe ia vuri përpara.

— Pi pak dhe mblidhe veten. Njeriu duhet të jetë i fortë në të tilla raste... Pastaj nuk ke arsye që të shqetësohesh kaq shumë. Ai do të kthehet, me siguri do të kthehet. Ju jeni njohur e u lidhët vetë me njëri-tjetrin. Apo jo?

— Si të thuash... Ja ashtu. Ishim parë disa herë kur sillte frutat e kooperativës në magazinë. Pastaj na ndihmoi edhe shoqëria që të afroheshim më tepër...

— Ti e ke shumë gabim, Sadrije, pastaj u bënë kaq muaj që bashkëjetoni.

— Pesë muaj, që në korrik. Megjithëse njëheshim edhe më përpara...

— E kuptoj, e kuptoj. I ndodh njeriut. Ju po përgatiteshit të bënit edhe celebrimin?

— S'kishte ditë që të mos i lutesha: «Shkojmë Dyl të bëjmë formalitetet. Po ai nuk donte të rrinte në fshat. Dontë që të shitja edhe unë pjesën e shtëpisë e të shkonim në një vend tjetër. Dhe atje menjëherë do të bënim celebrimin.

Në fund të bisedës Batoja e porositi që të mos fliste me asnjëri për takimin që kishin pasur. Ai u ngrit, i dha dorën dhe e përcolli gjer te porta.

Luani bashkë me dy ekspertë, kishte bërë këqyrjen e banesës së Sadrije Belibashës. Kjo ishte një shtëpi dykatëshe në të dalë të fshatit. Sadrija banonte në një dhomë në katin e sipërm. Po në këtë kat, në një kthinë shumë të vogël, banonte Azis Delibasha, i jati i Rremës, një plak shumë i thver në moshë dhe që kishte humbur krejt dëgjimin. Në katin poshtë jetonte Zylfije Delibasha, gruaia e ndarë e Sali Delibashës.

Në banesë, gjatë këqyrjes, diku në një qoshe ishte gjetur një shishe fliboli e përgjysmuar dhe në kopsht, nën dritaren e «odës së miqve» një çakmak i bërë nga gzhvoja fisheku. Çakmaku kishte qenë i Dylit dhe, siç kishte thënë Sadrija, ia kishin humbur vajzat e Zylfijes.

Tërë këto hollësira Batoja i dëgjoji në heshtje me vëmendje të madhe. E megjithatë ai nuk gjeti ndër to asgjë interesante. Asgjë, të paktën, tani për tani, nuk shërbente për t'i dhënë rrugë çështjes. Ç'rëndësi mund të kishte, për shembull, një çakmak i humbur, një copë tel elektrik i lidhur në një tra në tavan, një shishe uji në një strehë, një gjysmë shishe fliboli...

Kur u ngrit në mëngjes, Batoja e ndjeu kokën shumë të rënduar. Sytë i qenë fryrë. U vesh shpejt e shpejt dhe doli. Sa arriti në zyrë, sekretari e njoftoi se nga ministria kishin kërkuar njoftime se si shkonte çështja e Beshirajt. Kjo e bëri edhe më të zymtë nga ç'ishte. Ata nga lart kishin të drejtë të kërkonin prej tij, por... ç't'u njoftonte ai, kur as ai vetë nuk kishte gjë të qartë? Formuloi shpejt e shpejt një koncept të shkurtër.

— Jepe menjëherë! — i tha sekretarit.

Për tri javë të tjera ai qe i detyruar që të njoftonte pak a shumë me të njëjtat fraza: «Tani për tani ende s'kemi gjë të sigurt», «Shpresojmë se së shpejti çdo gjë do të sqarohet».

Lajmin e zhdukjes së Dylejman Zalës e kishte mësuar gjithë kooperativa madje edhe fshatrat përreth. Shkoi fjala gjer në Dëllinjas. I vëllai i Dylit erdhi i alarmuar në Beshiraj për të marrë vesh të vërtetën. Gojë më gojë kishin filluar të qarkullojnë «variante» të çuditshme. Dikush thoshte se e-

kishin zhdukur gjakësit e vjetër. Të tjerë flisnin se ishte mbytur në lumë atë natë me furtunë të madhe. Disa thoshin se ishte vrarë aksidentalisht me një predhë mortaje dhe trupin ia kishin mbledhur copa-copa në një arkë. Pati edhe të atillë që kishin hapur fjalë se Dyli qe përpjekur të kalonte kufirin dhe ishte plagosur rëndë e kishte vdekur matanë.



Kishte kaluar gati një muaj që nga fillimi i hetimeve kur Adriani i njoftoi diçka që Batos nuk iu duk pa rëndësi.

— Domethënë, kështu, që the ti, Adrian, — deshi të sigurohej më mirë shefi, — plaka i kishte parë të dy që po grindeshin.

— Po, shoku Bato. Plaka po kthehej në shtëpi me një krah barë në sup, kur te bishti i urës vuri re Dylejmanin, që po grindej me Sali Delibashën. «Sa nuk u rrahën», më tha gruaja. U shanë e nuk lanë gjë pa thënë.

Të nesërmen Mihali mësoi se Sali Delibasha, megjithëse i ndarë nga gruaja, shkante herë pas here në familjen e vjetër për të takuar të jatin plak dhe fëmijët. Batoja vendosi aty për aty që të pyetej plaku dhe Zylfija, ish e shoqja e Saliut. Doli se me të vërtetë Saliu i mbante lidhjet me njerëzit që kishte në Beshiraj. Një zbulim shumë interesant bëri po atë ditë Luani: midis faturave që llogaria e kooperativës mbante për dorëzimin e frutave në magazinat e seleksionimit, ishte gjetur një faturë, prapa së cilës qe shkrojtur emri i një farë Rustem Ali Broku,

tri katër fjalë të pakuptueshme, disa numra dhe emri i një qyteti të një shteti të huaj. Dekumentin e morën në dorë ekspertët. U vërtetua se kjo faturë ishte dorëzuar në llogarinë e kooperativës nga Dylejman Zala, që kishte çuar frutat në magazinë. Shkrimi prapa faturës nuk ishte vënë re më parë nga llogarija e kooperativës. Ekspertiza vërtetoi se ky shkrim nuk ishte i Dylejmanit por i dikujt tjetër. Përsa i përket emrit «Rustem Ali Broku», ky ishte emri i një banditi e diversanti të arratisur prej vitesh dhe që tani punonte në një minierë qymyrguri, pikërisht me atë adresë që ishte shënuar prapa faturës.

— Domethënë Dylejmani mund të na ketë lënë pendët dhe ne e kërkojmë këtu. Si mendon ti, Luan?

— Po, por edhe Rustem Broku nga prapadielli nuk kish si ta shkruante adresën e tij prapa faturës së kooperativës sonë. Atëhere duhet të ketë në këtë mes një njeri të tretë. Është ai njeri që ka shkruar adresën prapa faturës. Dhe këtë njeri ne duhet ta gjejmë.

*

* *

Ishte një kohë kur çështja kishte ngelur në një pikë të vdekur dhe nuk bëhej dot asnjë hap përpara. Kurse tani po ndodhte një tjetër dukuri: zbuloheshin të dhëna e vinin njoftime aq kontradiktore në pamjen e parë, sa njerëz pa eksperiencë do ta kishin humbur toruan dhe do të çorientoheshin krejt. Pikërisht ato ditë që po ndiqej çështja e faturës, Mihali e njoftoi nënkryetarin e degës se një-

ra nga vajzat e Zylfijes, rastësisht, kur po vadisnin lulet në shkollë, i kishte thënë mësueses: «Sa e bukur kjo shtambë, zonjushë! Kishim edhe ne si kjo, por...» Dhe, siç i kishte thënë nëna më vonë, shtambën nuk e kishte thyer xhaxhi Dyli, por i kishte rënë babë Saliut nga dora. Këto i kishte raportuar Mihali.

Si një pikë në horizont, që, duke u afruar gjithnjë e më me shpejtësi, rritet e rritet derisa bëhet diçka e qartë dhe shumë e afërt, ashtu po rritej e po merrte formë në imagjinatën e Batos figura e Sali Delibashës. Fizionominë e këtij njeriu e plotësuan edhe më mirë të dhënat që njoftoi Mihali më pas. Saliu ishte kontrollor në magazinat e seleksionimit të frutave. Tërë jeta e këtij njeriu kish qenë një aventurë. Që në moshën më të re kishte hyrë në milicinë fashiste. Pastaj u bë xhandar dhe kur «pilafi u bë gati» siç thotë populli, dezertoi dhe u fut në një brigadë. Ra më vonë në burg për vjedhje. Në moshën dyzetvjeçare la gruan me katër vajza (sepse nuk i lindte djalë) e u martua me një tjetër.

Lindi një pikëpyetje e re: mos ky njeri ka lidhje me faturën e llogarisë së frutave? Mos e ka shkruar ai atë adresë? Dhe në qoftë se Dylejman Zala është arratisur, mos ky njeri ka gisht në këtë punë? Po atëhere si mund të shpjegohet grindja te ura ose grindja në shtëpi ku u thye shtamba? Mos të gjitha këto ishin fjalë për të fshehur gjurmët?

U kërkuan copat e shtambës së thyer dhe u gjetën. Batoja bisedoi vetë, si rastësisht, me plakën fshatare, që i kishte parë të grindeshin Dylejmanin dhe Saliun.

— Gjynah ai djalë! E morën në qafë, — kishte

thënë plaka, — pa, sa për Saliun ai i hurit dhe i litarit ka qenë gjithë jetën. Po kjo Parti e kjo qeveri e popullit të jep dorën sot. Veç nuk thonë kot «ku di derri, ç'është nderi»! Se ai e do ndryshe. Ku ta dish, e kush e vë dorën në zjarr, se nuk i ka rënë në qafë Sadrijes?

— Ç'janë këto, që thua, moj nënë? Ai e ka kunatë Sadrijen.

— Hë hë — qeshi plaka me ironi dhe, duke iu afruar në vesh Batos, i përshpëriti:

— Është bërë gati për të lindur Sadrija. Fëmija rri në bark të nënës nëntë muaj, e ajo dhjetë a më shumë mbeti pa burrë.

Batoja mbeti për një çast pak i hutuar nga këto që thoshte plaka. Po pastaj gjithçka iu duk fare e mundshme.

— Të faleminderit shumë, moj nënë! Vetëm nuk është mirë që të bëhet fjalë. Kushedi si del puna dhe... nuk do të jetë mirë as për Dylejmanin e as për Sadrijen. Ata janë njohur para se të mar-toheshin dhe... ku ta dish...

— Nuk jam nga ato që marrin botën nëpër gojë, mos ki merak!

— Të faleminderit, nënë!
U ndanë me duar në qafë.



Ajo që deshi të mbante të fshehtë Batoja, doli në shesh që të nesërmen: kur në magazinat e seleksionimit të frutave në Fushëbeshiraj sa kishte filluar puna, Sadrije Belibashën e zunë dhimbje të

forta në bark. Atë e çuan urgjente në maternitet. Në pasdreke lindi djalë. Raporti i komisionit mjeksor konstatonte se lindja ishte plotësisht e rregullt, fëmija kishte lindur në zhvillim të plotë, në muajin e nëntë.

— Domethënë Dylejman Zala nuk ka si quhet i jati i kësaj fëmije, — u tha Batoja të tre shokëve, pasi u lexoi raportin në zyrën e vet. — Siç del e qartë, atëhere kur Sadrija ka mbetur shtatzënë, as e kishte parë me sy Dylejman Zalën.

Po atëhere kush ishte babai i vërtetë? Dhe ç'lidhje mund të ketë ajo me zhdukjen e Dylejmanit? Sigurisht, më mirë se kushdo këto mund t'i sqarojë vetëm ajo, Sadrija. Por tani për tani me Sadrijën nuk mund të vazhdonin hetimet. Dhe nëse përkohësisht në këtë drejtim çështja ngeli në vend, në një drejtim ajo mori rrugë papritur: u vërtetua se shkrimi prapa faturës së llogarisë ishte i një farë Lake Boro, një mikut të Sali Delibashës, me të cilin Saliu, qëkur ishte në milici ish bërë vëlla gjaku. «Miku» i Saliut pranoi se ishte njohur e takuar disa herë me Dylejmanin. Kohët e fundit kur kishte ardhur disa ditë te vajza, që takuar në pazar rastësisht me Dylejmanin. Së bashku kishin shkuar e kishin pirë kafe. Aty, vetë Dyli ia kishte shkruar adresën pas një copë letre.

— Si të ka rënë në dorë adresa e Rustem Brokës? — e kishte pyetur vëllamthin e Sali Delibashës.

— Më pat shkruar për të një njeri i fisit që iku përjashta që para luftës dhe që qe interesuar për të.

— Po Saliut i ke thënë që i ke dhënë këtë adresë Dylit? — pyeti Luani.

— E pse të bisedoja me Saliun për niçgjë?

Pastaj ne kemi edhe kaq kohë pa u takuar, që në prill.

Pikërisht ky kundërshtim i prerë dhe i menjëhershëm, e bindi Luanin më tepër se Sali Delibasha duhej të kishte dijeni për këtë çështje. Ai bisedoi me Baton dhe shfaqti mendimin që ta merrte menjëherë në pyetje Saliun. Por nënkryetari nuk qe dakord.

— Më mirë të presim edhe pak.

Të mërkurën Saliu shkoi në zyrën e një të njohuri në qytet dhe prej andej u lidh me Laken.

— «Telegramin» e morën ata të tutë dhe mos u bëj merak. Ti bëj punën tënde tani — i tha miku.

Mihali solli nga Beshiraj të tjera lajme. Ai kishte marrë përsëri në pyetje Zylfijen. Përgjigjet e saj në fillim ishin aq të ngatërruara, sa ajo vetë u detyrua më në fund të zbulonte një fakt të ri që i shpuri hetimet më përpara.

— Nuk kam dashur t'i bëj kurrë të keqen burrit tim, — kishte thënë ajo. — Megjithëse iku e më la, sidoqoftë e kam babën e fëmijëve dhe... po të flas keq për të, më vret zoti. Por edhe përpara qeverisë s'kam si e fsheh atë që di. Kishin kaluar, o pesë, o gjashtë ditë që kur Dylejmani kishte shkuar në ushtri. Ishte e shtunë atë ditë. Unë kisha mbledhur një thes me mollë për t'i shpurë në pazar. Sa qe errësuar e binte një shi i madh. Erdhi Sala. Ishte bërë ujë. I dhashë ndërresa. Hangri darkë dhe pastaj shkoi lart në odën e miqve për të fjetur. Fjetëm edhe ne. Ç'të bënim? Pastaj, mbas nja dy orëve, lart, në «odën e miqve» u bë një zhurmë e madhe. Sa s'më ngriu gjaku. Dëgjova që krisi kotruvja dhe

një britmë që m'u duk si zëri i Salës. Pastaj edhe zëri i Dylit. Ngjita shkallët. Dera e dhomës ishte e mbyllur. Brenda përpiqeshin si deshtë. Vura ulurimën. S'dija ç'të bëja. Më në fund dera u hap dhe Sala zbriti poshtë, shkoi i hodhi bar mushkës në kasolle. Unë mezi e prura në vete Sadrijen. Dylin s'e pashë asgjëkundi. Sala iku që atë natë. Mori edhe mollët në mushkë. Kur doli më porositi që të mos hapja gojë.

Këtë kuadër të ri të marrë nga Zylfija e plotësoi Sadrija kur doli nga materniteti. E gjendur përpara shumë fakteve, ajo i pranoi lidhjet intime me ish-kunatin nga burri i parë. Tregimi i saj ishte rrënjëqethës. Ja si ia përkroi Batoja prokurorit këtë çështje.

Ajo u ul aty në karrige, dhe vendosi të fliste hapur:

«Ç'kërkon, më tha, të të flas hapur? Epo mirë, do të flas. Saliun unë e kam dashur dhe e dua. Që përpara se të më vdiste burri. Mua prindërit më martuan pesëmbëdhjetë vjeçe. Më dhanë një burrë që s'ishte burrë. Dhe unë fjeta me të si motër e vëlla për shtatë vjet të tëra. E ç'të bëja tjetër! Burri më kishte blerë me para. Pastaj, më vdiq dhe burri. Gjynah, i shkreti Rremë. Po më mirë që vdiq, se ai gjysmë njeriu ishte... Vinin njerëzit e të afërmit të më qanin hallin.

Erdhën pastaj ditët e vështira, mbeta shtatzënë. U drodha kur e ndjeva për herë të parë se do të bëhesha nënë. Natyrisht, unë do të isha një nënë fatzezë. E kisha në dorë, mund ta vrisja krijesën time. Por ju e shikoni, unë as këtë nuk e bëra. Dhe atëhere Sala më dha mendimin të martohesha me kë të mundja. Veç sa më shpejt. Doli Dylejman Za-

la, dhe për sy e faqe u martova. Që në muajin e parë, ai e kuptoi që unë nuk e doja dhe atëhere filluan dyshimet, filluan grindjet, përgjimet, derisa një natë na zuri në «odën e miqëve». Ai hyri, mbylli derën me çelës, ndezi dritën dhe bërtiti: «Eh, ju thashë se do t'ju zija». Dhe atëhere plasi bubullima. Doemos, dy burra me një grua. U copëtua shtamba. Në fytyrën e kujt? Unë s'arrita të shikoja gjë. Më ra të fikët. As kur linda nuk i humba ndjenjat. Ç'ndodhi më vonë nuk e di. Dylejmani nuk ishte nga ata që e hanë turpin me bukë dhe... ndoshta për këtë u zhduk».

Nuk mbetej tani asgjë tjetër, veçse të përqëndrohej i tërë zjarri në drejtim të Sali Delibashës. Përpara shumë fakteve, përballë ballafaqimeve, ai u detyrua të pranonte lidhjet intime me ish kunatën, grindjet me Dylejmanin dhe ngjarjet rrënqethëse të asaj nate, kur Dyli i kishte kapur në flagrancë. Tablonë që përshkoi Sadrija, ai e plotësoi edhe me diçka të re: si qenë goditur të dy me Dyllin, kur kishte kërcyer nga dritarja e katit të dytë dhe qe zhdukur.

Ishte e pamundur të nxirrte më tepër nga Sali Delibasha. Megjithatë, që të katër punonjësit e degës kishin bindjen se ai duhej të dinte edhe më tepër. Luani ngulte këmbë se Dylejmani nuk kishte dalë matanë kufirit dhe gjithçka ishte kurdisur për të mbuluar krimin. Por kush e kishte kryer krimin? Saliu, «miku» apo ndonjë tjetër? Saliu patjetër do të kishte gisht gjer në fund të çështjes. Ndoshta edhe Sadrija.

Po të gjithë këto ishin hipoteza. Batos i dukej se po hynin përsëri në një shteg të errët. Duheshin të dhëna të reja për të ndriçuar rrugën e për të

dalë nga ky shteg. Vendosën që të vazhdonin kërkimet më tej.

Dhe «kush kërkon gjen», thotë një fjalë. Një mbrëmje, kur Batoja sa ishte kthyer në shtëpi, e mori në telefon Adriani.

— E, buçko, si i ke punët?

— Desha t'ju takoj, shoku nënkryetar.

— Ti je më i ri, Adrian, eja në shtëpi, të pres.

Polici i ri erdhi me një frymë. Ata shkuan në dhomën e pritjes.

— Atë natën e shiut të madh, — filloi Adriani menjëherë — një djalë nga Kallmishta, që vinte me lejë nga ushtria, ishte takuar afër fshatit me Sali Delibashën i cili kishte një mushkë të ngarkuar me mollë. Bile Saliu i kishte mbushur ushtarit shaminë me mollë. Po ç'deshi Saliu në Kallmishtë në mes të natës? Ai mollët i kishte marrë te Zylfija për t'i shpurë në qytet. Kurse Kallmishta ishte një orë larg nga Beshiraj.

— Është e sigurt kjo Adrian?

— Unë e takova vet ushtarin. Shkova posaçërisht për këtë punë në repart.

Batoja, jo për t'i bërë qejfin Adrianit, por e quajti shumë interesant këtë të dhënë. Atij i dukej se tani kishte vënë në dorë një pikëmbështetje për ta çuar më tutje punën.

— Adrian, sonte do të rrimë të hamë darkë bashkë, — tha Batoja tërë gëzim.

Adriani buzëqeshi.

Të nesërmen Mihali me Adrianin shkuan në Kallmishtë dhe organizuan kontrollin e vendit. Njerëzit që u ngarkuan kontrolluan, por megjithatë asnjë shenjë nuk u gjet. Ditën e dytë, një nxënës i klasës së tretë të shkollës së Kallmishtës shkoi e i do-

rëzoi oficerit të rojes të degës një orë xhepi me një copë zinxhir argjendi. Djali tha se e kishte gjetur te gardhi i varrezave të Kallmishtes, kur pondiqtë një dhi që kishte ikur.

... E thirrën Sali Delibashën përsëri në degën e brendshme.

— Nuk kam ç't'ju them më, — tha ai i revoltuar, sapo hyri në zyrën e hetuesit.

— Kemi diçka ne, — ia preu Batoja me një buzëqeshje që e çarmatosi menjëherë Saliun. — Atë natë që ndodhi ngjarja me Dylejman Zalën, iu ngarkuat dy thasë me mollë në mushkë dhe i çuat në qytet, apo jo?

— Po, kështu është.

— Mirë që njeri ishte me mollët e Zylfijes e të plakut, po mollët e thesit tjetër ku i gjete?

Saliu hapi sytë dhe shtangu.

— Mos u çudit! Kemi dëshmitarë për këtë. Të kanë parë, ndonjërit mund t'i kesh dhënë edhe ndonjë shami me mollë.

— Po... s'kam si e fsheh. Unë njërin thes e mbusha me mollët e Kallmishtes. Kisha nevojë për lekë dhe...

— Vajte vodhe pasurinë e kooperativës, do të thuash?

— Ashtu është, pikërisht ashtu.

— Ku i shkarkuat mollët? Desha të them në tregun e qytetit, apo në varrezat e Kallmishtes?

— Për nder, nuk ju kuptoj, shoku Bato. Për nder... unë... për nder...

— Mirë, mirë, mos u përbeto kaq shumë! Më thuaj sa e ke orën?

Për forcë të zakonit, Saliu e hodhi dorën në xhep të jelekut për të nxjerrë orën, por menjëherë

e hoqi sikur të kishte prekur në thëngjill të ndezur.

— Të ka humbur? Mos është kjo? — Batoja nxori nga sirtari orën me zinxhir argjendi.

Saliut i ra një çehre prej të vdekuri. Goja po i merrej.

— Ku... ku... ku e gjetët?

— Atje ku e humbe. Atje ku shkarkove thesin, te varrezat e Kallmishtes.

— Gjer atje shkuat?. E... e zbuluat të vrarin?!

— Sigurisht, të vrarin dhe njëkohësisht edhe vrasësin.

E KUJT ISHTE LLULA?

Atë natë të errët era frynte e shfrynte shumë. Fshatarët nuk mbanin mend që ditët e marsit të kishin qenë aq të ftohta ndonjë vit. Madje, një nga pleqtë thoshte se kjo cingërimë kishte ndodhur vetëm atë vit kur asaj ane kishin shkelur taboret e Xhavid Pashës.

Pasi i vuri zjarrit edhe një dru tjetër, nga ato që amvisat s'para i pëlqejnë, sepse janë me gunga e mezi futen në sobë, por ama pasi ndizen mirë e mirë bëhen tërë prush, nusja Leze, mori pak ujë të ngrohtë nga kusia mbi sobë dhe filloi të lajë enët. Vjehri me vjehrrën sapo ishin çuar nga guzhina dhe kishin shkuar në odën e tyre, ndërsa Marku, djali i të zotit të shtëpisë, lexonte i shtrirë mbi minder një libër agroteknik.

— Nesër do të vazhdojmë hapjen e tokave të reja lart në Qafë, — e theu heshtjen ai. — Kështu më tha agronomi.

Lezja vazhdonte të shplante me ujë të vakët enët.

— Edhe ne aty na... — po ajo s'mundi të flasë më tej, pasi dëgjoi një shpërthim të fuqishëm. Një perde tymi mbuloi vendin rreth e qark.

Ajo shtangu. Kur pa vjehrrin dhe vjehrrën që

kapërcyen pragun e guzhinës të tromaksur dhe vrapuan drejt Markut, që kishte rënë përmbys me duar në fytyrë, i ra të fikët...

I mbështetur mbi shpinëzën e karrikes, hetuesi mendohej për atë që kishte ndodhur dy net të shkuara. Akoma nuk kishte formuar ide të qartë lidhur me ambjentin dhe me të gjitha rrethanat e kryerjes së krimit. Bisedat me disa nga fshatarët kishin sqaruar marrëdhëniet shoqërore të familjes së Markut me fshatarët. Ishin gjetur edhe disa nga provat materiale. Megjithatë, personaliteti i kriminelit dhe motivet nga ishte nisur ai për kryerjen e krimit, ende mbeteshin të mjegulluara...

— Mundohuni të kujtoni me hollësi, si e kaluat atë mbrëmje!...

Lezja heshti për një çast dhe, si e kuptoi çfarë kërkonte hetuesi, foli:

— Atë mbrëmje, ne ishim të katër në shtëpi. Bisedonim për punët e kooperativës. Marku, pasi u tha prindërve se na duhej të blinim edhe një dollap të ri, filloi të lexojë një libër për bujqësinë. Vjehri dëgjonte lajmet.

— Kush e ndezi zjarrin? — e ndërpreu hetuesi.

— Zjarrin?... Vjehrra, si zakonisht. Unë e Marku, kur kthehem nga puna, e gjejmë zjarrin të ndezur.

— I vutë dru të tjera?

— Po. Nga ora 7 e darkës, zjarri sikur u ftoh; gjella s'kishte marrë akoma valën e parë, kështu që unë mora dy dru lisi dhe i futa në sobë.

— Nga i more këto dy dru lisi?

— Pranë sobës, aty ishte vendi i druve, që na duheshin për një ditë.

— Kishte dru të tjera aty?

— Jo...

— Kujtohuni mirë... — foli me zë të ulët hetuesi. Pastaj ai bëri një pyetje tjetër ndihmuese:

— Ato dy dru që vure në sobë si ishin? Mos qe ndonjëri prej tyre me gunga anash?

Lezes i shkëlqyen bebëzat e syve.

— Po, shoku hetues, — gati sa s'thirri ajo. — Njëri prej tyre, më kujtohet fare mirë, ishte me gunga. Druri me gunga ishte i fundit që kishte mbetur pranë sobës. Atë e vura rreth gjysmë ore para se të ndodhte...

Lezja uli kokën. Hetuesi e kuptoi që ajo ishte shumë e tronditur.

— Unë dua të di një gjë, — vazhdoi hetuesi.

— Si u ndodh ai dru me gunga aty. Ai kishte eksploziv brenda.

— Eksploziv? — thirri Lezja e habitur. — Si është e mundur? — dhe dy pika loti i rrëshqitën nga sytë...

Kërcitja e shpinëzës së karrikes, i ndërpreu hetuesit përfytyrimin e asaj dite. Kuadri i mendimeve mbi mënyrat e kryerjes së krimit qe akoma i pjesshëm, megjithatë disa nga rrethanat qenë të lidhura disi me njëra-tjetrën. Ajo që i kishte treguar Lezja në fund të bisedës se para dy muajsh, duke çarë dru në oborr kishte gjetur njërin prej tyre të gërryer nga brënda e të mbushur me barut, ishte një e dhënë shumë e rëndësishme. Dhe në mendjen e tij krijoi një variant të mundshëm të kryerjes së krimit: krimineli, para dy muajsh, në stivën e druve kishte vendosur një dru të gërryer

nga brenda e të mbushur me barut. Ai e kishte vendosur atë një metër larg gardhit, nën strehën e portës së jashtme. Pasi kishte dështuar ai, për herë të dytë, kishte vendosur një dru të vogël gungaç me myshk në vrimat e të cilit kishte futur eksploziv, që Lezja e kishte marrë para katër ditësh dhe, së bashku me të tjerët, e kishte lënë pranë sobës...

Por prova më e rëndësishme që ndodhej në duart e hetuesit, ishte një llullë e vjetër, buzët e së cilës përshkoheshin nga një rreth i hollë argjendi. Ajo u gjet gjatë këqyrjes që bëri rreth stivës së druve, një metër larg saj. Pra, e kujt ishte ajo llullë?

— Mund të flisni, — e filloi bisedën i pari hetuesi. — Besoj se do të na ndihmoni së tepërmi, — dhe e shikoi në sy plakun, i cili kishte mbështetur të dy duart në bastunin e vendosur midis gjunjëve.

— Prandaj erdha vetë tek ju, shoku hetues, — u përgjigj me një zë të zvargur plaku. — Kjo që ndodhi është një turp për fshatin tonë... Prandaj erdha... Marku është djalë i mirë, djalë i vetëm. E ku ndodhin këto fatkeqësi xhanëm tek djemtë e vetëm?

Plaku heshti dhe mori frymë thellë.

— Në të vërtetë, fatkeqësia nuk ka ndodhur. Marku është shumë mirë. Doktorët e kanë nën kujdes.

— Ashtu? — e ndërpreu plaku hetuesin. — Është mirë! Shyqyr, shyqyr!

Fillimi i bisedës mori një drejtim të padëshiruar. Por hetuesi nuk u shqetësua. Ai e dinte se në këto punë njerëzit e kanë pak të vështirë të futen

drejt e në temë. Prandaj i bëri edhe një pyetje tjetër:

— Juve e keni afër shtëpinë e tyre? Dëgjuat ndonjë zhurmë atë natë?

— Asgjë, shoku hetues. Këtë e mbaj mend shumë mirë. Pastaj ku të linte era të dëgjoje se ç'ndodhte përjashta?

Heshtja qëndroi pezull. Tani hetuesi po habitej. Vetë plaku kishte kërkuar takim me të, e megjithatë nuk po fliste. Ai vazhdonte të qëndronte në pozicionin e mëparshëm, i mbështetur mbi bastun, me vështrimin të ngulur në dysheme. Për të parë reagimin psikologjik të tij, hetuesi e pyeti:

— E përse erdhët?

Plaku ngriti kokën menjëherë. Pyetja iu duk si e papritur. Picërroi sytë, dhe, duke marrë një pamje të menduar, foli:

— A, po, për pak harrova, shoku hetues. Për pak harrova!... Mbrëmë duke menduar për atë që ndodhi, m'u kujtua diçka që ka të bëjë me Markun.

Hetuesi u mbështet më mirë në tavolinë pa ndarë vështrimin nga sytë e plakut. Ai, duke parë interesimin e hetuesit, vazhdoi:

— Para ca kohësh, shoku hetues, Marku është grindur keq me një fshatar që dikur ka punuar në një brigadë me të.

— Sa kohë mund të ketë?

— S'e mbaj mend mirë, por... — dhe plaku u mendua pak, — nja dy muaj kanë shkuar që atëhere.

— Si e quajnë?

— Ai që u mbyt në lumë, shoku hetues, s'ka as tri javë...

«Përse plaku Kolë erdhi tek unë?

A janë të vërteta ato që tha? Dhe, në rast se janë të vërteta, si është e mundur që ai është mbytur para tri javësh, ndërsa druri me gunga nuk ishte vendosur në stivën e druve veçse para pesë ditësh? Po llulla? A pinte duhan i mbyturi? Me çfarë e pinte? Po drurin e gërryer nga brenda e të mbushur me eksploziv ai e kishte vendosur? A është logjike që një grindje pune të shërbejë si bazë për të kaluar deri në krim? A duhej dyshuar në vërtetësinë e atyre që dëshmoi plaku Kolë?...

Një ditë e vetme mjaftoi për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, e të tjera si këto, që ia drejtoi vetes hetuesi. Bisedat që zhvilloi me fshatarët, sqaruan dhe hodhën dritë mbi shumë gjëra të errëta.

Në një mbledhje të kryesisë së këshillit të fshatit, plaku Kolë tregoi të vërtetën. Ai i kishte përhapur ato trillime i shtyrë nga ish-prifti i fshatit, Dom Pali. Pra, ish-prifti, përsëri po e përdorte si vegël ish-psalltin e tij.

Dom Pali u arrestua. Ky ishte filli që do të conte tek autori i krimit.

Ata, të dy, qëndronin përballë njëri-tjetrit. Vështrimet i kishin kryqëzuar. Por ish-prifti, herë-herës i jepte fytyrës një shprehje të përvuajtur. Duke parë se midis tyre ishte nderur heshtja ai donte të fliste dhe të kërkonte sqarim pse e kishin arrestuar, por iu duk e kotë.

Jashtë bënte ftohtë.

Hetuesi, me qëllim, rezervoi heshtjen në fillim të pyetjeve të tij. Si do të reagoonte. Dom Pali? Dhe, në një çast kur ai uli kokën hetuesi pyeti:

— Dom Pali?

— Po, zoti hetues.

— Mosha?

— 60 vjeç.

— Përveç misionit të priftit, jeni marrë me veprimtari tjetër?

— Po. Ju i dini ato, zoti hetues...

Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve formale, hetuesi e kuptoi se ish-prifti përpiquej të tregojë i «singertë». E vërejti me kujdes. Ai i shmangej vështrimit të tij. Shpesh sytë i hidhte mbi tavolinë. Hetuesi hapi sirtarin, nxori që andej llullën dhe e vendosi mbi tavolinë në mënyrë që prifti mos ta shikonte plotësisht, por vetëm buzët e saj të rrethuara nga unaza prej argjendi. Pastaj, hapi paketën, mori një cigare, e ndezi dhe, pa i hequr sytë nga ish-prifti, foli:

— Dëshironi ta ndizni?

Dom Pali s'e dëgjoi. Vështrimin e mbante të mbërthyer mbi tavolinë. Hetuesi e vuri re habinë që u shkaktua në fytyrën e të pandehurit.

«Përse e nxori atë llullë hetuesi? Provokim? Duket tamam si e Ndues. Por s'është ajo. S'e besoj ta kenë gjetur. Apo këta i dinë të gjitha?...».

— Dëshironi një cigare? — ia përsëriti pyetjen hetuesi.

— Aha, nuk e pi, zoti hetues, e kam lënë, — dhe sytë i hodhi përsëri vjedhurazi mbi tavolinë.

— Mos e pini me llullë? — Hetuesi e ngriti atë nga tavolina.

Ai çakërriti sytë. Disa si valëzime të lehta, ia përshkuan fytyrën. Mbi ballë i dolën bulëza djerse.

— Si? — dhe më pas goja iu qep.

— Pini një gotë ujë, qetësohuni, — mendohuni mirë dhe pastaj flisni, — ndërhyri hetuesi, duke mbushur qetë e qetë gotën. Kjo gjë e hutoi Dom Palin. Pak më vonë ish-prifti tregoi...

Kishin kaluar dy orë, dhe i pandehuri Ndue Cara nuk pranonte të ishte bashkëpunëtor i krimit. Kundërshtonte duke thënë se ish-prifti pak e njih-te dhe kish shumë kohë që s'e kish takuar. Pastaj thoshte se s'kishte ndonjë gjë që ta armiqësonte atë me Markun dhe familjen e tij.

— Domethënë, i pandehur, ju pohoni se asgjë nuk ju lidhte me Markun?

— Po, — u përgjigj i sigurt ish-bajraktari.

— Po me Lezen, gruan e tij?

— Me të... as që më lidh ndonjë punë.

— E njihni?

I pandehuri s'u përgjigj menjëherë.

— S'e kam parë ndonjëherë.

— Po ajo është nga fshati juaj. Kaq shpejt ju ka lënë kujtesa?

— S'më kujtohet. Nuk njihen të tëra cucat e fshatit.

— Por, 14 muaj më parë juve dhe i jati i saj jeni dënuar me kusht katër muaj, për një krim që kini bërë. Si është e mundur mos ta mbani mend?

I pandehuri lëvizi nga vendi.

Hetuesi e vuri re reagimin e të pandehurit, megjithëse ai mundohej ta përmbante veten. Ash-tu i qetë, nxori një cigare. I pandehuri vëzhgonte të gjitha veprimet e hetuesit. Pastaj, hetuesi, nxori diçka nga sirtari dhe e vuri mbi tavolinë. Unaza prej argjendi, që rrethonte buzët e llullës, shkël-queu. Pranë saj ndodhej një dru me gunga i djegur pjesërisht.

Duke shikuar me bisht të syrit të pandehurin, ai nxori shkrepshen.

— Ndizeni, — foli papritmas hetuesi duke i zgjatur paketën e cigareve.

I pandehuri mundohet të përmbante veten.

— Jo, e kam lënë, — dhe vështrimin e ndali përsëri mbi tavolinë. «Ku e gjetën llullën. Ku më ra ajo nga xhepi? Mos e kanë kapur edhe priftin?»

— Pijeni me llullë atëhere, — dhe hetuesi ia zgjati atë. — Ju takon, pasi kjo është llulla juaj.

— Mos! — klithi ai duke u çuar nga karrikja. Pastaj u ul prapë.

— Jo, s'është e imja. — Fytyra e tradhtonte. Zëri iu mek. Iu duk sikur as vetë s'e dëgjonte zërin e tij.

— Mos harroni, i pandehur, se mund t'ju ballafaqojmë edhe me Dom Palin. — Zëri i hetuesit ishte i ulët, por i sigurt. — Atëhere...

«Më erdhi fundi. I ditkan të gjitha. Ka treguar ai prifti frikacak. Kapitullove o Ndue Cara!...»

— Jo, — e ndërpreu hetuesin, me një zë lutes. — Të gjitha do t'jua tregoj vetë...

Gruaja e parë i kishte vdekur. Qe martuar së dyti. Lindën katër vajza njëra pas tjetrës. Kur i lindi e katërta u pikëllua shumë. Po i afrohej të gjashtëdhjetave. Kush do ta trashëgonte Kullën? Me gruan zihej për ditë. Vajzat s'i shikonte dot me sy.

Por ja, dalngadalë filloi të afrohej me një nga fshatarët, që dikur e kishte ndihmuar ekonomikisht. E ndihmoi përsëri me ca kok dhen. Pastaj i kërkoi vajzën. Ai pranoi. Atëhere qe çelur përsëri në fytyrë. Kulla e tij do të kishte një trashëgimtar... Por vajza u largua një natë nga shtëpia

dhe u martua në fshatin fqinj. Atëhere ish-bajraktari, Ndue Cara, u bë si i marrë. Familja e vajzës sipas zakonit i kishte një gjak borxh. Vendosi të hakmerrej, e të zhdukte familjarisht shtëpinë ku Lezja kishte shkuar nuse.

...Por, herën e dytë, kur u zgjat për të vendosur drurin me gunga në stivën e druve, ai nuk ndjeu gjë kur llulla i ra nga xhepi. Bile as Dom Pali nuk e vuri re kur ra ajo.

DRURË TË VETMUAR

Veliu uli valixhen dhe zgjati dorën drejt butonit të ziles. Dukej se ishte i emocionuar. Dora i drodh lehtëzi, por pastaj ajo fitoi siguri dhe u dëgjua sinjali pak si i çjerrë i ziles. Iu desh të priste nja dy minuta. I shtroi me dorë flokët që i ishin shpupuritur nga era gjatë udhëtimit në karrocerinë e kamionit. Ndërkohë u dëgjua kërcitja e çelësit në bravë dhe dera u hap. Kur u ndodhën përballë njëri-tjetrit ata shtangën për pak sekonda, pastaj ajo iu hodh në qafë dhe trupi i saj u var i pafuqishëm. Ai e mori thuajse në krahë dhe e shpuri në guzhinë. Si e qetësoi, u kujtua të marrë valixhen që e kishte lënë tek, pragu i derës. Nëna, që tani e kishte mbledhur veten, nuk ngopej së pari e së përqaftuari birin e saj.

«Zemra e nënës është e artë, mendoi Veliu, po të shohim se ç'do të thotë babai».

Nëna u ngrit të bënte kafe. Ndërkohë ai i hodhi një sy shtëpisë. Në këto vjet që ai ishte ndodhur larg kishin ndryshuar shumë gjëra. Nëna i solli kafën dhe i dha një llokume. Mëri dhe për vete filxhanin e kafes dhe u ul pranë.

— Epo, gëzuar o bir, e mirë se erdhe! Të shkuara e të paharruara!

— Faleminderit nënë, të paharruara! — u përgjigj Veliu, — të paharruara, — përsëriti ai edhe një herë.

— Do të pish një cigare? — e pyeti ajo me druajtje.

— Jo, nënë nuk e pi.

Atij iu kujtua kur pinte duhan katër vjet më parë. E pinte jo se e ndjente të nevojshme, por sepse e pinin dhe shokët e tij.

Përkundrazi ai sa herë që pinte kollitej, por të qeshurat e shokëve nuk i duronte dot. «Është e pamundur të mos e kujtoj në çdo hap atë kohë, — mendonte Veliu. — Ah, sikur të ishin këto katër vjet tamam si ato veprimet aritmetike në tabelën e zezë dhe unë me një të fshirë, si atëhere kur isha në shkollë, t'i zhdukja nga kujtesa e të gjithëve!». Atij iu duk qesharak ky mendim dhe, duke dashur ta largonte, e pyeti nënën:

— Po babai, Vjollca ku janë?

— Babai është me shërbim, ndërsa Vjollca ka një mbrëmje rinie.

— Është rritur ndopak?

— Ka rrezik të mos e njohësh fare.

Në orën nëntë të darkës hyri Vjollca. E gja-të, pak e hollë dhe me flokë të zez, të prerë shkurt, ajo e përqafoi të vëllanë dhe iu ul pranë. A thua nuk do t'i kujtonte ndonjëherë këtë periudhë? Kur ishin të vegjël, Veliu e kishte goditur një herë me gur. Ja, atë shenjën në vetull, Vjollca e mbante si kujtim nga i vëllai. Atëhere ajo nuk i kishte treguar babait. I kishte thënë se qe përplasur tek një mur duke vrapuar. Ndërsa më vonë, kur ishte nxehur një herë me Velion, i kishte thënë babait që ai e pat qëlluar me gur. Por atëhere ishin fto-

hur gjakrat dhe Veliu e kaloi me një të qortuar. Duke kujtuar këto, ai e pyeti Vjollcën.

— A do të m'i kujtosh këto vjet kur të grin-demi?

Ajo e shikoi me kujdes dhe pak si me egërsi. Veliu u tremb nga ai shikim. Nuk duhej ta bënte atë pyetje.

— Unë tani nuk jam as e vogël e as budalla-ge. Mos pandeh se e kam pasur të lehtë dhe unë këto katër vjet. Njeriu nuk mund të qëndrojë gjith-një i shtrirë kur rrëzohet. Ai ngrihet në këmbë dhe ecën përpara. Në qoftë se ti do të veprosh kësh-tu, jo unë, por kush nuk do të guxojë të të shikojë me sy të keq si një ish-i dënuar.



Veliu u zhvesh dhe u shtri në shtrat. Banja që bëri e kishte lehtësuar. Ndjeu erën e njohur të sapunit dhe të rrobeve të lara. Kjo erë gjithnjë i kujtonte të jëmën, të përkulur në banjë mbi go-vatë, në ambientin gjithë avull. E ëma e mbuloi mirë dhe u shtri të flinte në shtratin tjetër. Por asnjërin nuk e zinte gjumi. Veliu u vërtit dy-tre herë në shtrat dhe i shkoi mendja tek dita e shkuar. I bërë gati për rrugë, ai priste tek dera e koman-dantit. I erdhi radha. Trokiti dhe hyri pak i emocio-nuar. Komandanti ngriti kokën dhe e ftoi të ulej. E shikuan për një çast në sy njëri-tjetrin.

— Erdhi dita të ndahemi, mor djalë, — e filloi bisedën komandanti, — ti lirohesh para kohe. Fak-ti që ke realizuar gjithnjë normën dhe ke marrë

pjesë gjallërisht në të gjitha aktivitetet e je treguar i disiplinuar, tregon se ti e ke kuptuar dhe vlerësuar fajin tënd. Unë të porosis që po kështu të punosh edhe paskëta. Qëllimi është që ti të ecësh në një hap me të tjerët. Marsho krah për krah me ta, mos ngel prapa, mos u shkëput anash dhe do të jesh i vlefshëm për shoqërinë.

Veliu dëgjonte me kujdes. Ai kishte pasur gjithnjë respekt për këtë burrë të vjetër e mjaft të sjellshëm. Iu duk e tepërt që t'i premtonte. Ai e dinte që komandantit nuk i pëlqenin ata që merrnin zotime solemne. Një herë ai tregonte se njëri që kishte bërë be e rrufe se do të ishte i rregullt këtej e tutje, nuk kishte kaluar as tre muaj dhe ishte kthyer prapë. Komandanti u ngrit në këmbë dhe ia preu mendimet.

— Epo suksese në jetë! — i tha.

Të gjitha këto Veliu i kujtonte atje në krevat, në shtëpinë e tij, ku kishte lindur e ishte rritur, ku çdo send e çdo kënd i kujtonte një copëz të jetës së tij.

«E kisha djalë të urtë, mendonte nëna në krevatin tjetër, — si më iku ashtu nga duart?»

Ajo u çudit kur i thanë se i biri ishte arrestuar për vjedhje. Vërtet ai gjithnjë kishte lekë nëpër duar. Ishte pleksur me shokë të këqij, që vinin e i vërshelejnë tek dritarja kohë e pa kohë. Asaj i vinte turp, i vinte mjaft turp, nga vetja, nga shokët e punës dhe nga komshinjtë.

Para dy ditësh kishte ardhur në shtëpi Kiçoja, ai oficeri që e kishte arrestuar Veliun. Ata ishin trembur. Mos vallë Veliu kishte bërë ndonjë gabim tjetër?! Por jo. Ai u tha që Veliu do të lirohej këto di-

të dhe i porositi që ta prisnin mirë dhe të interesoheshin për punë. Këtoja e dinte që babai e kishte hequr nga defteri të birin, se i kishte nxirë fagen, dhe bisedoi gjatë me të. Së fundi i ati i Veliut u bind. «Mbase ka vënë mend, mendonte e ëma. Ajo u ngrit dhe iu afrua krevatit të djalit. E mbuloi. Sytë i nguli tek rrobet që i kishte rregulluar me kujdes mbi karrrike. Iu kujtua që i biri, më përpara, mezi gjente këpucët dhe çorapet, të cilat i hidhte andej-këndeji nëpër shtëpi.

* * *

— Bjer dhe ca llaç, — i tha Veliu Besnikut, — dhe hajde të suvatojmë bashkë.

Ai pa shpatullat lakuriq të Besnikut të pjekura në diell dhe u pendua që e dërgoi prapë për llaç. Dukej i lodhur sot Besniku. Veliu i vajti prapa dhe e ndihmoi ta mbushte kovën dhe e ngjiti në bashku lart. Filluan të suvatonin. Ishin lidhur me njëri-tjetrin. Besniku e kishte lënë shkollën e ishte futur në punë. Shkollën e vazhdonte natën së bashku me Veliun, të cilin në punë e kishte usta e në shkollë bashkënxënës. Punuan pa shkëmbyer ndonjë fjalë deri sa ra çanga. Përgjegjësi i mblodhi, bëri konkluzionet e punës dhe u ndau detyrat për të nesërmen. Veliu ishte në rregull me planin, përveç kësaj atë e përmendnin edhe për ndihmën që u jepte shokëve. Kur e lavdëronin, Veliut edhe i vinte mirë, edhe i dukej sikur e përkëdhelnin. A thua punonte me të vërtetë aq mirë? «Me këta shokë, mendonte ai, e vlen të punosh».

Deri në një farë vendi eci bashkë me Besnikun, pastaj u ndanë për të shkuar në shtëpi. Rrugës po vinte Xhaferi. Ai ndaloi pak hapat dhe e takoi.

— Veli, si dukesh me punë?

— Faleminderit, jam mirë.

— Hë, bëjini shpejt ato pallate, se presin njerëzia të gëzohen në shtëpi të re, — i tha ai dhe i zgjati dorën.

Veliut iu kujtua dita kur u nis për në komitetin ekzekutiv. Në zyrën e punës, ishte pikërisht ky Xhaferi që takoi tani. Ai trokiti dhe hyri brenda me ndrojtje. Një burrë rreth të pesëdhjetave i doli përpara. Ishte i bëshëm dhe që në fillim Veliu pati përshtypjen se ishte një babaxhan.

— Pse ke ardhur, mor bir, për punë?

— Si urdhëron, për punë

— Po si të quajnë?

Veliu i tha kush ishte.

— Po ç'di të bësh ti?

— Jam murator me kategorinë e katërt.

— E ku e ke mësuar zanatin?

Veliu u skuq.

— Kur kreveja një dënim, — u përgjigj nëpër dhëmbë, me shumë turp.

— Xhaferi plotësoi fletën e punës dhe ia dha. Qvsh atëhere, ai sa herë që e shikonte, e ndalte dhe e pyeste. E pyeste edhe për shkollën.

Veliu u la, hangri dhe mori librat.

— Baba, unë po shkoj në shkollë, — i tha dhe doli.

Rrugës ai pa Skënderin dhe deshi t'i shmangej takimit me të. Skënderi nuk kishte ndryshuar fare. Po me ata flokë e favorite të gjata që i mbulonin

veshët, me pantallona të ngjitura për trupi e të gjera në fund. Mirëpo ai e pa dhe i doli përpara.

— Veli, ç'ke që tharton turinjtë kur më shikon? Mos pandeh se kam ndryshuar? Jo, jam Skënderi që kam qenë.

Veliu u shtrëngua t'i japë dorën.

— Shkojmë të pimë nga një gotë për daljer të nde në ajër të pastër?

— Jo, unë po nxitoj për në shkollë, — iu përgjigj Veliu ftohtë, por i vendosur. — Përveç kësaj nuk pi alkool.

— Oh, më falni zotëri! Nuk e dija që jini bërë kaq delikat. Më duket se ke harruar që unë të bëra njeri. Ti ishe një djalë mamaje dhe asgjë tjetër. Mirë u pafshim! — përfundoi ai dhe u rrotullua mbi taka e çau nëpër turmë.

Veliut iu prish humori. Atë natë në shkollë ai ndejti i veçuar, pothuajse nuk shkëmbeu asnjë fjalë as me Besnikun. Të nesërmen Besniku e pa përsëri të qeshur. Megjithatë, e ngau në pushim:

— Mos të ishin mbytur gjemitë mbrëmë?

Veliu heshti pak, pastaj iu përgjigj:

— Mbrëmë takova një ish-shokun tim, që më futi në qorrsokake, dhe, pa pikë turpi e quajti veten «mësuesi im i parë». Shyqyr që ka fare pakë «mësues» të tillë! — e përfundoi mendimin Veliu.

Ata u ngritën dhe vazhduan rrugën.



Njerëzit kishin ardhur në poliklinikë, prisnin të vinte mjeku. Ai s'u vonua. I përshëndeti dhe, pasi veshi bluzën, doli tek dera.

— Të vijnë gratë dhe fëmijët e vegjël, — tha ai dhe hyri përsëri brenda.

— E paska kuptuar mirë emancipimin doktori, — tha një djalë me favorite të gjata, që kishte lidhur dorën dhe kishte veshur një palë kominoshe gjithë gëlqere.

Të tjerët qeshën me shakanë e tij. Djaloshi nxori paketën dhe ia zgjati një burri të moshuar:

— Ndize, xhaxho, se kemi kohë.

Tjetri mori cigaren dhe nxori shkrepjen. Djaloshi hyri tek mjeku. E zgjidhi dorën dhe ia zgjati. Mjeku i këshilloi një radiografi dhe i dha pushim.

— Si e kini emrin?

— Veli Shpuza.

— Pasi të bëni radiografinë ma sillni mua. Ja raporti juaj. I bëni banjo herë pas here.

Djaloshi e falenderoi dhe doli.

Xhaxhoja po hynte brenda.

— Mirë u pafshim, xhaxho!

— Mirë u pafshim, bir!

Pas pak plaku doli nga dhoma e vizitës dyllë i verdhë. Atij i kishin prerë xhepin dhe i kishin marrë kuletën, në të cilën kishte pensionin që e kishte marrë një ditë më parë. Doktorin e porositi të bënte një denoncim në degën e punëve të brendshme.

*

* * *

— Janë vërtet interesante këto fakte. — i thoshte Osmani shokut të tij, Lirimit. — Edhe në vjedhjen tek poliklinika, edhe në atë të kinkalerisë

ka nga një shenjë të Veli Shpuzës. A thua ka filluar prapë të vjedhë?

— Faktet kështu flasin. Në poliklinikë ishte regjistruar për vizitë. Dorën e kishte të lidhur, e verifikova unë. Ndërsa në dyqan u gjet një fletore shënimesh që i përket atij. Këto nuk janë pak.

— Cili është mendimi yt, mos duhet ta arrestojmë?

Lirimi ngriti supet:

— E ç'na mbetet tjetër?

Osmani ra në mendime. U ngrit dhe shkoi në zyrën e Kiços, të cilit i parashtroi çështjen.

— Duhet t'i sqarosh mirë këto fakte, — i tha Kiçoja. — Mos u nxitoni. Ngarkoja këtë detyrë Lirimit. Ndihej dhe ti.

Osmani ia dha dokumentet e çështjes Lirimit. Në mëngjes ai e gjeti Lirimën në zyrë. Kishte ardhur më shpejt se zakonisht dhe ishte zhytur në studim.

— Mua më duket se jemi gabuar, shoku shef.

— Për çfarë jemi gabuar?

— Në të dy rastet metoda e kryerjes së krimit, nuk i përgjigjet asaj që ka përdorur Velin kur vepronte. Përveç kësaj më duket budallallëk regjistrimi i tij në poliklinikë. Ai na ka lënë adresën e tij fare hapur edhe në kinkaleri. Kur është gjykuar herën e parë rezulton se ai është kapur në flagrancë dhe vjedhjet e tjera nuk kanë pasur asnjë gjurmë të tij. Ai i ka pranuar në hetuesi me prova të tjera.

— Ai mund ta ketë regjistruar emrin për të treguar se u vizitua dhe se nuk ka asnjë lidhje me vjedhjen, ndërsa fletorja i ka rënë. Ai vete në shkollë natën dhe mund ta ketë pasur me vete. Megjithatë sqaroi mirë këto gjëra. Mos u nxit!

Lirimi vendosi t'i sqaronte një për një, që të krijonte bindje. Shkoi në ndërmarrje dhe dëgjoi fjalët më të mira për Veliun. Po, ai e kishte vrarë dorën, por e kishte mjekuar atë me mjetet e ndihmës së shpejtë që kishte objekti, ndërsa raport nuk kishte marrë. As në spital për vizitë nuk kishte qenë. Shuqërohej me të gjithë, po më shumë me Besnikun. I lidhte mosha dhe shkolla.

Lirimi i shoshiti mirë këto gjëra. Ai mësoi se në shkollë Veliut i kishte humbur një fletore dhe se ai e kërkonte. Pas këtyre, Lirimi mendoi se kishte të drejtë të bënte pyetjen «Mos vallë një person tjetër vepron dhe e përdor si perde Veliun, për të na futur neve në rrugë të shtrembër dhe për t'i bërë keq atij?» Kjo pyetje e mundoi gjithë ditën. Po të ishte kështu, ai duhej ta gjente patjetër këtë njeri. E rishikoi edhe një herë çështjen e Veliut dhe nënvizoi emrin e Skënderit. Për të ai kishte dyshime. E dinte që ishte vjedhës dhe vagabond, por akoma nuk kishte mundur të shtinte në dorë prova të plota për ta demaskuar si të tillë. Të gjitha këto mendime ai ua tha edhe Kiços dhe Osmanit, të cilët i miratuan mendimet e tij. Së bashku ndërtuan një plan të hollësishëm. Përshkrimi që i kishte bërë atij denoncuesi, për atë që e kishte vjedhur tek klinika, përputhej me tiparet e Skënderit.

Lirimi u dha detyra policëve dhe punëtorëve të policisë dhe ishte në pritje. Kishte shumë besim në këtë variant, aq sa i dukej se e tepronte. Ja ku erdhi edhe dita që të ndeshej me Skënderin. Ai mësoi se Skënderi do udhëtonte me tren për në «K». Vendosi të shkonte vetë me të. Mori me vete Shpresën, punëtoreshën e re të policisë që atë ditë dukej si një udhëtare e zakonshme dhe një punëtor policie

të veshur civil, e u shpërndanë nëpër turmë. Erdhi treni. Njerëzit filluan të hypnin me ngut, siç ndodh në raste të tilla.

— Urdhëro hyp, moj nënë! — thirri Skënderi dhe e mori përpara.

Plaka që gjeti një përkrahës në gjithë atë turmë hypi përpara tij.

— Bëfsh hajër, more bir!

Shpresa, që ishte afër, e pa Skënderin me sa shkathtësi i futi duart në xhepat e plakës. Në njërin kishte një shami, të cilën e futi me nervozizëm përsëri në xhep, ndërsa në tjetrin një pako biskota. Skënderi e mori, dhe si e pa që plaka ishte një «gjah» i papërshtatshëm i vuri brylat dhe çau përpara. Lirimi pa një burrë që goditi me çantë në kokë Skënderin duke i bërtitur: «Haidut». Po Skënderi i shpëtoi nga duart dhe hyri në vagon. Deshi të bënte një dredhi, të zbriste nga dera tjetër dhe t'ia mbathte, por punëtori i policisë e zuri. E shoqëruan për në polici. Me vete morën atë burrin dhe dy veta që e panë skenën.

Skënderi bërtiste sa herë që e pyeste Lirimi:

— Ju lutem. lëshomëni! Unë s'kam bërë asgjë!

Burri, të cilit i kishin futur dorën në xhep, po çuditej: «Si ishte e mundur të vepronte kështu një alamet djali»? Më në fund Skënderi pranoi se e kishte futur dorën në xhep.

— Na thuaj, çfarë vjedhjesh të tjera ke kryer? — e pyeti Lirimi.

— Ky më duket një nga zakonet tuaia më të këqija. Unë pranova se futa dorën në xhepin e këtij shokut. Nuk iu miafton kjo? E përse mendoni se kam bërë viedhje të tjera?

— Unë nuk po të pyes për atë plakën që i mo-

re një pako me biskota, — i tha qetë-qetë Lirimi, — se më vjen ndot ta kujtoj atë gjest, por për vjedhje të tjera.

— Jo, unë nuk kam vjedhur asgjë.

Shpresa shikonte sendet personale të Skënderit. Në to ajo gjeti një raport mjekësor, të cilin e futi në mezin e një libri dhe ia zgjati Lirimit. Ky e mori dhe mezi u përmbajt nga gëzimi.

— Kini qenë këto kohët e fundit në spital për vizitë?

— Jo. unë jam miaftë mirë nga shëndeti.

— E njihni Veli Shpuzën?

— E njoh, por nuk kam asnië lidhie me të.

— Me të vërtet nuk ke asnië lidhje? Mua më duket se ky raport mjekësor, që u gjet në xhepin tuaj, mban emrin e Veliut. Si e shpjegoni këtë, mos doni ta thërrasim Veliun që të na japë shpjegime për këtë?

Skënderi e kuptonte ç'do të thoshte kio. Të vinte Veliu e ta shikonte në këtë gjendje? Në asnjë mënyrë. Si drejtin nuk e zhduku atë raport! Lirimi e kuptonte hutimin e tij. Ai vendosi të përparonte.

— Ky raport mjekësor mban datën e një viedhieje xhepush në poliklinikën e spitalit. Ai diali na foli edhe për një djalë hokatar që ju ngjante shumë juve.

— Unë nuk kam dijeni për gjëra të tilla! S'më interesojnë ata pleqtë tuaj! Më duket se doni të më mirrni në qafë — kundërshtoi me dëshpërim Skënderi.

Punëtori i policisë hvri në zvrë.

— Futi brenda! — tha Lirimi.

Brenda hynë pesë diem në moshë të Skënderit. Lirimi i vuri në radhë E futi dhe Skënderin

në radhë. Pastaj ai ftoi xhaxhon që kishte bërë denoncimin për vjedhjen në poliklinikë. Xhaxhoja pa hezituar zgjodhi Skënderin.

— Ky është, shoku hetues.

— Faleminderit, mund të shkosh. Mund të shkoni dhe ju, djema. Ju faleminderit!

Ata dolën. Skënderi mbeti përsëri në karriken përballë.

— Hë, Skënder, përse e bërë tërë këtë lojë? Ç'pate me Veliun?

— Ai më fyeu rëndë. Më pa me një mospërfillje të tillë kur e takova si u lirua nga dënimi, sa që m'u duk vetja si ndonjë qen i zgjebosur dhe desha ta kafshoj, ta kafshoj rëndë. Më vjen keq që nuk ia arrita dot qëllimit.

— Eh, Skënder, Skënder! Ti akoma nuk po shikon se ç'bëhet rreth teje. A e di si je ti bashkë me disa llumra të tjerë? Je tamam si ato pemët e zhveshura që ndodhen në mes një lumi që vërshon përpara pa u ndalur. Ky lumë po ju gërryen rrënjët e po ju nxjerr anash.

*

* *

Çështja iu referua Kiços, i cili nxori konkluzione të drejta.

— A nuk do të ishte mirë, — tha ai, — që gjykimi i Skënderit të bëhet në kolektivin e punës së Veliut? Unë mendoj se kjo vlen të diskutohet gjë-rësisht. Ka forcë të mëdha edukative.

Dhe ashtu ndodhi. Punëtorët thanë fjalën e tyre. Ata nxorën konkluzione. Veliu e shikonte

këtë skenë. Sytë i kishte pak të përлотur, por shikimi i tij ishte i kthjellët. Ai shikonte përpara dhe i tingëllonin në vesh fjalët, të cilat kurrë nuk do t'i harronte: «Ti marsho krah për krah me ne, mos u kthe prapa, mos u shkëput anash»!

— Kështu e vlen të jetosh, — tha ai.



PERGJIGJE LETRËS

Fshikëllima e erës të rrënqethte, megjithëse tanimë isha tharë dhe ngrohësia në zjarr. Jashtë binte dëborë. Atë ditë isha me shërbim në një fshat. U ktheva në shtëpinë e parë të fshatit. E zonja e shtëpisë ishte një nënë si të gjitha nënat, e thinjur, pak e kërrusur e me duar të ashpra. Ajo kishte një shikim të ëmbël, përkëdhelës.

I zoti i shtëpisë do të vinte vonë. Plaka pregatiste darkën. U ngrita për t'u hedhur një sy fotografive të vendosura në mur. Më tërhoqi vemendjen fotografia ballas e një vajze të re. Megjithse, ajo fotografi ishte e riprodhuar, nuk mund ta zbehte bukurinë e vajzës. Tek po mendoja përse ishte rrethuar me shirit të zi fotografia, dëgjova një psherëtimë. Ktheva menjëherë kokën. Ishte plaka. E kuptova që kërshtëria ime kishte hequr koren e një plage, që siç dukej, sapo kishte filluar të mbyllej.

— Më fal, nënë, — belbëzova. Ajo fshiu lotët me cepin e shamisë dhe doli pa folur. Pikërisht kjo heshtje ma ndezi kureshtjen të dija diçka rreth vajzës.

Në darkë në bisedë e sipër mësova se vajzën e kishin vrarë para tre vjetësh dhe se autori ishte zbuluar vitin e kaluar. Unë jam oficer, njeri i za-

natit, kjo më shtyti të interesohem për zbulimin e kësaj vrasjeje. Të nesërmen, me gjithë kundërshtimin e pleqve, u nisa. Kisha vendosur ta gjeja e ta studjoja këtë dosje. Shpejt ajo më ra në dorë. Fillova ta lexoj. Ja si është zhvilluar ngjarja:

Simoni thithte cigaren me qejf. I pëlqente të shikonte tymin e kaltër të duhanit tek e shtynte sa andej këtej ajri i dhomës. Eh ç'punë e lodhshme, ç'telashe! Kishte tre vjet që merrej me atë punë. Herë-herë, binte në një gjendje që mendonte se do të ishte më mirë të mos punonte në këtë sektor, por kur e «zgjidhte nyjën», i dukej sikur nuk kishte menduar kurrë për vështirësitë. Ja, në një gjendje të tillë ishte edhe tani.

Nga kjo gjendje e nxori zilha e telefonit. Simoni e la të binte. Herën e tretë ngriti me përtesë dorëzën:

— Ju dëgjon... — Ai tha numrin e telefonit.

— Ju flet kryetari i degës.

— Jam Simoni, shoku kryetar.

— Merr dosjen «27» dhe hajde tek unë.

Filloi të kërkonte çelësin e kasafortës. U vërtit mjaft dhe më në fund e gjeti: e kishte në dorë.

— Ptu, të marrtë dreqi! — mallëkoi ai çelësin dhe veten e tij, që nuk kishte asgjë në terezi për atë dosje që i kërkoi kryetari.

E gjeti dosjen, e hapi në një faqe dhe i hodhi një sy shpejt e shpejt. U nis për te kryetari. Në korridor takoi një shokun e tij, punëtor operativ.

— Ku kështu Simon? Ç'është gjithë ky vrull?

— Po shkoj të bëj një dush, — u përgjigj si pa qejf Simoni dhe ngjiti shkallët.

— Kujdes mos plevitosesh, — e thumboi shoku. Simoni hyri në zyrë dhe u ul në karriken që i treguan. Përveç kryetarit në zyrë ishte edhe shefi i policisë.

«Tani dëgjo, o Simon mavria. Njëri hidh e tjetri prit. Po ky shefi im ku i ka syzet?», mendoj me vete Simoni.

Shefi i policisë nxori syzat dhe filloi t'i pastrojë.

Simoni u çudit dhe u shqetësua njëkohësisht. Mos vallë i shprehu me zë të lartë mendimet e tij?!

— Na thuaj deri ku kemi arritur për sqarimin e versioneve që kemi ngritur për zbulimin e vrasjes së Besës.

Simoni e hapi dosjen në faqen tetë dhe i hodhi një sy fletës së daktilografuar.

— Versioni për Ahmet Seferin u rrëzua. Rezultoi se ditën që është kryer vrasja, ai nuk ka qenë në fshat. Këtë e provuam plotësisht. — Shefi i policisë pohoi me kokë. Në plan, përbri kësaj detyre, ai kishte vënë nënshkrimin.

Versioni nëse krimin e ka kryer djaloshi që e dashuronte u rrëzua. Ne e thirrëm, bile ai qau dhe tha tekstualisht: «Si mund të ngrija dorën kundër saj?».

Kryetari diç shkroi në bllokun. Shefi heshtte. Këtë detyrë ai nuk e kishte kontrolluar. Kjo duhej shoshitur mirë. Edhe Simoni e kuptonte që këtu diçka nuk shkonte, por vendosi të vazhdojë.

— Unë mendoj të qëndrojmë tek e dyta, — tha kryetari. — Të mos tregohemi sentimentalë. Madje, edhe e para, të sqarohet më me kujdes. Ç'detyra kanë mbetur akoma pa kryer?

Simoni vështroi nga shefi sikur t'i kërkonte ndihmë. Por siç dukej ai nuk kishte ndër mend të fliste, kështu që numëroi një sërë detyrash. Kryetari e shikonte i çuditur.

— Gjithë këto i ke lënë pa zbatuar?

— Po, po punojmë shoku kryetar...

— Jo, djalo, nuk punohet kështu. Kemi detyra të mëdha përpara. Populli pret nga ne. Pa lexoje këtë se ç'thotë?

Ishte një letër dyfaqesh, e shkruar me një shkrim të madh e të pastërvitur:

«... Unë kam besim tek Partia dhe tek organet e punëve të brendshme se autori i vrasjes së vajzës sime do të zbulohet. Por, më duket se në këtë çështje ka zvarritje. Sa më shumë të kalojë, aq më keq është. Hekuri rrihet sa është i nxehtë!».

Simonit i erdhi turp për dembelizmin e tij. E njihte babanë e Besës, që shkruante këtë letër. Ishte një burrë plak. Ishte përgjakur edhe me diversantët. Ai ia zgjati përsëri letrën kryetarit. Ky e mori, e palosi me kujdes dhe e vendosi në sirtarin e tryezës.

— Ç'thua, Simon? Kur t'i përgjigjemi xha Brahos?

Simoni heshti. Ai po mendohej thellë. Kjo letër me atë shkrim të thjeshtë shtremba-shtremba, kërkonte mundim, sakrifica për t'iu përgjigjur. Ai i premtoi në heshtje këtij plaku se për këtë mësim të mirë që i kishte dhënë do t'i ishte mirënjohës për jetë. Ndërsa kryetarit i tha shkurt:

— Ai ka shumë të drejtë.

Si diskutuan edhe pak rreth detyrave që dilnin, Simoni u largua.

— Më duket se xha Brahua nuk na shkundi vetëm ne, por edhe djaloshin, — tha kryetari.

— Ai s'ka shumë faj. Në shtëpi e kanë përkëdhelur, ndërsa ne nuk i kemi qëndruar aq afër. Unë i kam qëndruar ca ftohtë që kur jemi grindur një herë, — tha shefi i policisë.

— Me ta duhet kujdes. Ata janë të rinj dhe të shkathët. Energjia e tyre duhet kanalizuar në të mirën e punës. Edhe ne në fillim kështu kemi qenë, veçse nuk kishte kush të na mësonte. Ne ishim të parët.



— Mua më kanë pyetur edhe një herë për të gjitha këto, shoku hetues. Por megjithatë po ju përgjigjem prapë.

— Jo, unë nuk dua të më përsëritësh ato që u keni thënë të tjerëve. Mua më thonë vetëm me cilin keni udhëtuar, kë keni takuar më 24 tetor. Si mund ta faktoni se nuk keni qenë në fshat atë ditë.

— Unë në fshat shkoj rrallë. Jam një njeri që shikoj hallin tim. Atë ditë nuk kam udhëtuar më këmbë, por me makinë të qytetit. Isha së bashku me Xhemon, djalin tim të madh. Targën e makinës nuk e mbaj mend, por shoferi ishte një burrë i moshuar që kishte hequr krejt dhëmbët dhe ato ditë do t'i vinte të rinj. Ora ishte katër e gjysmë pasdite. Këtë na e tha vetë shoferi në bisedë e sipër.

Simoni mbajti shënim ato dhe e lejoi të largohet. Duhej gjetur shoferi. Deponimi i tij ishte i vlefshëm. A do ta mbante mend ai vallë këtë pasa-

gjër që kishte hipur një vit e gjysmë më parë në makinën e tij?

I njoftoi shefit drejtimin e ri dhe u nis me një makinë.

Ne karroceri ishte fresk. Ai u mbështuall dhe u ul mbi një arkë ambalazhi. Makina ecte shpejt. Filloi t'i dhimbte shpina ngaqë përplasej në karroceri. I vinte gjumë. Shkoi drejt e në hotel dhe, si zuri vend, zbriti për të ngrënë darkën. Në këtë qytet ai ishte si i huaj. Kishte qenë një herë në ekskursion kur ishte pionier, po nuk mbante mend asgjë.

Të nesërmen që në mëngjes, shkoi në park dhe pyeti për sekretarin e Partisë. E shpunë tek një djalosh i ri, veshur me kominoshe tërë vaj. Simoni e pyeti:

— Ju jini sekretari i organizatës bazë të Partisë?

Djaloshi që, siç duket, e kuptoi mirë pyetjen e Simonit, u përgjigj i qetë. Ata i dhanë dorën njëri-tjetrit dhe u hoqën pak mënjane. Simoni i tha përse interesohej.

— Pleq me dhëmbë të vënë plotësisht kemi vetëm katër. Një vit e gjysmë më parë i ka vënë Feimi me Kalon. Të pyesim dispeçerin në ç'rrugë janë.

Ata shkuan në zyrë.

Në tren Simoni zuri një kabinë, vuri çantën në krah të djathtë dhe u mbështet për t'u qetësuar. Me shikim të përqëndruar në një pikë të vetme nisi të mendojë. Veshi i kapi një shushuritje zërash dhe shikoi djathtas. Tek dera e kabinës kishin që-

ndruar një djalë dhe një vajzë të kapur për dore.
— A mund të rrimë këtu? — e pyeti djaloshi Simonin.

— Urdhëroni! — u përgjigj ai.

Ata u ulën dhe filluan të bisedonin kokë më kokë.

«Po, mendoi Simoni, edhe Besa do të krijonte familje, do të lindte por s'e lanë». Atëhere ai vendosi ta kujtonte edhe një herë ngjarjen duke e ndërtuar sipas materialeve të dosjes:

«Ishte dimër. Dëborë. Më përpara fshatarët pothuajse e kalonin kohën brenda, ndërsa tani dukej sikur të gjithë ishin përtërirë. Sado ftohtë që të ishte, të gjithë shkonin dhe fillonin punën. Besa atë ditë ishte nisur për t'i ndihmuar babait për të mbajtur drutë. Rruga kalonte nëpër pyll. Kur u kthye nga pylli, i ati e pyeti të shoqen si zakonisht për vajzën. Ajo i tha se e bija ishte nisur për tek ai që në orën 16. Plaku u shqetësua dhe doli ta kërkojë. Ora ishte tetë e darkës. Ç'bënte vajza jashtë? Doli ta kërkonte me një fener dhe me shkopin e tij, që s'e lëshonte nga dora. Në fillim e kërkoi vetëm, më vonë e ndihmuan edhe të tjerë. Vonë, aty nga ora një e natës, një djalosh i ri dëgjoi një zë të dobët. Nxitoi në atë drejtim. U bëri zë të tjerëve, që ishin përhapur nëpër pyll. Besa ishte shtrirë afër një dëllinje dhe rënkonte me një zë të dobët. Ai i vuri dorën ndënë kokë që ta ngrinte, por ajo rënkoi më fort. Sakaq mbërritën edhe të tjerët. Kur e vendosën në një vig të sajuar aty për aty, ajo i hapi sytë jashtë mase nga dhembja dhe desh të thoshte diçka. Në kokë kishte marrë një të goditur gjatësore, siç dukej nga një sëpatë. Pas dy orësh vdiq». Përfytyroi një njeri që i shkonte prapa Besës

në pyll. S'mund t'ia shihte fytyrën. Ia kishte mbuluar një perde e zezë.

Në sedilen përballë bisedonin djaloshi me vajzën. Ai i mbylli sytë përsëri.

Të gjitha këto skena nuk i përgjigjeshin dot pyetjes «përse e vranë?» dhe «kush e vrau?». Më duhet të pyes një njeri që ia njihte zemrën Besës. Atij iu kujtua se xha Brahua në pyetjen e tij kishte thënë:

«Ajo edhe kur vinte te Zenepja na thoshte deri në ç'orë do të rrinte». Simoni vazhdoi ta pyesë Zenepen. U ngrit dhe doli në dritare. Nxori kokën dhe e ndjeu veten të çlodhur.

Pas dy ditësh në degën e punëve të brendshme u paraqit Zenepja. Në fillim në zyrën e Simonit ajo e ndjeu veten keq. Ishte e hollë e gjatë, flokët i kishte prerë shkurt, kishte veshur një fustan të thjeshtë.

— Keni qenë në aksion? — e pyeti Simoni duke hapur njërën kanatë të dritares.

— Po, — u përgjigj ajo menjëherë.

Simonit iu duk vajzë e gjallë. Atij i kishte qëlluar të pyeste edhe herë të tjera vajza nga fshati. Ato ishin të ndrojtura, të turpshme dhe nuk të shihnin në sy.

— Të kam thirrur të bisedojmë së bashku për Besën, — i tha ai thjesht sikur t'i kujtonte një marrëveshje.

Vajza uli kokën. Shumë kujtime iu ngjallën atë cast. Simoni nuk e la të mendonte shumë.

— Si e njeh Besën?

— Ne jemi rritur bashkë, — filloi të fliste vaj-

za. — Besa ka qenë gjithmonë një nxënëse e mirë. Me ne shoqërohej nganjëherë edhe Vebiu, megjithëse ai ishte më i madh në moshë. Ai i vardisej dhe i bënte gjithnjë presion. Ai duket e donte Besën, por e donte në një mënyrë të çuditshme. Kur i doli bursa për në shkollën pedagogjike, ai bëri ç'ishte e mundur që të mos e linte. Por ajo shkoi. Ai vajti për ta takuar disa herë. Unë u çudita, kur ajo, në pushimet e vitit të parë, më tha se nuk do të shkonte më në shkollë. U çudita se ajo ishte nga nxënëset më të mira. Kur e pyeta ajo vuri kokën në supin tim dhe filloi të qante me ngashërim. «Unë nuk mund të vete në shkollë, nuk mund të bëj asgjë, unë nuk i përkas vetvetes». Ja kështu më tha ajo. Megjithëse më kishte shoqe të ngushtë, nuk më tha për fejesën e saj. Kjo m'u duk një gjë e papritur. Natyrisht unë e kuptoja që ajo nuk mund të fejohej me Vebiun, por edhe fejesa me një djalë larg fshatit, nuk më shkonte kurrë në mendje. Pas fejesës ajo u gjallërua në mënyrë të dukshme. Por kjo nuk zgjati shumë. Një ditë, kur po rrinim bashkë në odën time, më hodhi duart në qafë dhe më tha duke më shikuar në sy:

— Sa e lumtur je ti! E dua shumë jetën time, por... — Ajo heshti. Unë prita të më thoshte diçka, por më kot.

Vajza heshti. Simoni ndejti edhe një copë herë duke e shikuar. Më në fund ai bëri një pyetje:

— Ç'mendim keni ju për të gjitha këto?

Vajza ndejti në heshtje disa minuta.

— Nuk di ndonjë gjë të sigurt, por as vetë nuk e kuptoj. përse i lidh gjithë këto me të njëjtin person...

Simoni e përcolli deri tek dera e degës dhe urdhëroi një polic që t'i gjente vajzës ndonjë makinë.

Në zyrë, Simoni i hodhi një sy fletës në të cilën kishte bërë skicën e detyrave që do të ngrinte në plan, dhe me të në dorë trokiti te shefi. Pas pak shefi mori në telefon kryetarin dhe kërkoi t'i presë. Të dy hynë në zyrë. Simoni ishte më i gjallë se herët e tjera, por më i emocionuar. Të parashtroje tek kryetari një plan veprimi, nuk ishte gjë e lehtë. Kjo vlente më tepër se një provim. Ai, pasi e studjonte mirë të thërriste në zyrë dhe të bënte pyetje të papritura. Nëqoftëse nuk ishte i përgatitur për rrugëdaljet ai «të rrëzonte». E kjo do të thoshte të paraqiteshe edhe një herë në provim, të punoje më seriozisht.

Simoni doli andej i gëzuar.

Shefi e thirri në një kohë kur Simoni po martej të dilte.

Në zyrë ai gjeti Vebiun. Ky ishte një djalë i qeshur, i hedhur por këto kohët e fundit ishte hequr shumë. Simoni e kishte takuar edhe disa herë të tjera dhe i vinte keq. Ai nuk ishte i fejuari i Besës. I fejuari i saj ishte një tjetër, nga një fshat fqinj. Ai tani rrinte i qetë dhe punonte. Të paktën kështu thoshnin për të.

Vebiu ishte dhënë shumë pas Besës. Ata ishin rritur bashkë. Të dy shkonin e ktheheshin bashkë nga shkolla. Mësonin bashkë. Ata ishin mësuar kaq shumë me njëri-tjetrin, sa që kur s'takoheshin u dukesh sikur diçka u mungonte. Kur u rritën, filluan t'i largoheshin njëri-tjetrit, jo se nuk u pëlqente të

rrinin bashkë, por sepse ata tani ishin të rritur dhe të tjerët i shikonin ndryshe marrëdhëniet e tyre. Ky largim e bëri të mendohej më mirë Vebiun për të ardhmen. Ai nuk mund të rrinte dot pa të. Dalgadalë ajo ndjenjë e ngrohtë, që përshkonte marrëdhëniet e tyre, kishte filluar të rritej së bashku me ta. Ai nuk i kishte folur Besës për ndjenjat e tij, sepse priste një çast të përshtatshëm. Dhe u çudit shumë kur dëgjoi se Besa u fejua. Si ishte e mundur?! Kaq papritmas i ra kjo Vebiut, sa që një ditë e ndaloi dhe e pyeti:

— Ç'janë këto fjalë që fliten?

— Janë të vërteta.

— Po mua më harrove?

— Ne kemi qenë shokë dhe të tillë do të mbelemi.

— Mirë. Atëhere jetë të lumtur!

Kaq kishte thënë Vebiu dhe ishte larguar. Ato ditë atij as i punohej e as i flihej. Më vonë çdo gjë kaloi. Nuk mund të thuash se ajo që kaloi nuk la gjurmë. Përkundrazi, brazdat ishin aq të thella sa që koha e kishte të vështirë t'i mbushte. Por kur ndodhi gjëma, atij iu përtërinë të gjitha kuitimet e kaluara dhe humbi përsëri vetësinë. Këto Simoni i kishte mësuar nga goja e Vebiut. Kështu që nuk u çudit për takimin me të. Vebiu e kishte bërë zakon që sa herë të zbriste në qytet të kthehej nga dega e të interesohej. Herë-herë jepte edhe ndonjë mendim. Këtë ai e konsideronte si detyrë ndaj Besës.

Sot ai kishte bërë një njoftim interesant. Në shtëpinë e një fshatari kishte parë sëpatën e xha Brahos. Me këtë sëpatë duhej të ishte bërë vrasja, sepse ajo ndodhej në samar të kafshës dhe, kur u gjet kufoma, nuk ishte më në vendin e saj.

— A e njeh ti sëpatën e xha Brahos? — pyeti Simoni.

— Po, atë e kam përdorur kaq herë.

— Mund të shkoni — i tha shefi i policisë, — por mos e bisedoni me njeri këtë.

Kur Vebiu doli, shefi me Simonin shkëmbyen nga një shikim të shpejtë.

Vebiu u nis për në fshat me makinën e parë që gjeti. Në fillim u hodhi një shikim të shpejtë pasagjerëve, ndërsa, kur filloi t'i shihte me kujdes, u çudit. Mirë i thonë që sheh mendja e jo syri. Ai kishte njohur Basriun, moshatarin e tij. Ata u ngri-tën dhe u përçafuan me njëri tjetrin, megjithëse makina hidhej nëpër gropat e rrugës së paasfaltuar.

— Që nga kështu Basri?

— Jam nisur për në fshat.

— A e mbarove shkollën?

— Ja, ky është viti i fundit, por kam marrë një lejë shëndetësore që kërkon klimë malore.

— Për klimë malore mos u mërzit, — qeshi Vebiu, — këtu ajo nuk do të të mungojë.

Pasagjerët i shikonin duke qeshur këta të rinj, që bisedonin me zë të lartë, e që, siç dukej, kishin plot kujtime e plot gjëra për t'i thënë njëri-tjetrit. Por gjatë gjithë rrugës nuk thanë asgjë. Kur frenoi makina dhe dy shokët muarën rrugën për në fshat Basriu papritmas pyeti:

— Ç'flitet për Besën?

— Tani për tani asgjë. Duket sikur puna ka ngecur. Edhe sot isha në degë e u interesova. Më thanë se po punojnë, por unë nuk marr vesh hiç nga punët e tyre.

— Që po punojnë ti mos ki asnjë pikë dyshimi,

por ti duhet t'i ndihmsh. Ti je në fshat, midis njerëzve.

— Unë po punoj, — u përgjigj Vebiu — kur të mësoj ndonjë gjë do të të njoftoj edhe ty. Ndosh-ta ti më ndihmon.

Ata u ngritën. Dielli po perëndonte. Horizonti ishte skuqur.

Një djalosh i gjatë, elegant e përshkoi mes për mes bulevardin, dhe, si pa edhe një herë orën e dorës në dritën e një llampe, u kthye në një rrugicë nga e maita. Pas një çerek ore ishte ulur mbi një gur dhe vërshëllente me zë të ulët një melodi që i pëlqente shumë. Një e kollitur e thatë e detvroi të kthente kokën. U ngrit dhe u takua me të porsardhurin. Si shkëmbyen disa fjalë, djaloshi pyeti:

— Hë, ç'të reja ka nga ju?

Tjetri thithi një herë cigaren dhe u përgjigj:

— Tani për tani ne vendosëm, si të thuash, «kontaktin psikologjik». Së shpejti mund të bisedoj lirisht. Sëpata që është gjetur në shtëpinë e Selës është e xha Brahos. Këtë e pranon edhe i zoti i shtëpisë. Ai ishte çuditur kur e kishte parë.

Kështu ata biseduan gjërë e gjatë. U ngjitën. Dukeshin vetëm siluetat e tyre.

— Epo, — tha i gjati pasi thithi cigaren, — mirë u pafshim dhe sukses!

U ndanë. Cigaret dukeshin në errësirë si dy xixëllonja që fluturonin në drejtime të ndryshme.

Të nesërmen Simoni punonte në zyrë. E lajmëruan se e kërkonin. Pas pak një polic futi brenda një fshatar, që mbante një send të mbështjellë me një gazetë.

«Është Sala me sëpatën» mendoi Simoni.

Fshatari u ul në karriken përballë Simonit dhe priste që ky t'i fliste.

— Kur je grindur me xha Brahon? — e pyeti ai Salën.

— Kjo është një gjë e parëndësishme, besoj se nuk e vlen as ta them.

— Mirë. Mos e thuaj. Vetëm kujtohu të më thuash se kush ishte aty afër jush.

Sala filloi të mendohej. Rrudhi vetullat dhe përqëndroi sytë në një pikë.

«Një njeri që mendon kaq gjatë nuk mund të flasë kurrë pa përgjegjësi», mendoi Simoni. Ndërkohë trokiti dera. Brenda hyri një polic. Ai la një copë letër mbi tavolinë dhe pa marrë leje doli. Simoni hapi letrën në pëllëmbën e dorës dhe lexoi: Është në qytet. E ka ndjekur prapa. Unë jam «me të»!

Ndërkohë Sala i tha emrat e personave. Simoni i shënoi, por siç duket nuk e kënaqën. Ai i tha Salës se do ta mbante sëpatën dhe u përshëndet me të. Si doli Sala, ai mori nga tavolina gërshërën dhe preu spangon. Nxori sëpatën. Tehu i saj qe i ndryshkur. Ai nxori një lentë nga sirtari i tavolinës dhe filloi ta hetonte me kujdes sëpatën. Në bishtin e sëpatës, ai dalloi disa njolla me ngjyrë të kuqe të errët. I kruajti me kujdes në një copë letër dhe i futi në një zarf. Pastaj shkoi t'i raportonte shefit.

— Kam ardhur të bëj një bisedë me zemër në dorë me ty.

Sotiri, që akoma s'e kishte mbledhur veten nga gjumi, si hapi gojën dhe psherëtiu, i tha:

— Vebi, ç'është kjo vizitë tani. Ora është dy e natës. Mos ke luajtur menç?

— Jo, unë nuk kam luajtur menç, por mati mirë fjalët. Jemi vetëm për vetëm, nata është me ne. Ajo nuk di të dëshmojë, është memece.

Tjetri e kuptoi që nuk duhej bërë asnjë shaka. U ngrit nga shtrati, mbathi llastikat dhe u zgjat të ndizte llambën, por vizitori nuk e la.

— S'është nevoja. Ja kemi parë surratin njëri-tjetrit. Drita është një dëshmitar i padëshërueshëm.

I zoti i shtëpisë filloi të mendonte seriozisht, por i duhej edhe kohë.

— Folë, përse ke ardhur?

— A të kujtohet dhjetori i vitit 19...

— Që atëhere kanë kaluar dhjetë vjet.

— Dëgjo, qafir plak! Përgjigju saktë.

— Më kujtohet, — tha tjetri qetë. Dukej që biseda kishte marrë një karakter të padëshërueshëm. Vendosi të manovrojë se mos ndoshta e zbuste.

— Ja, për atë kohë do të bisedojmë.

— Na, dridh një cigare një herë.

— Të thashë që të heshtësh — i tha vizitori dhe, si e mbërtheu me të dy duart për jake, e shtriu për dhe dhe nisi ta shtërngojë. Të zotit të shtëpisë ment po i zihej fryma. Ai nisi të përpëlitej dhe me një përpjekje të dëshpëruar çliroi pak grykën sa për të folur.

— Aman, mos!

Vizitori e kuptoi se ç'donte të thosh kjo dhe e lëshoi.

— Ç'kërkon prej meje?

— Të vesh tek ata.

— Të vete tek ata! Oh, mos vallë të duket e thjeshtë?

— Po kjo mua më duket shumë e thjeshtë në krahasim me atë që mund të ndodhë po qëndrove tek këta.

— Po përse, unë jam i mbështjellë me hi.

— Ka fryrë era dhe të ka hequr hirin. Ti tani dukesh që djeg.

— Follmë më troç.

— Për ty dëgjova fjalë. Të kanë ngritur një grackë. Unë erdha të të lajmëroj dhe ata ta gjejnë grackën bosh.

— Po ti?

— Unë akoma jam i mbuluar me hi.

— Mos vallë ti nuk djeg?

— Unë djeg, por nuk më sheh kush.

— Ptu, — pështyu tjetri — po përse deshe të më mbytësh?

— Mos u bëj çilimi. Desha të më kuptoje.

— Kur të kaloj?

— Nesër më darkë.

— Hajde shkojmë bashkë.

— Jo. Unë duhet të djeg akoma.

— Mirë, u muarëm vesh. Nesër, megjithëse...

Vizitori e përfshiu edhe një herë për fyti.

— Mos e hap gojën më. Të thashë nesër.

U ngrit, dhe si i tha diçka në vesh, e përqafoi dhe u zhduk.

Po zbardhte. Ai nxitohej dhe, si hapi me kujdes derën e një shtëpie fshati, hyri brenda dhe pa zgjuar njeri, u zhvesh e hyri në shtrat. Gjumi nuk e zinte. Zgjati dorën tek paketa, mori një cigare. Deshi ta ndizte, por u pendua. Atëhere e futi në gojë dhe filloi ta kafshonte, pastaj e nxori nga goja dhe nisi ta thërmontë me dorë. Kështu e zuri gjumi. Të nesërmen i dhimbtë koka.

Atë natë edhe një njeri tjetër ishte i shqetësuar. Ai ishte hieja e vizitorit që nuk iu nda. Atë natë, teksa vizitori thithte lëngun e duhanit, ai nxitonte për të vënë në dijeni për bisedën «me zemër në dorë».

Të nesërmen, natën vonë, një njeri nëpër pyll ecte dhe përgjonte pastaj përsëri ecte. Në kurriz kishte një trastë. Dukej i lodhur, dhe ecte i kërrusur. Si bëri dy orë rrugë, u ndal ndënë një pemë për t'u çlodhur. Tani ishte fare pranë atyre. Duhej të grumbullonte forcat. Do të kalonte pa i hyrë asnjë gjemb në këmbë. Ah, që nuk mund të ndizte një cigare, ta thithte qoftë edhe një herë. Nisi të kujtonte ç'i kish ndodhur dhjetorin e vitit 19...

«Ishte natë. Ai si zakonisht rrinte vetëm në shtëpinë e tij. Nuk kishte bërë prokopi në këtë botë. Gruaja i kishte vdekur dhe fëmijë nuk i kishte lënë. Ai nuk do t'i hynte më asaj valleje. Punonte, por në krahasim me të kaluarën nuk jetonte gjë. Ah, e kaluara! Njeriu nuk ngopet dot me florinj. Troket dera. Ai ngrihet dhe shkon atje. Merr një revolver në dorë dhe pyet:

— Kush është?

Dëgjon një pëshpëritje.

— Jam unë Demoja, mos ka ardhur lopa ime në grazhdin tënd?

Ai pret pak dhe pastaj përgjigjet:

— Ja, prit të ndez pak kandilin.

— Veçse kujdes, se fryn erë.

Hap derën. Brenda hyjnë tre njerëz. Ata takohen dhe ulen.

Njëri prej tyre me kasketë në kokë u thotë:

— Peshku i artë noton qetësisht. Kur do ta turbullosh ujin? Mos pandeh, se na e ke lëshuar kot deklaratën?

— Nuk është aq kollaj ta turbullosh ujin.

— Ti nuk ke dërguar asnjë informacion.

— Po punoj në kondita të vështira, — u nxeh Sabriu.

— Këtu e tutje do të mbajë në lidhje «Kara-vidhja». Zbato çdo urdhër të tij.

— Mua do të më mbajë në lidhje një çilimi?!

— Ai ka dhënë prova.

Pastaj njeriu me kasketë i kishte dhënë parullën dhe kundërparullën dhe ishte larguar!...

Ai u ngrit dhe u nis për udhë. Ikte me hap të shpejtë. S'kaluan as dy minuta kur dëgjoi një dihatje dhe sa ktheu kokën prapa, një qen i madh iu hodh në gjoks. E përplasi në tokë. Pastaj dy duar e mbërthyen fort. Pas një ore, ai ndodhej në një «Gaz» në mes të dy vetëve dhe udhëtonte me shpejtësi. Pas tri ditësh u hap lajmi se Sabriu ishte hedhur matanë. Ato ditë pati lëvizje në fshat. Oficerët e degës kontrolluan banesën e tij.

Në kohën që të gjithë mendonin se Sabriu ishte diku matanë ai ishte futur në një dhomë të veçantë në degën e brendshme. Ishte i dërmuar. Për të kishin dijeni vetëm katër veta. Pas pak i erdhën për «vizitë». Ai u ngrit në këmbë.

— C'ndodhi kështu me ty?

— Të them të drejtën edhe unë nuk kuptoj.

— Fillimi nuk duket i mirë. Unë erdha për të bërë një bisedë «me zemër në dorë».

Sabriu lëvizi i shqetësuar në karrike.

— Përse mund të bisedojmë?

— Për hënën, për yjet, për zjarrin.

— Edhe për zjarrin?!

- Po, po.
- Zoti kryetar, unë kërkoj garanci.
- Nga ta filloj?
- Zakonisht fillohet nga e para.

Sabriu u kollit pak dhe, para se të fillonte, ia kujtoi edhe një herë kryetarit se po i fliste vërtet hapur dhe se patjetër duhej të kihet parasysh kjo.

Kryetari dëgjonte i qetë. Papritmas e pyeti:

— Po për Besën, ç'na thua?

— Aty unë jam i pastër.

— E di, ti punon gjithnjë pastër, por bën punë të fëlliqura. Na thuaj ç'i bëtë asaj?

— Ju lutem të flisni në njëjës, zoti kryetar. E përsëris që jam i pastër.

— Si e ke emrin?

Sabriu hezitoi pak. Ai e kuptoi për ç'emër bëhej fjalë, por fundja kjo ishte një gjë e parëndësishme tani.

— «Peshku i artë».

— Po ai tjetri?

— Cili?

— Ai që qëndroi për «të djegur».

«Peshku i artë» nisi të flasë.

— Ai budallai i kishte thënë se do ta merrte për grua dhe se do të shkonin të bënë qejf përjashta. I kishte thënë shumë gjëra. Më vonë ishte penduar. Rruga më e mirë ishte që ai të martohej me të, por vajza u tregua shumë e ftohtë. Ne këtu ndiqnim dy qëllime: t'i mbyllnim gojën vajzës, ta futnim të jatin në valle. Ai kishte disa llogari të vjetra me ne. Një ditë prej ditësh «Karavidhja» e kapi dhe i tha që të martohej me të, mirëpo ajo e kërcënoi me sëpatë dhe i tha se do të denonconte për gjithçka, bile edhe për armët që kishte të fshe-

hura. Atëhere ai bëri një gjest sikur e largoi degën e një ferre që i kishte zënë rrugën. Ja kjo që e gjitha.

Kryetari doli dhe thirri Simonin.

— Ç'na thua ti?

— Vebiun e kanë parë para dy ditësh në postë telegraf. Ai endet nëpër qytet. Atje ka hedhur një letër.

Kryetari hapi sirtarin dhe nxori një letër të shkruar me shkrim shtypi.

Simoni e shikoi me habi.

— Merre e shpjere për ekspertim.

Simoni e mori letrën, e hapi dhe filloi të lexonte:

«Jam një qytetar i ndershëm... përsa i përket vrasjes së Besës, u njoftoj se atë e ka vrarë Sabri...

Emrin nuk e ve, sepse dëshiroj të mbetem i heshtur. Më besoni dhe verifikoni.

Ju përshëndes».

Kryetari i shtrëngoi dorën Simonit dhe u largua.

Pasi erdhi përgjigja e ekspertimit, Simoni doli të kërkonte Vebiun. Ai e takoi tek po delte nga kinkaleria.

— Shoku Simon, si jeni?

— O, si je, si shkon?! Ku ke humbur kështu mor Vebi?

Pas përshëndetjes ata u drejtuan nga bulevardi duke biseduar. Kur vajtën përpara degës, Simoni e tërhoqi lehtë për krahu për nga dera, por Vebi e ndaloi dhe i tha:

— S'kam ndonjë punë aty, pse të vij?
— Dua të të njoftoj diçka, — i tha Simoni.
Vebiu hyri brenda. Aty e pyeti:
— Çfarë do të më njoftosh?
Simoni e shikoi drejt e në fytyrë.
— Arrestimin tënd!...

Ndërkohë Simoni shkoi në zyrën e kryetarit t'i raportonte. Ai i tha të ulej tek makina e shkrimit. Dhe Simoni u ul, vuri letër në makinë dhe priti të shkruante ato që do t'i thoshte kryetari. Ky rrinte i heshtur, flokët i kishin rënë mbi ballë.

— Shkruaj — i tha kryetari.

«I dashur xha Braho!

I përgjigjemi letrës suaj që na dërguat më...»
Simoni mbushi rreth dy faqe.

Kështu u zhvillua ngjarja. Të gjitha materialet e dosjes i përpiva brenda një nate. Në mëngjes tavilla e cigares ishte mbushur kapicë. Të nesërmen, shefi im hyri në zyrë dhe, si më pa ashtu të lodhur e me sy të skuqur, më përshëndeti duke më buzëqeshur.

U ngrita në këmbë. Më dukej se brenda asaj nate ai ishte transformuar. Përse nuk më kishte thënë asgjë nga këto?! I ktheva përshëndetjen:

— Mirëmëngjes, shoku Simon!

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Naum Prifti — Edhe një këngë tjetër	3
Shefki Haxhiu — Në vendin e takimit	11
Rrahman Osmanaj — Iluzioni i armikut	18
Skënder Iliri — Ndërgjegje	24
Agim Cerga — Pikëpyetje	29
Lolo Ganiu — Prapa një ngjarjeje	35
Naum Prifti — Operativi Çlirim Çeta	43
Isuf Baça — Me shpatulla në mur	53
Halim Stolia — Laku	61
Filip Rrumbullaku — E kujt ishte llulla?	78
Neshat Tozaj — Drurë të vetëmuar	88
Neshat Tozaj — Përgjigje letrës	102